
Shejh Abdulkadër Arnauti, ndërroi jetë!!!	3
Domosdoshmëria e momentit	4
BFI reloaded.....	6
Kalendari hënor.....	14
Thirja islame në media	16
Mediat si "zotërues" të kohës	17
Shkaqet e rehatisë shpirtërore	27
Beteja e Ahzabit	32
Vlera e dijes dhe dijetarëve.....	37
Mungesa e të vërtetës	42
Nderimi i emrave të All-llahut	47
Sistemi i emërimit në Islam	48
Kremtimi i martesave në xhami	53
Disa gra dijetare.....	56
Imam Hisham ed Destuvai.....	57
Ibën Ebi Dhi'b.....	58
Mezhebi i ehli hadithit	60
17. Butësia.....	61

Ne, musliman të nderuar, në këto vite të fundit jemi sprovuar me disa fatkeqësi, pa dyshim se prej fatkeqësive më të vështira dhe të rënda është vdekja e dijetarëve të Islamit, dijetarëve të Ehli Sunnetit, dijetarëve të Hadithit, dijetarëve që kanë flijuar gjithçka për të përhapur këtë fe të pastër, mu si atë ditë që i ka zbritur Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

I pari vdiq shejhu bujar dhe fisnik, njeriu i ndershëm dhe i devotshëm, njeriu që kujdesej për hallet e muslimanëve kudo që gjindeshin ata, që kujdesej për thirjen islame dhe mendohej të kontribuojë me çka ka, e ai është Shejhu i madh, Shejh Abdul-Aziz ibën Bazi, rahimehull-llah. Pas tij i erdhi vdekja muhadithit të këtij shekulli, ringjallësit të sunnetit të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, luftarit të paepur për të përhapur sunnetin dhe për të asgjësuar bidatin, njeri me origjinë shqiptare, e ai ishte Shejhu ynë Muhamed Nasirudin Albani, rahimehull-llah. Pas tij vdekja i erdhi fekihut të njohur, njeriut që njihnte hollësisht akiden e selefit, i thellësuar në njohjen e usuli fikhut, kibleja e nxënësve të dijes, e ai ishte Shejhu Muhamed Salih Uthejmini, rahimehull-llah. Kurse javën e kaluar, All-llahu na sprovoi me marjen edhe të një dijetari, e ai është Shejhu bujar, fisnik, modest, muhadithi i Damaskut, Shejhu Abdulkadër Arnauti, rahimehull-llah.

Kurse unë do të mundohem ti shpalosi disa evokime nga takimet e mia me te; Ky njeri tërë jetën e tij ia kushtoi dijes, daves dhe Islamit. Ishte mikpritës i madh i nxënësve të dijes, kujdesej për ata dhe i stimulonte për dije dhe punë me te. Ishte i butë, i afërt, kishte dije të thellë, dhe njohje të mirë mbi qëndrimet e Shejhu-Islam Ibën Tejmijes dhe nxënësit të tij, Ibën Kajim El-Xheviut, All-llahu i mëshiroftë.

Herën e parë jemi parë me te në vitin 1988 kur shkua në Damask të Sirisë që të mësojmë gjuhën arabe. Që nga takimet e para, edhe pse kishim dëshirë të mësojmë shkencat e hadithit të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ai me sjelljen dhe dijen e tij edhe ma shumë na shtoi këtë dashuri. Insistua nga shejhu që të na caktojë një kohë që të mësojmë me te, dhe më kujtohet si sot, dhe këtë libër akoma e kam në bibliotekën time, filluam të mësojmë me te librin "Muhtesar Rijadus-Salihin", të cilin e kishte reduktuar Jusuf ibën Ismail En-Nebehani dhe e kishte botuar në xhëp verzion. Fatkeqësisht për shkak të vizitave të shpeshta që i bënin njerëzit shejhut, nuk aritëm që të vazhdojmë gjatë në mësimet me te nga ky libër.

Insistua që të studentët që ishin duke mësuar në Damask të kanë takime të rregullta me shejhun dhe disa prej këtyre takimeve i kemi inçizuar në audio kasete. Çdo herë që kemi shkua te ai në zyre, ku zakonisht e kalonte pjesën më të madhe të kohës së vet, asnjëherë nuk na ka lënë të dalim pa na dhënë para. Kjo neve na turpëronte, mirëpo ai asnjëherë nuk e ka ndryshuar këtë zakon të tij. Pa dyshim se kjo shpalo bujarinë e tij të madhe dhe kujdesin që kishte për studentët e fesë.

Pasi që vazhdova studimet në Jordani, kur e vizitoja Sirinë, çdo herë e vizitoja edhe Shejh Abdulkadrin, dhe i çoja selamet që ia dërgonte Shejh Albani, rahimehull-llah, këtij. Një herë, më kujtohet shumë mirë, kam ndihmuar në këmbimin e letrave mes shejh Albanit dhe shejh Abdulkadrit. Takimi i fundit me te ishte në vitin e kaluar në udhëtimin tonë për në haxh, e shfrytëzuam atë takim për ta pyetur për shumë pyetje që na preokupojnë neve si thirës në vendin tonë. Pastaj kërkuam nga hoxha ynë që edhe ta mbajë një ligjeratë për mbarë muslimanët, material i cili është inçizuar dhe ka pasur jehonë të mirë në viset shqiptare. Normalisht se ka edhe shumë për tu thënë për këtë dijetar të madh që e humbi bota Islame, mirëpo ne mjaftohemi me kaq, për në fund e lusim All-llahun që shejhut tonë All-llahu tia fal mëkatet, tia ngrit gradat dhe ti dhurojë Firdeusin e lartë. Amin.

Bekir Halimi

(shkëputur nga hutbeja "Vlera e dijes dhe dijetarëve")

edicion i botuar / viti i parë / nr: 17

botues: ALBISLAM

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi,

Alajdin Idriz, Fatmir Zaimi

www.albislam.com

albislam@albislam.com

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

Shejh Abdulkadër Arnauti, ndërroi jetë!!!

Në moshën 76 vjeçare, me 26 nëntor, ditën e premte, në Damask vdiq dijetari i njohur shqiptar, Abdulkadër Arnauti. Ky dijetar shqiptar, me emrin Kadri Sokoli u lind në fshatin Vrellë në afërsi të Istogut (Kosovë) në vitin 1928. Qysh si fëmijë i vogël tre vjeçar, së bashku me familjen e vet shpërngulet në Damask (Shami i atëhershëm). Në Damask vijon shkollën fillore. Në këtë shkollë e njohur me emrin Medresetu Is'af El Hajri, mësimet e para i merr para mësuesit të tij Subhi El Attar tek i cili mësoi leximin e Kur'anit, texhvid dhe mësimet e para të fikhut (jurisprudencës islame). Pas mbarimit të shkollës fillore fillon punën si orëndreqës në dyqanin e një profesori të universitetit të Az-harit, Shejh Se'id El Ahmer, në afërsi të xhamisë Emevije. Pronari i dyqanit pas pak kohe vërejtë aftësitë e Abdul Kadrit, e morri ate dhe e çoi të mëson në Xhaminë Emevite në hallkat (tubime të diturisë) të mbajtura nga Shejh Salih Farfurit gjegjësisht tek nxënësi i tij Abdur Rezzak El Halebij.

Ai mësoi edhe tek Shejh Mahmud Faiz Ed Dir'atani tek i cili vazhdoi mësimet e Kur'anit. Në hallkat e xhamisë Emevije vazhdoi mësimet e hadithit, tefsirit dhe fikhut. Përdorja e haditheve të dobëta dhe atyre të trilluara nga ana e disave, e nxitën ate që më tepër t'i përkushtohet shkencës së hadithit.

Gjatë kësaj kohe mësoi edhe tek disa dijetar shqiptar siç ishin: Sulejman Gavoçi i ati i Vehbi Sulejman Gavoçit, dhe te Nuh efendiu, i ati i muhadithit të njohur, Muhammed Nasirudin Albani.

Pas pesë vite mësoi zanatin e orëve dhe

filloi të punon në duqanin e tij. Në atë kohë me kërkesë të shkollës bëhet mësues në shkollën në të cilën i morri mësimet e para. Gjatë kësaj kohe i përkushtohet tërësisht hadithit duke mësuar dita ditës më tepër për këtë shkencë të bekuar. Gjatë kësaj kohe fillon edhe redaktimin e librit voluminoz "Xhamiul Usul fi ehadithi Resul" të cilin libër e përpunoi brenda 5 viteve. Në saje të dijes së tij si dhe për shkak të oratorisë dhe guximit zgjedhet si hatib (ligjërues) i xhamisë Muhammedije në Damask. Hutbet e tij në këtë xhami ishin të dëgjua dhe vizituara nga ana e shumë njerëzve. Pas xhumasë ai qëndronte për t'u përgjigjur pyetjeve nga të pranishmit në xhami. Vetëm vonë para disa vitesh iu ndalua ushtrimi i këtij posti në Siri, nga ana e regjimit të atjeshëm. Njihet edhe si muxhtehid (shkalla më e lartë e diturisë) në çështjet e shkurorrëzimit (talakit).

Gjatë jetës shkencore shpesh herë është takuar me Shejh Albanin gjatë qëndrimit të përbashkët në bibliotekën edh-Dhahirije. Për të ai thotë: "Me Albanin, All-llahu e mëshiroftë, më lidhte një lidhje plot dashuri dhe respekt edhe pse nuk pajtoheshim në disa mendime me njëri tjetrin. Gjatë qëndrimit në Siri ai jetonte afër xhamisë ku unë isha hatib dhe falej pas meje."

Shejh Abdulkadër Arnauti kontaktonte shpesh edhe me shejh Ibën Bazin, me të cilin u takua në xhaminë e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ku ai kishte mbajtur një fjalë pas namazit të xhumasë. Pas këtij takimi çdo herë që vizitonte Saudinë është takuar me të. Me iniciativë të Ibën Bazit, shejh

Abdulkadër disa herë e ka vizituar Kosovën. Udhëtimet e tij në Kosovë kanë qenë shkak i dërgimit të grupës së parë për mësim në Univerzitetit Islamik në Medine. Kjo lidhje e fortë vazhdoi deri në fund të jetës së Ibën Bazit, All-llahu e mëshiroftë.

Shejh Abdulkadri asnjëherë nuk e ka kursyer kohën e as mundin në mbrojtje të Sunnetit dhe metodologjisë së shëndoshë fetare.

Veprat e tija poashtu dëshmojnë për aftësitë e tij shkencore. Si recenzent i haditheve ai ka nxjerrur vepra voluminoze. Ai ka redaktuar 40-50 libra dhe është autor i tre librave. Kurse prej tyre ende ka që janë në dorëshkrim dhe të pabotuara.

Shënimet bibliografike për te i ka tubuar një nxënës i tij në librin “Keshfu Litham an ehad muhadithij Sham, Abdul Kadir El Arnaut”

Në gjuhën shqipe i janë botuar dy libra: Mbi rrugën e të parëve tanë –Shkup, 1994 Porositë profetike- Prishtinë, 2001

Abdulkadër Arnauti jetoi dhe veproi në Damask-Siri. All-llahun e lusim që ta mëshirojë dhe ta shpërblejë për mundin e dhënë. Amin. In-na lil-lahi ve in-na ilejhi raxhiun.

Talha Kurtishi,
26.11.2004

Domosdoshmëria e momentit

Pasi i erdhi shpallja Pejgamberit, Muhamedit, salallahu alejhi ve sel-lem, ai i tha gruas së tij: “O Hatixhe, koha për gjumë ka ikur”. Ky hadith është një ndër hadithet e shumta që thërrasin për aktivitet dhe që të mos jemi pasiv dhe neglizhent ndaj gjërave që ne mund t’i kryejmë. Populli shqiptar gjindet në një krizë të madhe në shumë aspekte, si atë të identitetit fetarë, kombëtarë, të papunësisë, edukimit etj..

Megjithë këto probleme që janë bërë barrë e shumë shqiptarëve shihet një tendencë pasiviteti dhe neglizhence. Muslimanët në veçanti përballen me shumë probleme të cilat ia kalojnë çdo individ tjetër të shoqërisë. Ata përballen sot me probleme të veçanta si paragjykimet, fobitë, pamundësitë për një edukim në disa shkolla publike dhe për pamundësi për të gjetur punësim po ashtu në këto shkolla, duke marrë parasysh këtu që edhe mundësitë për të

gjetur punë në punët publike janë minimale, së pari nga papunësia e përgjithshme dhe së dyti nga paragjykimet e punëdhënësve.

Si muslimanë ne e dimë që çdo përpjekje e jona nuk do të shkojë kot nëse e kemi nijetin e pastër dhe nëse puna jonë është në përputhje me fenë tonë. Atëhere pse ne nuk duhet të impenjohemi që të marrin një rol të rëndësishëm në shoqërinë ku jetojmë? Pse ne duhet të shtrijmë dorën disa personave që na shikojnë me përbuzje për shkak të besimit? Pse ne nuk kërkojmë mënyra që të bëhemi të pavarur materialisht? Pse ne nuk bashkëpunojmë me njëri-tjetrin për të bërë diçka që ta nxjerrim njëri-tjetrin nga kjo situatë? Pse ne nuk organizohemi ashtu sikur disa grupacione të cilat kanë si gjë të përbashkët kanë vetëm interesin ndërsa ne kemi të përbashkët fenë dhe interesin? Pse ne duhet të rrimë duarkryq kur ne mund të bëjmë shumë?

Shumë persona që do ta lexojmë këtë artikull do të habiten, ndoshta edhe duke ngritur shpatullat, kjo ndodh nga pesimizmi që ata posedojnë tek vetja dhe rrethi i tyre. Ne kemi parë se si disa persona që nuk kanë asgjë më shumë sesa ne, kanë krijuar fondacione, organizata, kanë hapur punishte, ndërmarrje dhe zyra për të ndihmuar qytetarët shqiptarë me serviset e tyre. Po muslimanët ku janë? Ne nuk shihemi në asnjë cep të shoqërisë, kjo është arsyeja që shumë muslimanë të rinj duke mos parë ndonjë organizim të mirë shkrihen me kalimin e kohës dhe lënë shumë prej fesë së tyre. Kemi shembullin kur tre vajza muslimane u përjashtuan nga shkolla pasi mbanin mbulesën fisnike islame, sikur ato do të kishin një aletativë islame barra me të cilën u sprovuan do t'ju ishte hequr. Ku janë muslimanët? Vëllezër të shumtë që ne i njohim kanë shprehur dëshirën e tyre që të kthehen në Shqipëri për të investuar dhe jetuar. Por shumica janë të frikësuar nga ç'organizimi që shohin tek ambienti i muslimanëve në Shqipëri. Shumica dëshirojnë të kthehen pasi kanë fëmijë që duan t'i edukojnë si muslimanë të ndershëm. Si ka mundësi që të arrihet kjo kur në mjedisin e disa medreseve kemi njerëz që nuk besojnë tek Zoti, të cilët shpesh janë dhe amoral dhe shikojnë më shumë problemet personale sesa shikojnë interesin e muslimanëve dhe islamit dhe po këta japin mësim aty, kur në këto shkolla morali nuk është aspak në kurrikulumin e shkollës apo kemi shkolla ku nuk bëjnë dallim nga shkollat e tjera laike!

Tani, është e rëndësishme t'i vendosim disa pika të cilat janë më të domosdoshme për mbarëvajtjen e punëve të muslimanëve.

Pika e parë, është se shoqërisë muslimane shqiptare i duhen kuadro dhe intelek-

tualë që do të jenë të aftë që të hedhin këto ide në plan pune. Ne si shoqëri kemi nevojë për:

1. Mësues dhe mësuese në lëndë të shkencave të ndryshme.
2. Kemi nevojë për biznesmen apo ekonomist muslimanë të cilët do të merren me problemet financiare të institucioneve islame.
3. Kemi nevojë për menaxherë dhe drejtues të aftë që do të duhet të drejtojnë institucione islame.
4. Kemi nevojë për këshilltarë dhe psikologë të cilët janë muslimanë dhe që do ti këshillojnë pacientët e tyre me atë që është në përputhje me metodologjinë islame...
5. Ne kemi nevojë për mjekë dhe radiologe muslimane që do të marrin përsipër mbikëqyrjen e grave muslimane.
6. Ne kemi nevojë për gjinekolog muslimanë dhe muslimane...

Së dyti, kemi nevojë për njerëz që kanë iniciativa për të ndërmarrë punë të tilla. Ne shpesh kemi parë se disa organizata bamirëse shumë të mëdha janë krijuar nga individë të vetëm, po ashtu edhe ndërmarrje, po ashtu edhe zyra serviseshe që u ofrojnë punë të tjerëve në bashkëpunim me ndërmarrjet që kërkojnë punëtorë. Kjo nuk do të thotë se vetëm një individ e ka obligim këtë gjë, por shpesh iniciativa e dikujt bëhet shkak për ndërmarrjen e shumë projekteve të nevojshme. Diçka që do të ishte më shumë për tu lavdëruar do të ishte kur kjo iniciativë do të vihej në praktikë nga shumë persona sepse në këtë mënyrë do të arrihej prefeksionimi i tyre.

Ne shpesh i kemi dëgjuar shumë vëllezër në Perëndim që dëshirojnë të japin në bamirësi para për të shlyer zekatin e tyre apo për të dhënë sadaka por janë të pakënaqur pasi paratë e tyre nuk përdoren aty

ku është më e nevojshme

Nuk do të thotë që të gjitha këto do të kryhen brenda një periudhe të shkurtër por është e rëndësishme që muslimët duhet t'i kenë parasysh këto probleme dhe të zhvillojnë veten e tyre për t'i arritur këto synime në mënyrë që t'i kapërcejnë problemet e tyre me lehtësi. Po ashtu të tilla projekte do të krijojnë një përshtypje impresionuese tek popullata shqiptare e cila nuk është praktikuese e islamit. Duhet të jemi të vetdijshëm se këto janë probleme me të cilat po përballen të gjithë muslimanët e Europës e më larg dhe shumë kanë marrë përsipër iniciativë të tilla të cilat janë shumë frytëdhënëse. Nuk do të thotë që secila nga këto pika medomeos duhet të krijohet një zyrë apo organizatë kjo varet nga struktura dhe nga vërshimi i kërkesave nëse është e mundshme që këto të përmblihen

në një organizatë kjo do të ishte më e mirë dhe më efëcente. Nuk duhet të harrohet edhe roli i komunitetit muslimanë me të cilin ne si individë duhet të bashkëpunojmë për të arritur këto synime madhore.

Këto ishin disa ide apo mendime që desha t'i ndaja me vëllezërit e mi muslimanë.

Unë e di që në mesin tonë ka shumë vëllezër të zgjuar që ndoshta do të përpunonin më mirë këtë artikull apo këto ide. Le të jetë ky artikull një frymëzues për ta përmirësuar apo për të bërë një diçka më detajuese dhe profesionale duke përfshirë të gjitha anët e problemeve dhe zgjidhjen e tyre, planin e punës dhe përvetësimin e fondeve.

Allahu i ndihmoftë të gjithë ata që përpunon në rrugën e Tij. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij.

Ammar Ardit Kraja,
3.12.2004

BFI reloaded

Përkundër asaj se problemi më aktual dhe më i njëmenditë i popullatës së këtuhit në këto dy muaj ishte ekonomik dhe tokësor problemi i shfaqur si më i madhi në republikën e Maqedonisë në këto dy muaj ishte krejt tjetër diçka: referendumi. Referendumi si iniciativë mbeti çështje politike dhe sërrish tokësore por pritja e rezultatit nga ai nuk qe as naive dhe as sekulare. Ashtu gjatë kësaj pritje, vazhdoi kontesti rreth Kishës Ortodokse Maqedonase dhe llafeve për te. Dallimi këtë herë ishte se gjatë kësaj pritje u përfol edhe një bashkësi tjetër fetare e përmendur në Kushtetutë, e dyta për kah madhësia, Bashkësia Fetare Islame e

Maqedonisë. U ngrajt pluhur për disa zgjedhje të kryera aty, punësime të bëra etj. Që krejt të mbarojë, tani për tani, me ngujimin njëditor të kryetarit të këtij institucioni nga ana e disa imamëve të pakënaqur me myftiun e Shkupit. Ngujim ky i bërë me kërkesë eksplicite që kryetari të thërret mbledhje të Rijasetit për shkarkim të Myftiut. Më në fund mbledhja e Rijasetit u mbajt dhe në te u vendos që të thirret mbledhje e organit zgjedhor të myftiut të Shkupit, pra Kuvendit të Myftinisë.

Me aprovimin e ndryshimeve në kushtetutën e Republikës së Maqedonisë si rrjedhojë e Marrëveshjes së Ohrit, Bashkësia Fetare Islame tani më përmendet në

Kushtetutë dhe si pasojë i është ndryshuar statuti, jo dhe aq historikisht i qartë, i mëparshëm. Vetëm dy vjet më vonë se ndryshimet e sjellura ky institucion miratoi rregulloren e vet ku emërtohet në përputhshmëri me kushtetutën e shtetit. Tani afrohet edhe plotësim i vitit të paraparë po me këtë rregullore të këtij institucioni, për deri kurë është paraparë që të gjithë aktet normative të saja të jenë në përputhshmëri me rregullimin e ri juridik. Kurse ende edhe konstituimi i disa organeve të institucionit fetar të myslimanëve të Maqedonisë është ende i pjesërishtëm. Ashtu dy nga organet e larta të këtij institucioni, më se të nevojshme për implementimin e ndryshimeve, ende mungojnë. Sekretari i përgjithshëm dhe këshilli kushtetues ende ekzistojnë vetëm në nenet e aprovuara të rregullores së re kurse përveç të duhura për gjatë ndryshimeve, ata janë organe më se të nevojshme edhe për rregullim të kontesteve që ndërkohë mund të shfaqen si pasojë e krizës së legjitimitetit të tërhequr zvarrë me kalimin e kohës në këtë institucion.

Përveç vonimit edhe momentet e zgjedhura aludojnë në diçka krejt tjetër. Fakti se zgjidhen myftilerët vetëm dy tre muaj para aprovimit të rregullores së re juridike nga e cila pasojnë zgjedhje të përgjithshme dhe se në të njëjtën ditë kur mbahet mbledhje e Kuvendit të BFI-së për zgjidhje të kontestit rreth kuvendarëve nga Shkupi dhe zgjedhjeve në atë myftini, ngujohet Kryetari i BFI-së, me pretext kontestimi të zgjedhjeve për myfti të mbajtura një vit më parë, sipas nesh aludon se në këtë institucion ka një tajming virtual, i pakuptueshëm për botën reale dhe të dukshme. Autori i këtyre rreshtave është teolog dhe po të kishte diçka transcendente në këtë tajming, mos tjetër, do ja dinte fillin. I vetmi shpjegim

në dukje fetar por konspirativ, është se për shumë çka rreth këtij institucioni zgjidhet koha para muajit të ramazanit ose gjatë tij, si komplot kundër organizmit të jetës fetare përgjatë këtij muaji, në kuptimin tokësor, muaj apolitik. Sqarimi më i përafërt me të vërtetën do ishte se krejt ky virtualitet në zgjedhje të momenteve ka të bëjë me presion për forcim të pozitës para zgjedhjeve për kryetar të ri të këtij institucioni, i cili më së vonë duhet të jetë në fund të këtij procesi zgjedhesh dhe ndryshimeve në BFI.

Komisioni Zgjedhor pranë këtij institucioni i pat shpallë të pavlefshme zgjedhjet për organet kolektive në myftininë e Resnjës dhe ate të Shkupit. Si pasojë e kësaj Kuvendi i Bashkësisë Fetare Islame, i cili është organ më i lartë i këtij institucioni, formoi komision të veçantë për çështjen e zgjedhjeve në Shkup dhe edhe të vet antarëve të kuvendit nga Shkupi. Në mbledhjen e dytë të këtij Kuvendi, të mbajtur më 06 Tetor, u miratua raporti që u ofrua nga komisioni i formuar enkas për këtë gjë dhe u pranua rezultati nga zgjedhjet e mbajtura në myftininë e Shkupit. Relacioni ndërmjet myftinisë së Shkupit dhe kryesisë së BFI-së, ishte dhe mbetet çështje e cila preokupon më së shumti marrëdhëniet në këtë institucion viteve të fundit, por e njëjta vazhdon të jetë nyja e problemeve të fundit që ndodhin në BFI. Premisat për këtë gjë janë faktet se vetëm në myftininë e Shkupit ende nuk ka mbaruar trendi i “decentralizimit fiskal” që viteve të fundit kthehet në praktikë në shumë fshatra dhe qytete të Maqedonisë. Ashtu ende vetëm në Shkup, punonjësit kanë aq shumë allëshverësh me myftinë, në vendet tjera është kthyer pagesa e hakkit të hoxhës që grumbullohet nga besimtarët në xhematin përkatës. Kjo në Shkup bëhet më

vështirë edhe përkundër asaj se Myftinia e Shkupit dhe shumica e xhemateve nën juridicionin e saj ka vakëfe të mjaftueshme të ardhurat prej të cilave do mjaftonin për funksionimin e jetës fetare në këtë myftini. Të rikujtojmë se xhamitë tradicionalisht kanë pasë sistem gati të përsosur të vetfinancimit nëpërmjet institucionit të vakëfit, gjë që asnjëherë nuk e ka bërë të nevojshme mbledhje të antarsisë apo kontributeve tjera vullnetare për nevoja të funksionimit të mirrëfilltë të jetës fetare. Ashtu procesi i decentralizimit i ka takuar punonjësit fetar në Shkup me paga nën minimumin e caktuar në shtet dhe me probleme të çuditshme administrative në çështjet e sigurimit shëndetësor dhe pensional. Vonimi i vendosjes së autoritetit legjitim në BFI në përgjithësi dhe në myftininë e Shkupit në veçanti e bën, tani për tani, gati të pamundshme denacionalizimin e vakëfeve apo e rregullimit të disa nga këto banalitete.

Disa nga fjalët e thënura gjatë protestit të fundit të akcionit tëkërlek të disa prej punonjësve fetarë në Shkup, përveç me precedentin e ngujimit të kryetarit të BFI-së edhe me denoncimin publik për një borxh ndaj fondit invalidoro-shëndetësor, rëndojnë edhe më shumë autoritetin e nevojshëm institucional. Shikuar nga ky prizëm, të njëjtën e bëri edhe myftinia përkatëse e Shkupit në përgjigjen ndaj disa prej fjalëve të thënurave kur tha se BFI është organizatë joqeveritare dhe kur vazhdoi me emërtim të shtrembët për nxitësin real të protestit, duke mos e emërtuar atë me emërtim të vërtetë. Nëse i shtohet kësaj edhe fakti se për herë të parë kallaballëku i hoxhallarëve, tani i emërtuar Kuvend i myftinisë, nuk mbajti mbledhjen tradicionale para ramazanit do mund të kuptohet se pse organi i Myftinisë së Shkupit tani konsiderohet tejet i dobësuar me

dijagnozë të përafërt me vdekje klinike.

Kurse BFI nuk është dhe nuk do jetë sindikatë e hoxhallarëve pasi kjo është koncept tejet përdhe, por se disa nga këto funksione duhet ti kryejë një shoqatë sub-institucion i BFI-së, i emërtuar Ilmijje. Kjo është një subinstitucion i formuar, përveç për qëllimet e shkruara gjatë themelimit në sistemin monist, edhe për tu kujdesur për hoxhalarët. Gjatë tërë bujës së fundit kjo shoqatë në suaza të BFI-së zgjodhi heshtjen dhe me këte ju bashkangjiti shumicës heshtëse në BFI.

Siç edhe u publikua në media Rijaseti ka propozuar që të thiret mbledhje e Kuvendit të Myftinisë së Shkupit, kuvend ky i cili ka problem të konstituimit. Andaj përveç verifikimit të nënshkruesve në ndonjë iniciativë për shkarkim të myftisë duhet të verifikohen edhe antarët e këtij kuvendi. Por para kësaj Rijaseti, tani i përkohshëm duhet të përfundon me konsistimin e vetes, duke zgjedhë një sekretar të përgjithshëm. Poash-tu duhet urgjentisht të zgjidhet Këshilli kushtetues i cili do jet refer për kontestin i cili do të paraqitet gjatë verifikimit të antarëve të Kuvendit të kësaj myftinie.

Pas kalimit të muajit të ramazanit kur u pa se jo vetëm që ramazani nuk u bojkotua por bile mu ata që përmendën bojkotin, mund të ankohen në bojkot të ramazanit ndaj tyre, gjendja momentale në BFI është në heshtje. Por konstituimi i përkohshëm dhe i pjesë-rishëm i disa nga organeve kyqe të BFI-së dhe mungesa në tërësi e disave prej tyre ka kapacitetin për destabilizim të tërësishëm të situatës brenda institucionale në BFI. Kësaj i shtohet edhe rreziku nga vazhdimi me trendin e decentralizimit të skajshëm të cilin e bën të mundshëm mungesa edhe e minimumit të funksionalitetit të këtij institucioni në momente të caktuara. Ashtu

rasti i fundit nga kjo situatë ishte mu në bujën e madhe të paradokohshme kur nuk mund të vërtetoheshin komunikatat zyrtare nga ky institucion kurse nga ana e disa medimeve, kryetari i BFI-së, paraqitej si një "jeti" i cili herë ishte i shtrirë në spital, herë ishte parë në Tetovë, herë nuk mund të vinte në kabinet të vet, e që pastaj të dale se ishte në Ohër etj.

Një tjetër gjë e cila ka kaluar disi pavërejtur në opinion e që ka të bëjë me BFI-në ishte një komunikatë e një këshilli të disa organizatave joqeveritare turke të cilat ankoheshin për përfaqësim jo të denjë me ç'rast kishin përmendur edhe Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Ata përveç se kishin harruar se në atë marrëveshje ka një kuotë e cila duhet plotësuar nuk dishin edhe se brenda gjithë organeve të BFI-së ka reprezent turk. Ata janë më shumë aty ku ka bashkëfolës të tyre, si shembull në Maqedoninë lindore ose në myftininë e Resnjes, ku ende nuk u morr vesh zyrtarisht se çka ndodhi në zgjedhjet e fundit pasi të njëjtat ishin shpallë si të pavlefshme. Pasoja më e madhe që sjell kjo komunikatë naive me qëllim punësimi edhe të ndonjë turqishtfolësi në qendrën, administrativisht të stërngarkuar të BFI-së, është se kërkohet në bazë të çelsit etnik në një institucion i cili sipas definicionit është fetar. Kjo gjë përveç që si akt rëndon legjitimitetin e njerëzve që veç më punojnë në këtë institucion dhe që kanë gajle turke ajo është edhe një autogol për vet ata pasi me këte ua kujton shumicës një çels me të cilin ata do mund, sipas tyre, të lypin hakun në këtë institucion. Nëse e njëjta lidhje nuk është ndonjë lidhje virtuale e disa fantom organizatave, gjë për të cilën flet fakti se të njëtit nuk janë deklaruar për një çështje shumë me rëndësi si referendumi, ata sa më parë duhet ti kërkojnë falje

publike institucionit të vetëm fetar të myslimanëve të Maqedonisë, BFI-së.

Një vështrim tjetër për bujën e përcjellë në publik për ate që ndodhi kohëve të fundit në Bashkësinë Fetare Islame të Maqedonisë, ishte se kjo kishte të bëjë me integrimin e opinionit publik. Krejt kjo me të vetmin argumentim nga një risi të cilën e bëri Agjencia Informative e Maqedonisë për ramazanin e sivjetshëm, e ajo ishte se krahas kalendarit katolik dhe atij ortodoks publikoi edhe pjesë nga kalendari islamik. Konkretisht ajo publikoi kohët e fillimit dhe mbarimit të agjërimit, dhe prej saj ate e morrën dhe e publikuan edhe disa nga medimet në gjuhën maqedonase. Por ajo që i ndodhi në fund të kësaj buje, një televizioni privat në gjuhën maqedonase, i cili medium ishte më aktiv në përcjelljen e lajmeve për këtë temë është argumentim më i mirë se ende është shumë herët për integrim të opinionit publik dhe se më shumë ishte aktivitet përcjellës i pritjes së referendumit. Mediumi në fjalë në vazhdimësi përcillte lajme dhe komente nga grupi i punonjësve fetar të pakënaqur me myftiun e Shkupit. Si i tillë ai kishte rënë në sy dhe më së fundi e pësoi duke u ndeshur me një bllokadë informative për anën zyrtare të problemit, pra ate brenda institucionit të BFI-së. Ai kanal televiziv, me të veten, u hakmorr ashtu që për prezantimin e kryetarit të BFI para opinionit publik për ramazan, tha se është inçizim i vjetshëm. Ndonëse shihej qartë nga kontesti i fjalive të thënura në atë prezantim se puna ishte shumë e sivjetme. Përveç kësaj edhe komunikata BFI, e nënshkruar nga kryetari i saj dhe që kundërshtoi referendumin si një iniciativë njënacionale është argument më tepër për ate se ndoshta mu integrimi i opinionit publik do jetë pika e fundit e integrimit të shoqërisë sonë multi-konfesionale dhe multietnike.

Në zhvillimin insitucional të BFI-së si dhe gjatë miratimit të ndryshimeve është evident një vonim dhe shtyrje e afateve të parapara. Ajo që befason secilin njohës të rrethanave të këtushme është reagimi me kohë kur diçka prej këtyre punëve ka të bëjë me financat. Ashtu sasia e lëmoshës së ramazanit-sadakatul fitrit u caktua në kohë, që në mbledhjen e parë konstituive të Rijasetit kurse e njëta ishte rasti edhe me organizimin e haxhillëkut. Kjo kur dihet se për dyja mbledhjet kishte në rend dite punë shumë më esenciale se këto, për mbarëvajtjen e këtij institucioni. Ashtu ndryshimet dhe përmirësimi në këtë institucion do të ndodhë duke e aplikuar tajmingun i cili është i saktë për financat edhe për ndryshimet kurse aplikimi i parë i këtij tajmingu do bëhet me plotësimin e konstituimit të organeve të larta të BFI-së dhe me zgjedhjen e kryetarit të ri i cili do të drejton këtë institucion në periudhën e ardhshme.

Në fund kisha menduar për një ankesë publike kundrejt disa prej mediave në gjuhën maqedonase të cilat për në ditë të bajramit hodhën tituj bombastik me përmbajtje dikund dikund edhe spekulative duke mos pasë parasysh se me këte mund të ofendojnë besimtarët mysliman të cilët atë ditë kanë njërin prej festave vjetore të tyre dhe ditë solemne e cila nuk duhet prishur. Përkatësisht mendoja se do të kem problem me sqarimin e një konceptit; prishje e bajramit. Që një njeri nuk duhet prishë bajramin duke u hidhëruar apo humbur gëzimin e nevojshëm për këtë ditë. Por tani çdokush që ka kuptuar se edhe atij mund të i ishte hedhur ndonjë faj gjatë arsyetimit të dorëheqjes së kryetarit të qeverisë së vendit, në ditë të bajramit, tani më ka kuptuar se si prishet bajrami.

Gjendja institucionale në BFI gjatë muajit të ramazanit ishte e përcjellur me aktivitete fetare përveç disa deklaratave për vonim të dorëzimit të parave të grumbulluara nga lëmosha e ramazanit dhe me një kërcënim për prishje të manifestimit publik të kryetarit që tradicionalisht mbahet në një xhami qendrore në Shkup. Ashtu si një kërcënim u përcoll në disa medime vërejtja e grupit të punonjësve fetar të pakënaqur me myftiun e Shkupit e që ishte që kryetari mos të vijë në Shkup, për bajram. Kryetari i BFI-së Arif ef. Emini, erdhi në Shkup dhe udhëhoqi me ceremoninë e bajramit të cilin manifestim qendror e përcollën gati të gjithë medimet në vend. Poashtu gjatë muajit të ramazanit edhe myftinia e Shkupit organizoi një manifestim për shënim solemn të Natës së Kadrit, një natë kjo e veçantë në muajin e ramazanit. Kurse lëmosha e ramazanit ende grumbullohet nga xhematet përkatëse në çdo myftini por duhet përkujtuar se kjo është një lëmoshë fetarisht e përkufizuar në kohë ashtu që kjo gjë përpos që vërehet në emërimin e saj e që është sadakatul-fitr para lëmoshë për fitr bajramin ajo edhe duhet të jipet dhe shpërndahet për bajram.

Edhe për këtë bajram gjëja më interesante për vështrim ishin urimet e bajramit. Këto vizita e urime erdhën edhe si përkrahje e domosdoshme pas krejt përcudnive dhe bujës, detaje prej së cilës dolën edhe në publik dhe ate për dy prej institucioneve nga më me rëndësi në BFI, kryetarin e saj dhe myftininë e Shkupit e cila është myftinia më e madhe në Maqedoni. Kjo pasi me ndodhitë e fundit, si dhe me ato që kemi përmendë edhe më parë si; konstituimi i përkohshëm dhe i pjesërishtëm i disa nga organeve kyç, mungesa në tërësi e disave prej tyre, trendi i decentralizimit të skajshëm dhe mungesa edhe e minimumit të funksionalitetit të këtij

institucioni në momente të caktuara kishte vërë në pyetje legjitimitetin në tërësi të institucionit. Mbetet që kjo përkrahje, nga institucione relevante dhe të huaja të ruhet dhe të mos zgjat vetëm sa një bakllavë e bajramit. Që kjo gjë të arrihet përveç nevojës të gjithmonshme për vetëdijësimin e të punësuarve në këtë institucion për kontinuitetin historik dhe rëndësinë e BFI-së, për momentin duhet që sa më parë të jetësohet përgjegjësia e punës dhe fjalës në këtë institucion edhe publik. Themi të jetësohet ngase kjo si princip tani më vetëm se është i legalizuar në këtë institucion ku sipas rregulores së re juridike të BFI-së secili funksionar dhe punëtorë pranë institucionit mund të mirret në përgjegjësi disiplinore në raste të cënimit të interesit të BFI-së ose kur i shkakton dëm të njëjtës.

Duke qenë të vetëdijshëm për nevojën e një institucioni stabil dhe të mirrëfilltë i cili i përfaqëson myslimanët e Maqedonisë dhe i cili do të mirret me organizimin e jetës fetare ndër to, vazhdimisht duam të rikujtojmë edhe opinionit rëndësinë e përmirësimit dhe rimëkëmbjes të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, si institucion i cili do të kryen këto funksione. Ashtu edhe ky shkrim, si edhe të mëhershmet, duhet kuptuar si një fryt i kësaj vetëdije si dhe i njohjes për reziqet eventuale të cilat mund të sjellë mospatja e një institucioni të këtyllë apo delegjitimimi i tërësishëm i këtij aktual. Kjo pra është shënimi i një zgjidhjeje për disa nga problemet që ndodhin në Bashkësinë Fetare Islame të Maqedonisë. Zgjidhje kjo e cila është në vijë me proceset e ndryshimeve dhe të përmirësimit që ndodhin në këtë institucion, pas vitit 2001. Baza edhe e këtij propozimi është platforma, më herët e publikuar, e Iniciativës për përmirësimin e organizimit të jetës fetare. Një

iniciativë kjo, e formuar në fillim të vitit të kaluar, rreth të cilës brenda BFI-së, janë mbledhur shumë punonjës fetarë dhe intelektualë mysliman nga qytete dhe fshatra të ndryshme të Maqedonisë. Njerëzit që do të bartin këto ndryshime në BFI janë emra të dëshmuar për opinionin dhe ata përveç vetëdijes për nevojën e ngritjes kualitative të institucionit ku punojnë kanë edhe ndjenjën e borxhit ndaj bukës së vakëfit të cilin borxh do ta pagojnë vetëm duke kontribuar për përmisimin e organizimit të jetës fetare dhe ruajtjen e kriterit për zhvillimin e së njëjtës. Me dëshmim nënkuptojmë këtu se ata me ate që kanë bërë deri tani kanë sqaruar dy gjëra më se të nevojshme për momentin dhe rrethanat në të cilat ndodhet institucioni. E para prej tyre është se ata janë të njëmendtë në insistimin e tyre për përmisim dhe e dyta se këte e bëjnë me një rend.

Myftinia e Kërçovës është njëra prej tri myftinive të Bashkësisë Fetare Islame të cilat ende nuk janë stabilizuar nga zgjedhjet e fundit e mbajtura në këtë institucion. Ashtu kjo myftini krahas myftinisë më të madhe ate të Shkupit dhe asaj të Resnjes, ku ende askush nuk qartëson se çka ka ndodhë në zgjedhjet e fundit, pasi ato në fillim ishin shpallë të pavlefshme. Në disa reagime dhe opinione për publik në lidhje me kontestin dhe problemet në atë myftini u vënduan mes tjerash edhe tituj si “heshtje para stuhisë”. Ashtu me këso tituj edhe evergreen edhe bajate shpesh pasqyrohet gjendja në institucionin fetar të myslimanëve të Maqedonisë. Ngjarjet që do ndodhin javëve dhe muajve të ardhshme priten nga opinioni për të parë se çka dhe si do të vajnë punët në këto tri myftini por edhe në krejt BFI-në. Ashtu në Shkup duhet të mbahet mbledhje e kuvendit të myftinisë të Shkupit kurse mund që një mbledhje e njëjtë të thuret edhe në myftininë

e Krçovës. Mbetet që gjatë këto rrjedhave mos të ketë as heshtje e as stuhi. Thjesht duhet vazhdimisht të i sqarohet opinionit jeta institucionale në këtë bashkësi fetare. Për të mos ju mbetet njerëzve që e njëjta mëton të i përfaqëson, pra myslimanëve të Maqedonisë, që vet të bëjnë si dijnë dhe si munden, të marrin vesh se çka ndodh aty. Hisen e vet të mundit në këtë aspekt gjithsesi duhet ta japin mediat e shkruara dhe elektronike të vendit por ende më shumë kjo bashkësi duhet që të artikullojë mirë zërin e saj. Ashtu gazeta e këtij institucioni, në tri gjuhët, duhet të dalë në kohë dhe të përmban sa më shumë informata për ndodhitë në këtë institucion. Kjo sepse nuk është kuptuar asnjëherë se çka është pasojë e çka shkak në relacionet e heshtjes me stuhinë. Kjo ngase heshtja e gjërave provokon stuhi por edhe pas ndonjë stuhie shumë gjëra edhe në janë të zëshme, duken të heshtura.

Nisur nga krejt që është botuar dhe thënë rreth ndodhive të fundit në BFI gjithë njerëzve të vetëdijshëm edhe për përgjegjësinë historike të fjalës dhe veprës mund të ju shkon mendja se si do të përshkruhet gjendja e tanishme në këtë institucion pas një kohe, kur dikush krejt tjetër do shkruan dhe me siguri do të lexon titujt dhe shkrimet që janë botuar në këtë temë. Nëse kjo do bëhet nga njerëz që kanë qenë të përfaqësuar mu nga ky institucion, objektiviteti i tyre për këtë gjë do jetë i njollosur ngase do të ndjehen të turpëruar. Këtë turp do ta ndjejë secili i cili ka pasë ndonjë mundësi që në ndonjë moment apo rrethanë të kontribuojë që ky përfaqësim të jetë sa më i denjë dhe i çliruar tërësisht nga kriza e legjitimitetit dhe kontesteve të vazhdueshme që përshkojnë jetën institucionale të BFI-së.

Gjithsesi do ndodhë shumë shpejt që ky

institucion ta marrë të mbarën pasi asnjë njeri i vetëdijshëm për të mirën e përgjithshme të shoqërisë nuk do lejojë që të harxhohet mundësia për përfaqësim të myslimanëve të këtij vendi nga ndonjë preteks absurd. Siç mund të jetë fjala bie insistimi për pensionim i dikujt dikujt dikujt duke qenë në ndonjë pozicion udhëheqës, që për pension të ketë koeficient më të lartë! Kjo sepse pa asnjë konspirim dhe prapavijë si frenim i ndonjë ndryshimi të nevojshëm për rregullimin e gjendjes në këtë institucion, herë-herë, paraqiten edhe kësi momente absurde.

Përmisimi do bëhet duke ruajtur çdo gjë në këtë institucion, edhe meritat por edhe sigurimin e pensioneve për të gjithë punësuarit, por duke e vazhduar kontinuitetin vetëm e të së mirës në te. Kurse ky përmisim do të bëhet duke aplikuar tajmingun i cili është gjithmonë i saktë për çështjet financiare që të jetë i saktë edhe për ndryshimet e nevojshme të cilat janë pasojë e statutit të ngritur të këtij institucioni pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Kjo gjë medoemos do të ndodhë sepse tani krejt kushtet për përmisimin janë pjekur dhe në BFI është arritur edhe kulminacioni i absurditetit dhe është kaluar edhe vija e lejuar e minimumit të funksionalitetit. Dy sinjale këto të cilat nuk janë kushte por gjithsesi janë paralajmërime të natyrës për ate se më keq nuk mund të bëhet. Për këtë dëshmi më eklatante ishin edhe ndodhitë dhe buja e fundit për të cilat kemi shkruar në vazhdimësi. Dhe gjithsesi përmisimi dhe rregullimi do të ndodhë para se të bëhet vonë, pra para se mos të mbetet as legjitimitet as funksionim minimal dhe gjithsesi as pensionim e as pensione!

Kjo sepse tani një dynja e tërë e ka kuptuar se dynjaja priset kur të priset feja kurse dy nga ndodhitë e fundit në Maqedoni janë shenjë e asaj se përveç të gjithave BFI është edhe pasqyrë. Pra një institucion ku njerëzit marrin shembull por edhe institucion i cili i vigjilon kufijt e mirësjelljes. E para nga këto dy ndodhi ishte kur një grup studentësh të fakultetit të medicinës pranë UT-së ngujuan rektorin e tyre kurse e dyta kur në Shkup, nevojtarët pranues të ndihmës sociale bllokuan qendrën sociale. Ndoshta si të mësuar me çudira në këtë vend ku ka ndodhur edhe rasti –tome pivara- nuk na ka tërheq vërejtjen se dy ndodhitë e sipërpërmendura ndodhën vetëm pas ndodhivë të fundit në BFI dhe në shumë çka ishin një reflektim nga precedenti i ngujimit të kryetarit të BFI-së, që ndodhi para më shumë se një muaji.

Krejt kjo janë fjalë për të qartësuar se kur priset dynjaja është prishë për të gjithë. Pra këto nuk janë fjalë për të vënë në pah se si hoxhë apo hoxhallarë kemi ndonjë “kartagjenë” profesionale të cilën duhet “pushtuar”. Kjo sepse botërisht dihet se decentralizimi i skajshëm eventual i autoritetit dhe legjitimitetit të BFI-së më së shumti do ju kuvendonte intereseve grupore

(na ruaj Zot!) apo individuale (na ruaj Zot!-dy herë) të hoxhallarëve, por më së paku vendit, kombit, shoqërisë dhe botës së tërë. Kjo është një zgjidhje e propozuar që mund të përshpejton dhe rrumbullakson proceset e nisura të ndryshimeve në BFI. Kjo është zgjidhja e shkruar dhe që është më afër kufirit të normalizimit të rrethanave në këtë institucion tejet me rëndësi për mbarë shoqërinë, nga grupe të ndryshme etnike që i njëjti mëton të i përfaqëson. Krejt mënyrat e pashkruara, heraherë duken më të kapshme, më të lehta por sjellin tjera implikime. Problemi i të pashkruarës është i njëjtë me zgavrrën prej ku Alisa futet në botën e çudirave, mandej krejt është njëllë, virtuale dhe krejt përsëritet deri në banalitet. Në fund nga krejt kjo nuk e pëson feja, ate e rruan krejt tjetër kush, por e pësojnë edhe mediat që botojnë shkrime anonime edhe politikanët që me koment komunikata apo ndikim, dëshirojnë të jenë aty dikund dhe ta dijnë bile emrin e kryetarit të ri, para se ai të zgjidhet dhe e pëson mbarë shoqëria. E pëson Alisa, lepuroshi që ja tregon rrugën asaj vazhdon të jet në botën e vet. E shpresa, shpresa është në ate se kur vjeshta vonohet dimri është më i shkurtër.

(shkrimi është pjesë nga artikujt e autorit të botuara në “Lobi” dhe revista tjera në Maqedoni)

Ramadan Ramadani,
10.12.2004

Kalendari hënor

Edhe para ardhjes së Islamit, arabët kanë përdorë kalendarin hënor. Ky kalendar – që është 11 ditë më i shkurtë se kalendari gregorian – nuk i pasonte sezonat (stinorët). Haxhxi në atë kohë të ardhurimit të idhujve ka qenë më shumë si një festival i madh, dhe pasi kalendari hënor nuk pasonte sezonat, Haxhxi është mbajtur në muaj të ndryshëm çdo vit. Kjo ka nënkuptuar se gjatë viteve të caktuara, Haxhxi ka ardhur në kohë kur gruri nuk ka qenë gati për korrije dhe kështu nuk ka qenë në shitje. Në këtë mënyrë ka prishur përgatitjet për të festuar këtë ngjarje.

Për këtë shkak arabët zbuluan një metodë për të tejkaluar këtë tollovi duke shtuar një muaj në kalendar në vite të caktuara. Ky metod u quajt kabisa - koha kur Haxhxi duhesh të arrijë dhe kështu u bë i ndryshueshëm, dhe njoftimi për datën e tij vazhdimisht bëhesh gjatë Haxhxit paraprak. Ky njoftim fillimisht ishte përgjegjësi e një personi të quajtur Kalammas. Kalammasi ishte nga fisi Beni Kinane, fis nga i cili Hashimi (464-546 e.s.) ishte pasardhës dhe i cili më vonë u bë baba (kryeplak) i fisit Kurejsh (fisi i Muhammedit, alejhis-selam). Kalamasi ishte poashtu përgjegjës për të njoftuar se cili muaj duhet të pasohet nga muaji plotësues, i trembëdhjetë. Të gjithë ata që e morën këtë detyrë për të njoftuar kohën e Haxhxit quheshin Kalammasa.

Kalendari hënor në Kur'an

Muhamedi, alejhis-selam, ka vendosur të mos vazhdohet praktika e kabisas dhe ka refuzuar kalendarin Kalammasi. Kalendari

hënor është përdorë ashtu siç është disejnuar nga Allahu dhe koha e Haxhxit ishte caktuar për ditë të njëjtë të çdo viti hënor.

Ky Ajet nga Kur'ani kërkon që kalendari hënor të jetë kalendar që duhet të pasohet nga muslimanët: "Ai e bëri diellin shëndritës, e hënën dritë dhe asaj (hënën) ia caktoi fazat, që ta dini numrin e viteve dhe llogarinë. All-llahu nuk krijoi këtë për tjetër, pos me qëllim të caktuar. Ai ia sqaron argumentet një populli që kupton". (Junus: 5)

Ndërsa në Ajetin e ardhshëm Allahu udhëzon muslimanët të caktojnë kohën e Haxhit: "Të pyesin ty për hënën e re (dhe fazat e saj) Thuaj: "Ato janë përcaktime të kohës për njerëz dhe për haxh..." (Bekare: 189)

Numri i muajve çdo vit, siç është urdhëruar nga Allahu ishte 12, siç shihet në këtë Ajet: "Te All-llahu numri i muajve është dymbëdhjetë (sipas hënës), ashtu si është në librin e All-llahut prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën..." (Teube: 9)

Caktimi i Fillimit të Epokës

Edhe pse kalendari hënor ishte përdorur gjatë kohës së Muhammedit, alejhis-selam; asnjë vit, nuk ishte caktuar të përdoret si fillimi i Epokës islame. Transmetohet nga lbën Abbas se njerëzit e Medinas kanë përdorë një ose dy muaj pas ardhjes së Muhammedit, sal-llahu alejhi ve sel-lem, si fillim të kalendarit të tyre, por kjo praktikë është ndëprerë pas vdekjes së tij. Asnjë epokë nuk është përdorë as gjatë Halifatit të Ebu Bekrit. Kalendari Hixhri nuk është përdorë deri në vitin e katërt të Halifes së dytë Omer ibën Hatab. Ahmed ibën Hanbel

dhe Buhari transmetojnë nëpërmjet Mejmun ibën Mihran se “një shumë e të hollave (borxh) i paguar në Sha’ban ishte prezen-tuar Omerit. Menjëherë pas kësaj Omeri ka pyetur në cilin Sha’ban, në të fundit, në këtë, ose në atë që vjen? Ofroni njerëzve diçka që mund ta kuptojnë”.

El-Hurmuzin, mbreti i dikurshëm i el-Ahvez (para arrestimit të tij nga muslimanët gjatë pushtimit të Persisë) i cili më vonë ka pranuar Islamin, ka sugjeruar përdorimin e kalendarit persik. Megjithatë, ai kalendar nuk u pranua nga muslimanët, pasi që nuk kishte ndonjë periudhë të caktuar, për shkak se epoka persiane ka filluar si e re pas ardhjes së çdo mbreti në fron.

Pas dëgjimit dhe analizimit të sugjerimeve të ndryshme, muslimanët janë pajtuar të përdorin Hixhrin (migrimin) e Muhammedit, sal-llahu alejhi ve sel-lem, nga Mekka në Medine si fillimi i Epokës Islame.

Dita e parë e muajit Muharrem të vitit 1 P.H. (Pas Hixhrit) përkon me 16 qershor e vitit 622 të kalendarit gregorian.

Hixhri është përdorë në vend të datlindjes së Muhammedit, sal-llahu alejhi ve sel-lem, ose datës së shpalljes së Kur’anit të Shenjtë, pasi që data e sigurtë e këtyre dy ngjarjeve nuk është ditur saktësisht. Data e vdekjes së Muhammedit, sal-llahu alejhi ve sel-lem, ishte ngjarje shumë e dhimbshme për ta përdorë. Për këtë shkak është vendosur që Hixhri të përdoret për të shënuar fillimin e kalendarit islamik.

Para kalendarit Hixhri, vitet janë emëruar sipas ndonjë ngjarjeje të madhe që ka ndodhur gjatë atij viti dhe ajo është përdorë si sistem i tyre për të llogaritur vitet. Përshembull, viti i parë i qëndrimit të Muhammedit në Medina është quajtur “Viti i lejes për të udhëtuar”. Viti i dytë është quajtur “Viti i urdhërit për të luftuar”. Viti i

tretë është quajtur “Viti i testit” dhe kështu me radhë. Ky sistem është hedhur poshtë pas vdekjes së Muhammedit, sal-llahu alejhi ve sel-lem, (Said, Hakim, 1984)

Dymbëdhjetë muajt hënor janë: Muharrem, Sefer, Rebi el-Evvel, Rebi uth-Thani, Xhumade Ula, Xhumade el-Ahir, Rexheb, Sha’ban, Ramadan, Sheval, Dhulkade dhe Dhulhixhxe. Numri i ditëve të çdo muaji ndryshon ndërmjet 29 dhe 30 ditë. Kështu që viti hënor përbëhet nga 354 ditë.

Kalendari Islam kohën e ndan në cikle prej 30 viteve. Në çdo cikël ka 19 vjet që kanë nga 354 ditë dhe 11 vjet që kanë një ditë shtesë, gjëgjësisht 355 ditë.

Muaji ka filluar pasi të jetë parë hëna e re. Hëna konsiderohet e re kur ajo fillon ciklin e saj të ri rreth Tokës. Hëna kalon nëpër faza, fillon me hënën e re, kalon në gjysëm, dhe të plotë dhe sërish prapa. Koha që hënës i nevojitet të kalojë prej hënës së re, në tjetër hënë të re, njihet si muaji sinodik, dhe zgjat mesatarisht 29.530589 ditë. Megjithatë, pasi Toka poashtu rrotullohet rreth diellit në të njëjtën kohë sa hëna e kompletion një cikël rreth tokës, vetë Toka ka kaluar të dymbëdhjetat e rrugës së saj rreth Diellit. Me qëllim që Hëna të kompletion ciklin e saj në hënë të re, ajo duhet të kompletion rrotullimin e saj dhe pak më shumë, që të kthehet në pozitën ndërmjet Tokës dhe Diellit sërish. Për shkak të dallimit të rrotullimeve të Tokës dhe Hënës, koha aktuale ndërmjet hënave të reja mund të sillet prej 29.27 deri në 29.83 ditë. (Hermit eclipse, 1995)

Dita dhe koha e çdo hëne të re mund të llogaritet saktësisht, mirëpo për të shënuar fillimin e Ramazanit në shumë shtete islame, hëna e re patjetër duhet të shihet me sy (pa ndihmë; pa mjet ndihmës). Megjithatë, në vend të shikimit me sy, disa shtete islame mbështeten në llogari shkencore.

Shikueshmëria e hënës së re varet nga disa faktorë, siç është lokacioni dhe përvoja e vëzhguesit si dhe sa i qartë është qielli në kohën e vëzhgimit. Zakonisht është vështirë të shihet hëna e re në ditën e parë të hënës së re. Hëna e re qëndron shumë poshtë në qiellin perëndimor pas perëndimit të diellit, ka ndriçueshmëri të ulët të sipërfaqes së saj dhe është shumë e hollë. Sipas Observatorit të Marinës amerikane, rekordi i shikimit të hënës së re me teleskop është 12.1 orë pas hënës së re; ndërsa për shikim me sy, rekordi është 15.5 orë pas fillimit të hënës së re. Këto janë vëzhgime të veçanta dhe se vëzhgimet e hënës së re kaq herët në muajin hënor nuk duhet të merren si norma.

Kalendari Islam, hënor në vend të atij diellor, ka një rëndësi të madhe për muajin e Ramazanit. Nëse kalendari i përdorur do të ishte diellor, muslimanët që jetojnë në një hemisferë do të kishin përparësi në agjërim në ditë më të ftohta dhe më të shkurta,

ndërsa muslimanët tjerë që jetojnë në hemisferën tjetër do të duheshin të agjërojnë ditë të gjata dhe të nxehta gjatë gjithë jetës së tyre. Mirëpo me kalendarin hënor, sezonat rrotullohen çdo 32 ose 33 vjet dhe vështirësia ose lehtësimi i agjërit ndahet baraz nga gjithë muslimanët anembanë botës. Ky kalendar poashtu mundëson rrotullimin e Haxhit në sezona të ndryshme.

Fillimi i Kalendarit islam me Hixhri tregon rëndësinë dhe veçorinë e kësaj ngjarje në historinë islame. Është një periudhë e sakrificës së madhe nga ana e muslimanëve dhe të durimit dhe ruajtjes së tyre. Për të filluar kalendarin me këtë vit në veçanti është në harmoni me mësimet e Islamit, që bazohen në vetë-sakrificë në emër të qëllimit më të madh dhe më të rëndësishëm. Kjo sakrificë e bërë nga muslimanët e parë, është bazë sipas të cilës muslimanët u bënë të fuqishëm dhe fjala e Allahut u shpërnda jo vetëm nëpër Arabi, por nëpër gjithë botën.

Aishe El-Avedi
solli në shqip: XH.A.
26.11.2004

Thirja islame në media

Përdorimi i mediave është bërë një nga mjetet më të sukseshme dhe të dobishme të komunikimit në këtë kohë. Kjo është për shkak të popullaritetit por dhe të qënurit e saj një armë me dy teha.

Nëse mediat, si radioja, gazetata dhe televizioni përdoren për davet dhe për t'i udhëzuar njerëzit tek Allahu dhe te ajo që ka sjellë Pejgamberi, atëherë kjo është një gjë e madhe e cila mund t'i bëjë dobi ymmitit kudo që janë, me lejen e Allahut. Kjo mund t'i bëjë dobi edhe jo-muslimanëve për t'i ndihmuar ata për të kuptuar islamin dhe për ta mësuar atë, mësuar meriat e tija dhe për të kuptuar që është rruga e vetme për suksesin në këtë botë dhe në tjetrën.

Është e obligueshme si për thirësit në islam, ashtu edhe për qeveritarët musliman të kontribuojnë për thirjen në islam, në çdo mënyrë që ata mundën, përmes përdorimit të radios, gazetës, televizionit dhe të ligjëruarit në grumbullime, ditën e xhumasë si edhe në ditë të tjera. Ata duhet gjithashtu të përdorin mjete të tjera për t'i bërë njerëzit për ta dëgjuar të vërtetën, në të gjitha gjuhët që përdoren nga njerëzit, kështu që daveti dhe këshilla të mund t'i arrijë ata kudo që janë në botë.

Shejh Abdul Aziz Ibën Baz (Marrë nga: "Words of advice regarding dawah", botuar nga el-Hidajjah, 1998)
3.12.2004

Mediat si "zotërues" të kohës

Mjetet e informacionit publik paraqesin një rëndësi të madhe në karakteristikat kryesore të postmodernizimit dhe e definojnë civilizimin ekzistues botëror të kohës sonë. Është e pamundur të kuptohet ndikimi dhe zgjerimi i postmodernizimit, pikëpamjeve, pakuptimësi dhe mangësi të tij, pa kuptuar esencën e medimeve.

Duke marrur parasysh faktin se natyra e shqyrtimit të diskutimit tonë është e paqartë, e padefinuar dhe e ndryshueshme, do të cekim vetëm disa orientacione nismëtare të tij, edhe pse mendojmë se është e pamundur që të jepet ndonjë konkluzion i forte dhe kompakt lidhur me të. Prandaj diskutimet tona paraqesin vetëm vërejtje hyrëse mbi këtë çështje dhe është e domosdoshme të bëhen hulumtime më serioze.

Gjatë historisë, medimet perëndimore kanë qenë rreziku më i madh i islamit: madje më shumë se baruti, trenat dhe telefoni, cilët kanë ndihmuar shumë në kolonizimin e vendeve islame, dhe kanosje më të madhe se aeroplanët, të cilët në fillim të këtij shekulli u paraqitën në vijat ajrore të vendeve islamike. Medimet perëndimore janë të pranishëm gjithnjë dhe në çdo vend, duke atakuar dhe analizuar vazhdimisht edhe pikën e dobët më të vogël.

Sulmet e këtyre medimeve të fuqishme paraqesin problem të dyfishtë për muslimanët. Si duket muslimanët nuk janë në gjendje të mbrohen, ose, çka është edhe më keq, se nuk mund as të kuptojnë esencën dhe qëllimin e këtij sulmi. Përpos kësaj, prijësit e tyre, të cilët nuk janë tjetër pas mburravecë të thjeshtë, dhe hulumtuesit matufë i prezantojnë në mënyrë tejet poshtëruese, sikur të ishin një turmë shkurtabiqësh cilët pëshpërisin kur

mbi kokën e tyre qëndron një vigan shumë i madh dhe i fuqishëm. Në realitet, vetëm qytetarët e thjeshtë muslimanë, mendja e shëndoshë dhe të kuptuarit instiktiv e të cilëve është më e sigurtë dhe më e pranueshme se e prijësve dhe shkencëtarëve të tyre, e kuptojnë fuqinë dhe nivelin e rrezikut. Një musliman i thjeshtë di fare mire për rafshin në të cilin është duke u zhvilluar kjo luftë dhe për kapacitetet e fuqisë që janë në luftë kundër tij. Mirëpo, mungesa e besimit ndaj prijësve të vet shton presionin që bëhet mbi të.

Ndofta në vitin 1258, kur Mongolët kishin arritur para portës së Bagdadit, për ta shkatërruar përgjithmonë mbretërinë më të madhe të Arabëve në historinë e tyre, ka mbretëruar një atmosferë e tillë. Në këtë kohë, ndonëse ishte shkatërruar dinastia e Abasidëve, pas tyre krijohen dinasti tjera me pozitë të ngjashme dhe me pallate kolosale e madhështore: Fatimidët në Egjipt, Omavidët në Spanjë, Safavidët në Iran dhe Mongolët në Indi. Mirëpo këtë here është vendosur ndryshe se nuk do të ketë më dinasti tjetër, nga se "demoni" është qenie hakmarrëse dhe xheloze. Në këtë diskutim do të përpiqemi të prezantojmë disa veçori dhe karakteristika të medimeve, për të kuptuar me këtë përgjigjen e islamit për kohën e postmodernizimit.

Njohja e esencës së "demonit"

Në raport me modernistët të cilët përpos njohjes së botës, janë përpjekur ta ndryshojnë atë, si duket postmodernistët janë më të matur dhe më modestë në qëllimet e tyre. Dëshira e tyre është ta rikonstruktojnë botën për ta njohur atë, na duket se është tejet vështirë edhe vetëm kuptimi i kësaj dëshire modeste.

Para disa vitesh, më saktësisht në vitet gjashtëdhjetë, dmth. Në kohën kur bota, në krahasim me horizontet që sot i ka përpara, ka qenë më e shëndoshë, më e parrezikshme dhe shumë më e pastër, themeluesi dhe paraardhësi i idesë mbi mediumet na ka paralajmëruar mbi ekzistencën e “teknologjisë elektrike” dhe mundësinë e saj që të bëhet “sistemi ynë qëndror nervor”. Ai ka paralajmëruar se mediumet janë duke u bërë porosia e vetme e mundshme, ndërsa pastaj mediumet e kohës sonë u bënë prijës dhe udhërrëfyes shpirtërorë, edhe atë prijës që kanë karakter demonik. Mediumet e kohës sonë, shikuar nga aspekti i ndikimit që ushtrojnë mbi neve, kapacitetit të tyre për ndryshimin e fakteve, thjeshtësimit të rrezikshëm të problemeve dhe ndikimit në ngjarje, konsiderohen si “demon” shpirtkeq, absolutisht i fuqishëm dhe i pranishëm, dhe, në realitet, shkaktar i ekzistimit të “frymës” dominante të kohës së postmodernizimit.

Akoma nuk janë të njohur mire esenca e këtij “demoni” dhe rreziqet që kanosen nga ekzistimi i tij. Për këtë arsye unë me vetëdije dhe qëllimisht po përdori termin “demon”. Gjatë viteve nëntëdhjetë, kur bota nxiton drejt fshatit teknologjik, çdo ditë është gjithnjë e më e madhe fuqia e këtij demoni dhe zgjërohet niveli i përçarjes mes popujve të ndryshëm. Liderët e ardhshëm më shumë do të dëshirojnë që gjithnjë pranë tyre të ndodhen ekspertët e hermenautikës, në mënyrë që, gjatë punës me mediume, t’i paralajmërojnë për rrezikun dhe që t’u japin këshilla të nevojshme në situata delikate kulturore.

Ne supozojmë se mbyllja jonë në suazat e mediumeve elektronike, të cilat paraqesin karakteristikat themelore të civilizimit dominues botëror, është situatë e definuar dhe e qartë. Mirëpo, më lejoni që të mos e thjeshtësojmë këtë fenomen kompleks dhe të mos

sjellim përfundim definitive mbi çështjet të cilat janë të paqarta dhe mashtruese.

Revista EKO “ECO” kështu e parashtron problemin e mediumeve: “Ç’janë mjetet e informimit publik? A janë mediume shpalljet në gazetë, sektori ndërkombëtar i televizionit ose një a dy fanela pa mëngë? Në realitet, na jemi ballafaquar jo vetëm me një, dy ose tri mediume, pora me një numër të madh syresh që veprojnë në suaza të rrjetëve të ndryshme. Mediumet janë bërë shumë-dimensionale, mirëpo disa prej tyre janë mediume të mediumeve, dmth. Veprojnë dyfishë.” (nr. 149, v.1987).

Prandaj më lejoni që edhe na të analizojmë më thellë esencën dhe mënyrën e veprimit të mediumeve. Hulumtimi preciz i esencës së mediumeve dhe studimi i tyre, do t’na zbulojë disa karakteristika dhe veçori që janë të fshehura në zemrën e këtij problemi. Në këtë mënyrë do të njihemi me paqartësitë, kontradiktat dhe paparashkueshmërinë e këtij fenomeni. Me këtë do të kuptojmë më mire esencën e këtij “demoni”.

I- Mjetet e informimit publik nuk njohin kurrëfarë ndjenje të lojalitetit ose miqësisë

Ndofta njëra ndër karakteristikat më të rëndësishme të mediumeve është jolojaliteti, ndërsa në realitet, paqartësia e tyre rrjedh nga kjo veçori. Na e dijmë mire se mediumet janë fuqi, forcimi i dominimit kulturor dhe përhapje e filosofisë politike. Ato janë armë shumë e rëndësishme e çdo vendi.

Gjithashtu, e dijmë mire se gjatë historisë, asnjë fuqi e madhe nuk ka përjetuar humbje për shkak të përdorimit të armëve të saj edhe atë nga armiku direkt, siç ka përjetuar Amerika gjatë krizës së Gjirit, edhe atë vetëm nga shkak se mediumet paraqesin shpatë me dy teha.

II-Mediumet janë, kjo është e qartë, raciste

Mediumet perëndimore janë nën kontroll të protestantëve të bardhë anglosaksonë (VASP). Yjet dhe heronjtë e medimeve duhet patjetër të jenë të bardhë, ose nëse kanë ngjyrë të mbyllët të lëkurës, ajo duhet të jetë e bronzë. Sytë e kaltër dhe flokët e bardha janë karakteristika të dëshirueshme. Persona të këqinj dhe të poshtër në medime janë, kryesisht, personat nga Azia. Zezakët pasqyrohen gjithënjë më një kallëp të njejtë: "Zezaku i keq" është përtac, hajn, rebelues dhe problematik, ndërsa "zezaku i mire është pop-këngëtar ose sportist. Në të ardhmen zezakët që janë korespondentë dhe drejtorë nga gjenerata e Spike Lee-ut, me siguri do ta përmirësojnë këtë moto (natyrisht kur të mundin hidhërimin dhe zemërimin e tyre).

Yjet e medimeve dhe heronjtë na ndihmojnë të kuptojmë këtë fakt (fantazimin ndaj një ngjyre të caktuar të lëkurës ose një race të caktuar). Nëse dëshirojmë që në bazë të programeve të medimeve të caktojmë listen e dhjetë personave më të njohur të botës, lista do të dukej afërsisht kështu:

...natyrisht kjo listë nuk është precise dhe e saktë, mirëpo njëkohësisht supozohet si listë postmoderniste. Në jetën e këtyre njerëzve baza morale ose shpirtërore është e vogël. Ata janë kryesisht njerëz tekanjozë dhe të çuditshëm. Shenjtëria dhe famoziteti i tyre është arritur përmes medimeve.

Krishterizmi, gjithashtu, është i lidhur në mënyrë jashtëzakonisht interesante për këtë botëkuptim racist. Për protestantët e bardhë anglosaksonë krishterizmi është burim shpirtëror i kuptimit të botës. Për shembull, krimet dhe pushteti i shejtanit (djallit), në shumë filma, siç janë "Thirrësi i fantazmave" dhe "Simptomi fatal", (edhe në vazhdimet e tyre dhe filmat me temë të

ngjashme), paraqitet si personazh ose temë qëndrore. Kryqi, symbol themelor dhe kryesor i krishterizimit, shfrytëzohet për të frenuar djallin. Me fjalë të tjera, jokrishterët janë të gjykuar me shkatërrim, nga se nuk posedojnë një armë të tillë. Çështja e ngjyrës së lëkurës, gjithashtu, manifestohet me këtë lidhje. Figurat klasike të shejtanit atë e paraqitin si qenie të zezë, dhe vetëm pas protestës së luftarëve zezak dhe ithtarëve të tyre, ngjyra e shejtanit u shndërrua në të kuqe.

Muslimanët pyesin: Tani që mediumet perëndimor kontribuan në disfatën e komunizmit, kush do të jetë armiku i ardhshëm i tyre? Përgjigja në këtë pyetje nuk është fare e vështirë: Islami. Islami akoma vazhdimisht izolohet dhe poshtërohet. Nga njëqind orë program të emituar televiziv, për islamin bëhet fjalë vetëm rreth dhjetë minuta, edhe atë duke prezentuar ata muslimanë që djegin librat ose ata që takohen nëpër tubimet e fshehta. Muslimanët ftohen rallë të marrin pjesë në emisionet e njohura televizive të cilat emetohen drejtpërdrejt, ndërsa i kushtohen problemeve universale dhe specifike.

Në shoqëritë tradicionale islame, mjekrra është simbol i diturisë, urtisë, modestisë, kredibilitetit dhe pushtetit. Në vendet islame nganjëherë të lëshuarit e mjekrës është i nevojshëm për ata në pozita në administratën shtetërore dhe shoqëri. Mirëpo mjekrra dhe mustakët janë të padëshirueshme dhe simbole të shëmtuarë për mediumet. Për këtë arsye personët fetarë muslimanë dhe hebrej nuk janë të mirëseardhur në mediumet perëndimore. Praktikisht, mediumet kanë ndaluar të lëshuarit e mjekrës. Prandaj, nuk mund të mendohet që një pop-këngëtar ose politikan të ketë mjekër, nëse pretendon që figura e tij të jetë e pranueshme për mediumet.

Hebretë, përkundër muslimanëve, janë bërë mjeshtrit më të mëdhenj dhe bartësit e mediemeve. Filmi “Mbretëria personale: Si e krijuan Hebretë Holivudin” pasqyron mjaft mire se si Hebretë, që sapo kishin arritur nga Europa dhe kryesisht ishin të varfër, madje as nuk e flitnin mire anglisht, krijuan vlera, modele dhe mite me ndihmën e cilëve ia dolën të pushtojnë të menduarit amerikan. Gjithashtu, kjo veprimtari e tyre kishte formuar dhe definuar vetëdijen dhe kulturën amerikane. Një numër i madh i ujeve më të mëdhenj të filmit amerikan janë hebretë: Gregori Pek, Elizabet Tejlör, Kik Daglas, Bert Lankaster, Pol Njumen e shumë të tjerë. Ata kanë ndikuar në formimin e idealit të bukurisë dhe joshjes së Holivudit.

III-Mediumet kanë lidhje të forta mes vete dhe mbrojnë njëri tjetrin

Filmat e pranuar nga të gjithë dhe tregimet, të cilat shygjerojnë ndjenjën e posedimit të trashëgimisë së përbashkët dhe unitare kulturore, transmetohen rregullisht dhe kështu bëhen të përjetshëm.

Mediumet me ndihmën e karakterit të fuqishëm të lidhjeve të ndërsjella, përforcojnë idetë, vlerat dhe pikëpamjet specifike. Kështu që një film që krijon sukses për një yll filmi, me vete bartë edhe bisdat televizive, intervjuimet në gazeta dhe revista të modes dhe pjesëmarrjen në reklamat propagandistike.

Burimet kryesore të kulturës perëndimore prej Homerit deri te Shekspiri, prezentohen në një mënyrë tejet të thjeshtë dhe të pranueshme nga të gjithë përmes filmave dhe dramave televizive. Kështu krijohet mundësia më e madhe për njohjen e tyre. Në filmat, serialët dhe komeditë serioze, pastaj në emisionet informative dhe komentet politike, gjithënjë potencohen këto burime kulturore. Kështu çdo gjeneratë i

komenton këto shkrimtarë në mënyrë të vet dhe me këtë arrin të vetëdija mbi trashëgimitë kulturore.

Disa fjalë dhe shpreje që janë përdorur në filma regjistrohen në “Leksikonin Oksfodian të shprehjeve dhe frazave të shquara bashkëkohore.” Dhe në këtë mënyrë bëhen të përjetshme si fjalia “ekzekutoje sërish Sem”, e cila është përdorur në filmin “Kazablanka” (1942). Burimi i këtyre fjalive janë filmat vestern, të vizatuar, shkencorofantastik dhe romancat lidhur me luftën e dytë botërore. Këto fjali përmes mediemeve janë ruajtur dhe i janë prezentuar botës si dhuratë kulturore. Këto fjali vazhdimisht imitohen, ritregohen dhe gjithëherë janë prezente në gazeta dhe revista.

IV-Mediumet e kanë përballuar vdekjen

Për vlerësimin e drejtë të këtij fenomeni, është e nevojshme që ai të shqyrtohet nga aspekti sociologjik dhe jo nga aspekti Hyjnor, ose në bazë të parimeve të cilat janë prezente në njohjen e jetës pas vdekjes. Vdekja e një ylli, në realitet, nuk e sjell në pyetje praninë e tij në medieme. Në medieme mbretrojnë një interesim serioz për paraqitjen e vazhdueshëm të atyre që kanë vdekur. Elvis Prisli është shembull gjegjës për këtë pohim. Kur vdiq Elvis Prisli, thuhej se ka bërë punën më të mirë në jetën e tij profesionale.

V- Mediumet vërtetë janë demokratike dhe paraqesin “njeriun e zakonshëm

Parimi demokratik i cili është prezent në thelbin e mediemeve reflekton ekzistencën dhe prejardhjen e mediemeve në demokracinë perëndimore. Mediumet nuk i japin rendësi rangut, fuqisë, ose madje pozicionit të mbretërive. Pozicioni dhe gjendja e mbretërive, për shkak të esencës së tyre specifike mund të jetë e respektuar, por edhe objekt i kritikës së ashpër. Mirëpo rallë mund

të zbatohet edhe njëra edhe tjetra. Megjithatë, për shkak të ndikimit të mediuve është e vështirë ruajtja e distancës respektive dhe serioziteti të personalitetit, të cilat janë të domosdoshëm për ekzistimin e mitit mbi mbretërinë.

VI-Mediumet i paraqesin të vërtetat më të çuditëshme se përrallat dhe kështu ato bëhen më të pëlqyeshme për dëgjim dhe shikim

Lajmet televizive prezentohen në atë mënyrë që mund të garojnë me programet më të mira teatrore dhe filmore. Emitimi i lajmeve, që zakonisht zgjatë rreth një orë, me muzikë joshëse, me udhëheqës të cilët janë të popullarizuar si yjet e filmit, me shfrytëzimin e fotografive arkivore dhe raportet nga mbarë bota që transmetohen në mënyrë direkte, fascinojnë shikuesin. Mediumet munden fare lehtë t'i shëndërronjë emisionet ditore informative në emisione spektakulare të shout. Spektatorët e televizionit më shumë dëshirojnë t'i shikojnë lajmet se programet tjera argëtuese dhe skenike, në rastet kur lajmet kanë më tepër karakter të një emisioni të shout...Paraqitja e të vërtetës dhe fakteve është bërë më interesant se paraqitja e ndonjë tregimi ose përalle, ndërsa shkaku është fare i thjeshtë: është e domosdoshme të tërheqet vëmendja e spektatorëve në mënyrë adekuate, përndryshe ata me një të shtypur të sustës do të ndërrojnë programin.

VII-Mediumet informative sillen në mënyrë tejet të vrazhdë dhe të ftohtë ndaj qëndrimeve morale dhe porosive intelektuale

Ata fare lehtë janë në gjendje që në një moment të paraqesin tablo nga festa e Kërshëndellave në Amerikë, ndërsa menjëherë pas kësaj të emetojnë pamje mbi skamnorët në Etiopi. Këtë mënyrë e sjelljes krijon probleme të caktuara. Këto fotografi të shkurtëra nuk munden kurrësesi të

përshkruajnë gjendjen komplekse të shoqërisë amerikane dhe etiopiane. Me të shikuar këto fotografi kontradiktore parashtrahet pyetja: Në çfarë mënyre mund t'i lidhim këto fotografi dhe cili është qëndrimi ynë lidhur me to?

Reklamat propaganduese televizive janë shembull i mirë i krahasimit të fotografive të ndryshme dhe kontradiktore. Trupat e bukur dhe harmonikë që rrinë të shtrira pranë pishinave; ose mbështeten për automobila dhe pijë pije freskuse, janë simbole të pushimit me sy. Shpenzohen mjete, energji dhe planifikime kolosale për këto fotografi të shkurtëra. Na tretemi fort në këto pamje dhe mënyrën e transmetimit të tyre, sa fare lehtë hallojmë qëllimet e tyre morale dhe politike, duke ditur që nga Azia e deri në Afrikë akoma ka me mija e mija njerëz vdesin nga uria. Ky shpenzim i kotë dhe teprim me reklama e pasqyrojnë shumë mire mosinteresimin e tyre për popujt dhe shoqëritë e mjerë dhe të varfër. Këto fotografi djallëzore na magjepsin dhe njëkohësisht na ngjallin ndjenja të averzionit e zemërimit.

Mediumet adhurojnë agresivitetin dhe me plot kënaqësi, gjërësisht transmetojnë skema të vrasjes dhe të shtënave. Ngjyra e kuqe e gjakut dhe ngjyra e verdhë e zjarrit krijojnë skema jashtëzakonisht tronditëse dhe efektive. Brenda një momenti të shikimit të skenave të tilla, agresioni bartet nga një fshat i Azisë jugore ose nga një qytet i Europës lindore në dhomat tona të ndejës.

VIII-Mediumet në mënyrë teknologjike janë jashtëzakonisht të fuqishëm, mirëpo janë shumë të dobët në aspektin e njohjes kulturologjike të njerëzve

Lufta e Gjirit është dëshmi e këtij pohimi. Në kohën kur teknologjia e fuqishme na ka informuar prej çastit në cast mbi ngjarjet luftarake lidhur me Gjirin (si numri sulmeve

ajrore, mënyra e përparimit të forcave ushtarake, anijet dhe tankset luftarake), ndjehej një vakum i analizimit të drejtë të rolit të ngjarjeve të rëndësishme socialo-kulturore. Mënyra e sjelljes së Sadam Huseinit ndaj fëmijëve gjatë kohës së bisedave të tij televizive në vitin 1990, i cili tani është diskredituar, e tregojnë këtë më së miri. Dy shoqëri që kanë qenë të përzierë në këtë ngjarje, dmth. Kultura arabe dhe civilizimi perëndimor, e komentoni këtë sjellje në dy mënyra esencialisht të ndryshme, ndërsa rrënjët e këtij dallimi në komentim duhet kërkuar në esencën e kulturës së tyre. Dallimet në mënyrën e komentimit të këtij problemi, në realitet, e kanë thellur mospajtimin ndërmjet këtyre dy kulturave.

Në fund duhet potencuar se mediumet në botën moderne luajnë rol të rëndësishëm në çështjet ndërkombëtare me mundësi akoma më të madhe të zgjerimit të dimensionit të veprimit të këtij roli.

Ekspertët e medimeve, vetë sipas zgjedhjes dhe mendimit të tyre emitojnë porosi të caktuara. Ndonëse është problem kompleks për shkak të essences së dyfishtë të medimeve, megjithatë vazhdohet tentimi i qeverisë për të gjetur zgjedhje të cilat do t'i sigurojnë pozitën më të favorshme. Gidnezi lidhur me këtë përmend suksesin e Shteteve të Bashkuara, duke shfrytëzuar emërtimin "imperializmi i medimeve" (1989). Ai gjithashtu na paralajmëron se sidomos "vendet e botës së tretë janë të rrezikuara më së shumti, nga se nuk posedojnë burime të cilat do t'u ndihmonin të ruajnë pavarësinë e tyre kulturore."

Atë që nuk ka arritur ta bëjnë fuqia politike amerikane, mediumet ia kanë dalur, ndërsa atje ku Pentagoni ka qenë krejt i pafuqishëm, ia ka dalur Holivudi. Lidhjet ndërmjet këtyre dy nocioneve bëhen të

qarta vetëm kur të dihet se filmat argëtues dhe armatimi janë artikujt më profitabil eksportues të SHBA-ve. Konsiderohet se suksesi më i madh i medimeve Perëndimore është shkatërrimi i komunizmit dhe rrënimi i struktures së tyre të moçme unike. Mediumet, me propagandë të vazhdueshme dhe me talentin e jashtëzakonshëm për të kritikuar dhe ironizuar, goditën rrënjët e botës komuniste. Rrënia e komunizmit është planifikuar me vite të tëra para paraqitjes së Gorbaçovit.

Këtu ekziston një teori e cila kërkon hulumtim dhe shqyrtim: në botën bashkëkohore, sa më shumë tradicionale që është një kulturë, as më tepër do të bëjnë presion mediumet mbi te. Andaj më së paku presion bëhet ndaj krishterizimit, ndërsa më së shumti ndaj islamit. Të gjitha religjionet tradicionale, prej budizmit dhe hinduizmit deri te islami dhe krishterizmi, propagojnë nderin, kontemplacionin dhe misticizmin. Përkundër kësaj, sulmet e gjithëmbarshme dhe të pamëshirshme të medimeve paraqesin kërkesë të turpshme për materializëm, me propagimin e manures konsumuse të jetës dhe marrjen me gjëra të pakuptimta dhe padobishme në jetë. Reglamat joshëse, yjet e pispillosura dhe rrebeshi i ngjyrërave, atakojnë shtëpitë si vërshim duke fundosur idetë e ndershme. Pas kësaj njerëzve ia vjedhin virtytet më subtile, respektivisht, nderin dhe krenarinë. Idea postmoderniste nuk i lejon askujt të ketë nder dhe dinjtet në këtë botë të pamëshirshme, pandershme dhe zhurmëmadhe.

Kontrasti ndërmjet emisioneve të mirënjohura muzikore dhe himneve tradicionale fetare në kisha janë shembull i mire për krahasim, ...Tani më nuk ekziston besimi dhe nderi të cilët dikur i karakterizonin njerëzit. Prandaj nuk është vështirë të kuptohet përse

muslimanët e refuzojnë postmodernizimin si “anarkizëm” dhe “nihilizëm”

Për mediet perëndimore, civilizimet “për qark”, dhe jo vetëm muslimanët, gjithnjë janë paraqitur sipas një shabloni. Për perëndimin murgjit gjysëmlakuriq, të cilët vazhdimisht luten, janë manifestimi i vetëm i hinduzmit dhe budizmit, dhe ata si reminishenca të papranushme dhe të panjohura nga e kaluara, i dëbojnë nga mediet. Natyrisht, disa prej tyre kanë arritur që me afrimin nga Perëndimi, të arrijnë atje sukses të dukshëm.

Ajo që dëshirojë të theksoj është roli i medieve si pasqyrim i pushtetit dhe simbol i suksesit të kulturës, përhapjes së grindjeve politike dhe, në realitet, si atu kryesor. Me ndihmën e medieve, jo vetëm që mund të mundet armiku me lehtësi, por me të privuarit e tij të mundësisë së shfrytëzimit të medieve, mund të krijohen aso kondita që ekzistenca e tij të harrohet fare. Prandaj mediet paraqesin njërin nga armët më të rëndësishme të çdo vendi. Ky është leksioni më i madh i kohës sonë, leksion të cilin kanë dashur të na imponojnë një kohë të gjatë ekspertët siç ka qenë Mak Lohan, Komoli dhe Narboni. Mediet gjithashtu janë përgjegjës për ndryshimet kryesore në drejtimin tjetër. Ekuilibrimi, esenca, stabiliteti dhe mënyra specifike e jetës në familje ngadale ndryshon. Mbase nuk mund të paraqitet lidhja ndërmjet familjes dhe medieve në mënyrë të kënaqshme, mirëpo një gjë është e padyshimtë e ajo është vëllimi i ndryshimeve dhe shkatërrimeve që ngjajnë në familje.

“Demoni” dhe rrënimi i sistemit të familjes

Të gjithë ata që jetojnë në Perëndim, janë të njoftuar me skenat të cilat janë të shumtën alarmante dhe flasin mbi situatën e pavolitshme. Këto skema pasqyrojnë thellësinë e

kalbësirës dhe amoralitetit të shoqërisë. Mirëpo, nuk është në rregull nëse mendojmë se këto skena janë simbole dhe prezencione të Perëndimit. E kemi shqyrtuar fatin “eksploziv” të civilizimit perëndimor, e cila gjithashtu ndikon në kulturën dhe politikën e viseve tjera të botës. Ndonëse, nga njëra anë, Perëndimi është dominant dhe ngadhënjimtar në skenën botërore, nga ana tjetër, bërthama kryesore e sistemit shoqëror të njerëzimit, respektivisht, familja, në këtë kulturë ndodhen në rrezik të madh.

Njëri ndër konfliktet më kryesore të muslimanëve në Perëndimin është lidhur me shkatërrimin e sistemit të familjes në Perëndim, nga se në islam familja është pjesë e rëndësishme e shoqërisë dhe çdonjëri pjesëtar i familjes ka rolin dhe detyrën e caktuar. Uniteti dhe stabiliteti i familjes janë të dëshirueshme. Muslimanët e kuptojnë fare mire presionin e kulturës konsumuese të Perëndimit, indolencën seksuale, drogën dhe... , të cilat në masë të madhe kanë dëmtuar institucionin e martesës në Perëndim dhe janë të brenjosur se këto presione mund të arrijnë në shtëpitë e tyre. Mirëpo, në lidhje me këto ndryshime ekzistojnë vetëm disa studime të kufizuara sistematike. Muslimanët kanë frikë se feja mund të jetë plotësisht nën hije të botës, nga se kjo çështje do të jetë tragjike kur të kihet parasysh botëkuptimi i muslimanëve mbi sistemin e drejtë dhe të ekuilibruar shoqëror.

Përse muslimanët, dhe në veçanti prindërit, frikohen në atë masë nga mediet e reja perëndimore? Për arsye se këto mediet janë të fuqishme dhe universale, se kanë disponim armiqësor ndaj islamit dhe fare lehtë mund të futen në shtëpitë muslimane.

Civilizimi islam ka bërë filozofë..., gnostikë..., poetë ... dhe godina siç është Taxh Mahalli. Mirëpo, në botën bashkohore, vetëm muslimanët janë të pafuqishëm në vlerësimin adekuat të fuqisë dhe ndikimit të tërësishëm të medimeve perëndimore. Kjo është për t'u habitur, nga se, edhe pse këto medime janë nën patronatin dhe kontrollin e Perëndimit, disa vende islame si Egjipti, Pakistani dhe Irani, prodhojnë filma dhe programe televizive të kualitetit të lartë.

Si duket muslimanët për shkak të fuqisë dhe sjelljes agresive të medimeve perëndimore, si dhe për shkak të qëndrimit të tyre kundër islamit, kanë humbur fuqinë e kundërshtimit dhe madje nuk mund të prezentojnë atë që dijnë mbi faktet e jetës së tyre. Shembëlltyra që e kanë njerëzit e botës mbi islamit janë të determinuara nga fotografitë televizive, fjalët armiqësore në gazeta dhe satira e pamëshirshme. Muslimanët nuk kanë vend në medime dhe për ata nuk është paraparë kurrëfarë tribuni. Prandaj ata nuk kanë rast të protestojnë të paraqesin arsyetimet e veta. Të shprehurit e identitetit kulturor nga ana e muslimanëve konsiderohet fantazëm, si kërkesa e tyre për fitimin e të drejtave legjitime që konsiderohet fundamentalizëm. Në këtë lojë, në të cilën duken të dobët dhe të pafuqishëm, muslimanët nuk kanë shans për fitore. Prandaj dëshpërimi i tyre manifestohet si mllef dhe agresivitet, ndërsa ata përkatësinë e vet islamike e shprehin me metoda të cilat në esencë janë kundër islamit.

Tani në konflikt me islamit manifestohen shpirtëligësi të shumta: edhe fanatizmi i Perëndimit kundër kishës zyrtare krishtere dhe kundërshtimi me pakicat fetare siç janë Hebrejt.

Ekzistojnë shumë botëkuptime të gabueshme lidhur me islamit, si për

shembull, se islami e udhëheqëin klerikë fantikë dhe të pa informuar (profane) dhe se islami i urren femrat. Siç kemi vërejtur tani më, të dy këto botëkuptime janë të gabueshme.

Perëndimi sot në masë të madhe sërish merret me ato çështje të cilat islami nuk i ka përqafuar kurrë, si për shembull konsumimi i mjeteve të narkotizmit. Më e rëndësishmja është fakti se medimet rrezikojnë stabilitetin e familjes, e cila është epiqendër e strukturës shoqërore të islamit. Çkurorezimi, dyshimi në kompetencat e prindërve, izolimi dhe marginalizimi i çështjeve të personave të moshuar, ndryshimet e vazhdueshme në shtëpi dhe jetë si dhe çështjeve lidhur me këtë, dobësojnë familjen. Muslimanët këto ndryshime i shikojnë me brengosje të madhe.

Tani për muslimanët shtrohet një pyetje e drejtë: Përse duhet të orientohen drejt provimit shoqëror për të cilin që më parë e dijnë se nuk është në harmoni me qëndrimet e tyre? Përse duhet të flinë jetë e tyre familjare për vlera sipërfaqësore, edhe pse këto vlera janë bindëse? Kjo pyetje janë shtuar me të drejtë.

Strategjia e muslimanëve

Reakcioni i muslimanëve ndaj postmodernizimit është shumë e ngjashme me reacionin të cilin e kishin pasur para një shekulli: tërheqje e përcjellur me emocione të fuqishme fetare dhe mllef i madh. Para kësaj ata kishin ikur në male dhe shkretirë për t'u mbrojtur nga Europa kolonialiste dhe atje kishin gjetur veten me ndihmën e fuqisë së traditës dhe kompaktësisë së zakoneve të tyre. Nga pikëpamja europiane, muslimanët në qëndrueshmërinë e maleve dhe shkretirave të tyre kishin gjetur strehim të sigurt për vete, që ishte jashtë rrezikut nga europianët, e këto ishin vende jashtë suazave të tutorisë, rregullave dhe ligjeve

kolonialiste. Muslimanët kërkonin strehim në të kaluarën, sikur e tanishmja të mos kishte ekzistuar kurrë.

Mirëpo, sot ekziston dallim i madh. Ndonëse muslimanët para një shekulli kanë mundur që për mbrojtjen e unitetit dhe kompaktësisë së jetës së tyre, të ikin në male dhe shkretira, tani vendqëndrimet e tyre më nuk janë të sigurta, ndërsa progresi teknologjik ka pamundësuar ikjen e mëtutjeshme. Satelitët mund të përcjellin çdo deve në shkretirën arabe, raketat e kontrolluara me laser mund të goditin çdo shtëpi në kanjonet më të largëta të Avganistanit, edhe video-rekorderët janë të pranishëm gjithëkund, prej tendave shkretimore deri te fshatrat malore.

Muslimanët që jetojnë në fise kanë qenë gjithnjë më të shkathët në njohjen e strategjisë nga bashkatdhetarët e tyre të qytetit. Ata shumë shpejtë vërejtën se mediumet janë faktor i cili mund të shkaktojë çrregullime në jetën e tyre tradicionale. Për këtë arsye, deri para disa vitesh në "Tiri", që ndodhet në një krahinë fisnore të Pakistanit, në mënyrë solemne madje e kishin thyer edhe një radio si simbol të modernizimit. Mirëpo, sot nuk mund të pengojmë depërtimin e medimeve as në vendet më të largëta, siç është "Makrani", i cili ndodhet në krahinën Baluçestan në Pakistan. Makrani është njëri ndër teritorët më të largëta dhe më të paarrtshme të botës arabe. Ky është një teritor i madh me numër të vogël banorësh., ku akoma nuk ka rrymë dhe, natyrisht, as televizor. Nuk ekzistojnë as hekurudha, as rrugët magjistrale që do të lidhnin këtë teren me pjesët tjera të Pakistanit. Në realitet, Makrani ka ndryshuar fare pak nga ajo kohë kur Aleksandri i Maqedonisë atje kishte humbur rrugën në të kthyer prej Indisë.

Madje edhe islami atje ka qenë i shtrembëruar në bazë të traditave lokale dhe është i mbuluar me padituri. "Zikiri", që janë sektë lokale, madje kanë krijuar Mekën, haxhin, Ka'abën, si dhe pejgamberin e vet të Zotit. Mirëpo, atje fare lehtë mund të gjeni filmat e huaj më të rinj dhe me amorale. Agregatët për prodhimin e rrymës dhe videorekorderët janë ndër gjërat e para që blejnë ata që janë në gjendje të mire materiale. Kur në vitin 1985 vizitova fshatrat më të largëta të kësaj krahine, vura re se shumica e familjeve fshatare posedojnë videorekorderë. Akoma nuk janë bërë analiza dhe hulumtime lidhur me ndikimin e vlerave të reja në shoqëri të tilla të cilat ekzistojnë me shekuj.

Njëra ndër karakteristikat e qarta të kësaj periudhe të historisë së muslimanëve është lidhja e institucioneve dhe qendrave, të cilët në shikim të parë duken pa lidhje. Hulumtimi i kësaj lidhje ndër muslimanë edhe më shumë e përhap teorinë e komplotit kundër tyre dhe shkakton që ata të mendojnë se ekziston ndonjë komplot botëror me qëllim të dëmtimit dhe shkatërrimit të tyre. Mediumet janë ata që mund të krijojnë një lidhje të tillë të ndërsjellë.

Bankrotimi i bankës BCCI, e cila ka qenë në pronësi të muslimanëve (paratë arabe, ekspertët pakistanezë:, në korrik të viti 1991, si rezultat ka pasur reagimin zinxhiror të shkatërrimit që përfshiu revistën "Jugu" (South) dhe "Ordu Center" në Londër, pronare e cilëve ka qenë kjo bankë. Raportet në shtypin dhe televizionin perëndimor vetëm e kanë shpejtuar këtë process. Këtu kanë qenë të gershtetuar kultura dhe problemet financiare, investimet, politika dhe paratë. Shkatërrimi i njërit, shumë shpejtë ka kushtëzuar shkatërrimin e tjetrit.

Karakteristikë tjetër e dukshme e kësaj periudhe historike të muslimanëve është paraqitja e yjeve të mediemeve. Para kësaj popullariteti në shoqëritë muslimane ka qenë privilegj ekskluziv i liderëve politikë dhe feudaleve. Dikur në qarqet dhe shoqëritë elite i përqeshnin dhe i fyenin aktorët ose këngëtarët si njerëz pa rrënjë. Nga kjo arsye, para disa vitesh, disa yje të shoqëruara muslimanë, në Indi zgjedhnin për vete emra hindusë dhe kështu fshenin origjinën e tyre muslimane. Mirëpo, sot aktorët e vendeve islame, që janë bërë të njohur me ndihmën e mediemeve, fitojnë shumë, ndërsa artistët më të mirë marrin të ardhura që janë shumë mbi suazat lokale. Investimet kolosale në këtë fushë kanë kuptime të ndryshme, gjë që tregon se ka ndryshuar botëkupimi i muslimanëve mbi argëtimin dhe njerëzit e zakonshëm gjithënjë e më tepër marrin pjesë në jetën kulturore dhe vetë ndikojnë në te. Gjithashtu, tregon se koha e mediemeve ka zënë fill edhe në shoqëritë muslimane. Muslimanët duhet të ballafaqohen me këtë realitet se tani më nuk mund atë të ikin nga ku “demon”, as mund të izolohen dhe kërkojnë strehim.

Koha e postmodernizimit gjatë viteve nëntëdhjetë po troket në derë të ixhtihadit (zbatimi i jurisprudencës fetare) muslimane.

Mirëpo, muslimanët para se të hapin derën, duhet të njohin esencën dhe fuqinë e kësaj kohe, andaj duhet të njihen me ata që janë simbole të kësaj periudhe. Këto simbole përfshijnë edhe ata të cilët nuk janë aq të mirëseardhur ndër muslimanë.

Shumë më me rendësi është fakti se muslimanët tani më e kanë kuptuar përse mu këta njerëz përfaqësojnë kohën tone. Sulmi është efikas aty ku muslimanët janë më të dobët: sunduesit e prishur dhe maliciozë, drejtorët dhe përmbauesit e paaftë dhe mendimtarët e varfët gjithashtu janë ndër këto pika të dobëta. Pa marrë parasysh rrëfimet e zakonshme, fryma e islamit mungon dukshëm në tentimet dhe veprimet e tyre. Prandaj, në këtë situatë, ixhtihadi është më se i nevojshëm...

Pastrimi i shoqërisë muslimane nuk është i mundur pa kuptuar mirë kohën jomuslimane në të cilën po jetojmë.

Akbar Ahmed

Shkëputur nga: “Islam and post-modernism”

(Demoni i keq-mjetet e informacionit si zotërues të kohës)

Shqipëroi: Dr. Selim Sylejmani

Botoi: Drita e jetës-Gjilan

10.12.2004

Shkaqet e rehatisë shpirtërore

All-llahu, subhanehu ve teala, njeriun e ka krijuar në këtë jetë dhe i ka lehtësuar shkaqet, të cilat i shkaktojnë mirësinë e jetës së zemrës dhe trupit, nëse i shfrytëzon mirë dhe si duhet, nëse e stërvit vetveten në këto gjëra, pasi që njeriu është në luftë të pandalur në këtë jetë.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Vërtet, Ne e krijuam njeriun në vështirësi të njëpasnjëshme". (El-Beled: 4).

Në luftë kundër nefsit të tij, egos, në luftë kundër shejtanit dhe cytjeve të tija, në luftë kundër vështirësive, telasheve dhe problemeve të jetës, herë herë fiton e herë herë humb, herë gëzohet e herë mërzitet, herë qeshet e herë qan, e kështu me rradhë. Jeta për askend nuk e pastër për askend.

Njerëzit dallojnë në betejat e tyre në këtë jetë, disa janë të ngadalshëm, e disa nxitojnë në luftë kundër egos së tyre, andaj edhe vuajnë, shtoja kësaj edhe mundësinë e kthimit të njollave të jetës herë pas here.

Kjo situatë i përsëritet secilit njeri, madje nëse thua se nga kjo nuk shpëton askush, nuk do të kishe gabuar, edhe pse dallojnë në sasi.

Ngushtimi i gjoksit, streset dhe vështirësitë që i vijnë njeriut, e kaplojnë secilin prej nesh, disa u zgjat ma shumë e disave më pak.

Nëse njeriun e kaplon kjo gjendje e gjen të mërzitur, të brengosur, i është ndryshuar gjendja, edhe veten nuk e duron, nuk ka oreks as për ushqim e pije, qajtje dhe mërzi,

vetmi dhe trishtim, diken e mund egoja e tij, e i ankohet secilit me të cilin rrin dhe bisedon, duke mos u përpjekur për ta luftuar veten as për një çast.

Ata që qëndrojnë me te shohin petkun e brengës dhe ngushticës mbi te, i nënshtrohet tërësisht shejtanit, e shpalos dëshpërimin, demoralizimin dhe ankesën, i mbyll shumë dyer të rrugëdaljes dhe tejkalimit të krizës, madje disa edhe më shumë i nënshtrohen shejtanit, sa që mer vendim për të bërë hapa që definitivisht do tia ndërrojnë kahjen e jetës, siç është divorcimi i gruas, lërja e punës, ndërimi i banesës, e shumë gjëra që lidhen me këto hapa, sa që dikush arrin deri te vendimi për vetvrasje. Tërë kjo tregon se mashtrimet e shejtanit ndaj tij janë shumë të mëdhaja.

Pa dyshim se brenga ka shkaqet e veta, qofshin ato shpirtërore ose emocionale, mirëpo mund edhe ta befason njeriun, e mos tia din shkakun.

Qëllimi është me tregu se ngushtica e gjoksit disa herë njeriun e ban peng të cytjeve dhe halucinacioneve, e kështu i ngrati mbetet peng i shejtanit, i cili është në epërsi ndaj tij me fuqinë e pshtjellimit të gjërave dhe këtij i dobësohet rezistimi i tij.

Musliman të nderuar!

Pasi që kjo gjendje i ka kapluar shumë muslimanë, ndikon në adhurimet dhe sjelljen e tyre, andaj është e arsyeshme të flasim për shkaqet që i ndihmojnë njeriun për të poseduar zemërgjërësi, tia largon atë

mbulesë të zeza nga zemra e tij dhe ta bën që ta ndien rehatinë dhe qetësinë shpirtërore dhe zemrore.

Duke kërkuar ndihmën dhe suksesin nga All-llahu themi se shkaqet e zemërgjersisë janë të shumta, në këtë takim do të mjaftohemi me përmendjen e vetëm tetë prej tyre, me shpresë se do ti kaplojnë edhe ato që nuk janë përmendur.

1- Forca e tevhidit

Pa dyshim se prej shkaqeve më të mëdha për zemërgjersi dhe largim të brengës është forca e tevhidit dhe dorëzimi i tërë çeshtjeve tona All-llahut, az-ze ve xhel-le. Duke besuar me një besim të prerë dhe të paluhatsëm se vetëm All-llahu është Ai që sjell të dobishmen dhe e largon të dëmshmen, dhe se Atij ska kush ia kthen caktimin dhe ska kush ia kundërshton gjykimin, është i Drejtë në Gjykimin e Tij, i jep kujt të dojë me drejtësi dhe askujt nuk i ban padrejtësi Zoti yt. Andaj njeriu duhet ta mbush zemrën me këtë besim dhe gjërat që kanë të bëjnë me këtë gjë, sepse në momentin kur bëhet i këtillë All-llahu ia largon brengën dhe ia zëvendëson frikën me siguri.

Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë:

"Dashuria ndaj All-llahut, njohja e Tij dhe përmendja e Tij vazhdimisht, qetësimi me Te dhe veçimi i Tij me dashuri, frikë, shpresë, mbështetje dhe raporte, në asi forme sa që Ai ti zotëron të gjitha brengat e njeriut, vendosjet dhe dëshirat e tija. Kjo është xhenneti i dynjasë, begatia që nuk krahasohet me asgjë, është kënaqësia e të dashuruarve dhe jeta e njohësve".

2-Mendimi i mirë për All-llahun

Mendimi i mirë për All-llahun domethënë ta ndiesh se All-llahu është Ai që ta largon brengën, ta eliminon ngushticën, sepse atëherë që njeriu ka mendim të mirë për All-llahun, All-llahu i hap bereqetet e Tija nga

nuk mendon njeriu. Andaj, rob i mirë i All-llahut, ke mendim të mirë për Te, do të shohish gjëra që të gëzojnë.

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "All-llahu tebareke ve teala, ka thënë: Unë jam te mendimi i mirë i robit Tim për Mua, nëse mendon mirë, këtë e fiton, nëse mendon keq, këtë e fiton". (Sahih, Ahmedi dhe të tjerët).

Për këtë ke mendim të mirë, lidhe shpresën për Te, kujdes nga mendimi i keq, sepse është vepër që të shkatërron.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"... mendimi i të cilëve ndaj All-llahut ishte mendim i keq. Atyre u rraftë e keqja! All-llahu shprehu urrejtje kundër tyre dhe i mallkoi e xhehennemin e përgatiti për ta, që është vendbanim i keq". (El-Fet'h: 6).

3- Lutjet e shumta

Lutja e shumtë dhe insistimi në te kur ke ngushticë, ose brengë, ti ngrish duart e përkuljes para All-llahut, ti shpalosish ankesat dhe mërzitë tuaja Atij, të lotosh para Tij, duke e ditur se Ai, All-llahu është më i mëshirshëm ndaj teje se sa që është i mëshirshëm nëna dhe babai yt, se gruaja dhe fëmijët tuaj, është element shumë i rëndësishëm në largimin e brengës dhe ngushtisë.

Omeri radijall-llahu anhu, tregon:

Erdhën para Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, disa robër. Një grua e cila ishte gjidhënëse, kur e gjeti foshnjën e vet, e mori, e ngjiti për barku dhe i dha gji. Atëherë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: A ka mundësi që kjo grua ta hedh foshnjën e saj në zjar? I tham: jo, nëse ka mundësi mos ta hedhë. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: "All-llahu është edhe më i mëshirshëm me robërit e Tij se sa kjo ndaj foshnjës së saj". (Buhariu).

4-Nxitimi për të ikur nga mëkatet

Kontrollolo nefsën dhe nxito për të ikur nga mëkatet, nëse dëshiron rrugëdalje nga kjo krizë në të cilën gjindesh. Si ka mundësi të kërkosh rrugëdalje kurse je i zhytur në mëkatet? Habi puna yte! Kërkon nga All-llahu nevojat tuaja, kurse i haron krimet dhe gabimet që i ke bërë.

A nuk di, All-llahu të udhëzoftë, se mëkatet janë një derë e madhe nga e cila i vijnë fatkeqësit njeriut?!

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Çfarëdo e keqe që mund t'ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai u falë". (Esh-Shura: 30).

"E kur juve u goditi një dështim (në Uhud) e që ju ia patët dhënë atë dyfish (armikut në Bedr), thatë: "Prej nga kjo"? Thuaj: "Ajo është nga vetë ju"! S'ka dyshim se All-llahu është i plotëfuqishëm për çdo send". (Ali Imran: 165).

Abas ibën Abdul-Mutalibi bëri lutje për shi, e mes tjerash tha:

"All-llahu ynë, secili dënim që na ka ardhur, na ka ardhur nga shkaku i mëkatit, e ky dënim nuk ngritet ndryshe përpos se me pendim".

Kurse Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë:

"Shpërblimi që i vjen mëkatarit, siç është ngushtica në zemër, ashpërsia e zemrës, shpërndarja, erësimi, brenga, dridhja, mërzia, frika, këto janë gjëra në të cilat nuk dyshon ai që ka minimumin e jetës dhe ndjenjave. Madje brengat, mërzitë, ngushtica janë denime të shpejta, zjar i kësaj bote dhe xhehenem i momentshtëm. Kurse drejtimi kah Zoti, kthimi te Ai, kënaqësia me Te, mbushja e zemrës me dashuri ndaj Tij, kënaqja me përmendjen e Tij, gëzimi dhe dëfrimi me njohjen e Tij janë shpërblime të nxitueshme, xhennet dhe jetesë që aspak

nuk i afrohet as jetesë e mbretërve...". (El-Vabil Es-Sajib, fq. 104).

Nxito, All-llahu të pastë në kujdesin e Tij, ta llogaritish vetveten me një llogari të vërtetë dhe të jeshë i matur, me një llogari të njeriut që synon kënaqësinë e All-llahut dhe mirësinë për vetveten. Nëse je i mangët në namaz, në zekat, ose në obligimet tjera, ose nëse ke rënë në dnonjë mëkat, nxito ta përmirësosh gjendjen tënde, lufto vehten tënde në këtë drejtim, do të shohish se All-llahu do ta hap gjoksin dhe do ta lehtëson punën.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"E ata, të cilët luftuan për hir Tonë, Ne me siguri do t'i orientojmë rrugës për te Ne, e nuk ka dyshim se All-llahu është në krahun e bëmirsve". (El-Ankebut: 69).

"... e kush u përmbahet dispozitave të All-llahut, atij Ai i hap rrugë dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare. ..". (Et-Talak: 2-3).

"E kush i frikësohet All-llahut, Ai atij ia lehtëson punën". (Et-Talak: 4).

"... e kush e ka frikë All-llahun, Ai atij ia shlyen të këqijat dhe ia shton shpërblimin". (Et-Talak: 5).

Nxito, All-llahu të udhëzoftë, drejt devotshmërisë, se vetëm ashtu do të shohish nga All-llahu gjëra që të gëzojnë.

Imam Ibën Xhevziu, rahimehull-llah, thotë:

"Mu ngushtua puna, e kjo shkaktoi brengë të përhershme dhe të pandarë. Fillova të mendoj thellësisht për mënyrën e shpëtimit nga këto brenga me çdo kusht dhe me çdo formë. Nuk gjeta mënyrë më të mirë se sa ajo që mu sqarua nga ky ajet: "... e kush u përmbahet dispozitave të All-llahut, atij Ai i hap rrugë...". (ET-Talak: 2).

Atëherë kuptova se devotshmëria është shkaku i daljes nga çdo krizë, andaj unë u preokupova vetëm me realizimin e

devotshmërisë, dhe e gjeta rrugëdaljen. (Shiko: "Sejduh-Hatir", fq. 153).

5- Zbatimi i obligimeve dhe vazhdimi në to

Kujdesi për zbatimin e obligimeve dhe vazhdimi në to, shtimi i veprave vullnetare, siç është namazi, agjërimi, sadakaja, bamirësia, etj, janë prej shkaqeve me të cilat njeriu bëhet i dashur te All-llahu.

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, thotë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "All-llahu, tebareke ve teala, ka thënë: kush ma armiqëson mikun Tim i kam shpallur luftë. Gjëja më e dashur me të cilën më afrohet robi Im është ajo që ia kam bërë obligim. Vazhdon robi Im të më afrohet me vepra vullnetare gjersa ta dua, e kur ta dua, bëhem veshi me të cilin dëgjon, syri me të cilin shikon, dora me të cilën prekë, nëse kërkon prej Meje i jap, e nëse strehohet te Unë e strehoj". (Buhariu).

6-Ndeja me burra të devotshëm

Takimi me njerëz të devotshëm, të dëgjosh bisedat e tyre, të përfitosh nga fjalët dhe udhëzimet e tyre. Nuk ka dyshim se ndeja me ta e kënaq Zotin, e hidhëron shejtanin, andaj rri me ta, shoqërohu me ta, kërko këshillën e tyre, do të vëresh zemërgjërësi dhe galdim. Ik nga vetmia, ke kujdes dhe mos rri vetëm, pa shok dhe mik, sidomos kur ke vështirësi, sepse shejtani ia shton robit dobësinë dhe plogështinë kur është i vetmuar, sepse shejtani është më afër njërit se sa dy personave, e ik nga tre persona, sepse ujku e hanë delen që ndahet nga kopeja.

Qëllimi është të themi se duhet të jesh i kujdeshëm që mos të rrih i vetmuar, përpjeku dhe luftoje vetveten që të rrih me njerëz të devotshëm dhe të mirë, të shkosh në ligjerata dhe tribuna, të vizitosh dijetarë dhe nxëns dije, sepse kjo ta hap gjoksin, ta shton dijen dhe besimin.

7-Leximi i Kur'anit

Leximi i Kur'anit me meditim dhe analizë është prej shkaqeve më të mëdhaja në largimin e mërzive, brengës dhe ngushticës. Leximi i Kur'anit trashëgon qetësinë e zemrës dhe zgjërimit e gjoksit.

"Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen". (Er-Rad: 28).

Imam Ibën Kethiri, rahimehull-llah, thotë:

"Domethënë i kaplon mirësia dhe mbështetjen në All-llahun, qetësohen kur përmendet Ai dhe është dakord që ta ketë All-llahun mik dhe ndihmës. Andaj All-llahu subhanehu ve teala, tha: "duke e përmendur All-llahun qetësohen zemrat". Domethënë këto zemra e meritojnë këtë gjë".

Të pastë All-llahu në Kujdesin e Tij, shtojë leximin e Kur'anit gjatë natës dhe ditës, lute All-llahun që ky lexim i yti të jetë shkak i zgjërimit të gjoksit, sepse nëse njeriu i drejtohet Zotit të vet me vërtetësi All-llahu ia hap dyert e bereqeteve të Tija:

"O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla (Kur'ani) dhe shërimi i asaj që gjendet në kraharorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët". (Junus: 57).

"Ne të shpallim Kur'anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk u shton tjetër përpos dëshpërim". (El-Isra: 82).

8-Dhikri i mëngjesit dhe mbrëmjes

Të jesh i rregullt në dhikrin e mëngjesit dhe mbrëmjes, në dhikrin e gjumit dhe dhikret tjera që janë gjatë ditës dhe natës, pa dyshim se e ruajnë muslimanin, me ndihmën e All-llahut, nga e keqeja e shejtanave; xhin dhe njerëz, ia shtojnë njeriut forcën fizike dhe shpirtërore, nëse i thotë ato duke e përjetuar domethënien e tyre, duke qenë i bindur në frytet dhe rezultatet e tyre. Kujdesu, All-llahu

të pastë në Kujdesin e Vet, për këto dhikre, sidomos ato që duhet thënë gjatë vështirësive dhe brengave.

Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Abdullah ibën abasi, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjatë vështirësive thoshte: La llahe il-Allahul-'Adhimul-Halim, la llahe il-Allahu Rabbul-'Arshil-'Adhim, la llahe il-Allahu Rabbus-semavati ve Rabbul-erdi ve Rabbul-'Arshil-kerim.

"S'ka të adhurar tjetër përveç Allahut të Madhëruar e të Urtë. S'ka të adhurar tjetër përveç Allahut, Zotit të Arshit të lartësuar. S'ka të adhurar tjetër përveç Allahut, Zotit të qiejve dhe të tokës dhe Zotit të Arshit Fisnik".

Ose lutja të cilën e transmeton Buhariu nga Enesi, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, shpesh luteshte duke thënë: All-llahumme inni e'udhu bika minel-hemmi vel-hazeni, vel-'axhzi vel-keseli, vel-buhli vel-xhubni, ve dale'id-dejmi ve galebetir-rixhali.

"O Zoti im, kërkoj mbrojtjen Tënde nga brengat dhe dëshprimi, nga paaftësia dhe dembelia, nga koprracia dhe frika, si dhe nga zhytja në borxhe dhe mundjet e njerëzve".

Abdullah ibën Mesudi, radijall-llahu anhu, thotë se Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur i binte ndonjë brengë ose vështirësi thoshte: "ja hajju ja kajjumu bi rahmetike nestegith..."

"O Ti që je i Gjall dhe që je Kujdestar kërkojmë ndihmë në mëshirën Tënde". (sahih, Hakimi).

Ebu Bekrete, radijall-llahu anhu, thotë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: lutja e atij që është në vështirësi është: All-llahumme rahmeteke erxhû fe la tekilni ila nefsi tarfet 'ajnin ve aslih li she`ni kul-lehu. La ilahe il-la Ente.

"O Zoti im, në mëshirën Tënde shpresoj, mos më le të mbështetem në vetvete, as sa një lëvizje e syrit dhe ma përmirëso gjëndjen time. S'ka të adhurar tjetër përveç Teje". (sahih, Ebu Davudi).

Abdullah ibën Mesudi, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nëse një musliman e kaplon brengë ose pikëllim le të thotë:

All-llahume inni 'abdike ve ibënu 'abduke ve ibënu emmetuke, nasijeti bijedike, madin fije hukmuke, 'adlun fije kadauke, es`eluke bi kul-li ismin huve lek semmejte bihi nefsek ev enzeltehu fi kitabik ev 'al-lemtehu ehaden min halkik, ev iste`therte bihi fi 'ilmil-gajbi 'indek, en texh'ale El-Kur`ane rebi'a kalbi ve nure sadri ve xhelae huzni ve dh habe hemmi".

"O Zoti im, unë jam robi Yt e biri i robit Tënd dhe i robëreshës Sate, balli im është në dorën Tënde. Dispozitat Tuaja mbi mua i pranoj, i drejtë është gjykimi Yt mbi mua. Të lutem me çdo emër me të cilin e ke emëruar Vetën Tënde ose që e ke zbritur në librin Tënd, apo ia ke mësuar dikujt prej krijesave Tua, apo që e ke mbajtur të fshehur në diturinë Tënde, bëre Kur'anin pranverë të zemrës sime dhe dritë të gjoksit tim, shëndritje për pikëllimin dhe largim për dëshprimin". (sahih, Ahmedi).

Abdul-Aziz Sed'hanNasir Muhamed El-Ahmed
Përshtati: Bekir Halimi
19.11.2004

Beteja e Ahzabit

- I -

Porosia e All-llahut për të parët dhe të fundit është devotshmëria: "...Ne ju patëm sugjeruar atyre që iu pat dhënë libri para jush, e edhe juve që të keni frikë nga All-llahu...". (En-Nisa: 131).

Ska dyshim se nozulli më i mirë është devotshmëria, dynjaja është vendkalim, kurse ahireti është vendqëndrim, andaj merni nozull nga vendkalimi për vendqëndrimin, ai që frikohet niset herët, e ai që niset herët arrin në vendin e caktuar. Dijeni se malli i All-llahut është i shtrenjtë, malli i All-llahut është xhenneti, andaj llogaritne veten para se t'ju llogarisin, nëhuni gati për ditën e prezentimit të madh:

"Atë ditë ju do të ekspozoheni (para Zotit), duke mos mbetur fshehtë asnjë sekret juaj". (El-Haka: 18).

Musliman të nderuar! Në kohën e dobësisë dhe thyerjes, kur ti shtohet ummetit shtetrrëthimi, kur ta godasin telashet dhe brengat, atëherë dridhen zemrat gjersa besimtarët do të thonë: kur do të vjen fitoreja e All-llahut?

Kjo gjendje e vështirë përputhet qindpërqind me gjendjen e muslimanëve të sodit. Muslimanët i ka kapluar vështirësia, sprova, andaj ata tani kanë shumë nevojë për rianalizim të gjendjes së tyre dhe rregullim për fundin e tyre.

Kemi nevojë për shkaqet e përforcimit dhe për gjërat që na bëjnë të kapur për fe deri në vdekje. Ky është ligji i All-llahut me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe shokët e tij fisnik. Kur i shtoheshin problemet dhe vështirësitë Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe shokëve të tij, All-llahu, Zoti i qiejve dhe tokës i përforconte me shkaqe të ndryshme të përforcimit. Në këtë drejtim janë edhe

tregimet e pejgamberëve, tregimet e njerëzve të mëhershëm, përfundimi i mirë i të devotshmive: "Të gjitha këto që t'i rrëfyem ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që ta forcojnë zemrën tënde, dhe në to të ka ardhur e vërteta e këshilla, si dhe përkujtime për besimtarët". (Hud: 120).

Musliman të nderuar!

Duke pasuar këto ligje hyjnore, ne sot do të prezentojmë ndodhinë më të rëndë që u ka ndodhur muslimanëve, ditët e vështirë që i ka kaluar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe besimtarët. Fundi i kësaj ndodhi ishte fitoreja dhe mëkëmbësia, pasi që All-llahu ua sprovoi zemrat besimtarëve dhe bëri dallimin mes besimtarëve dhe munafikëve. Ky rast është beteja e Hendekut, të cilën All-llahu e emërtoi beteja e aleatëve, rast për të cilin All-llahu zbriti një sure të plotë e cila lexohet deri në Ditën e Kijametit.

Në muajin Sheval, në vitin e pestë të hixhretit, një grup i çifutëve, sikur që e kanë zanat për të bërë fitne, shkuan në Mekë dhe u takuan me njerëzit autoritativ të Kurejshëve dhe i nxitën në luftë kundër Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u premtuan fitore dhe përkrahje, kurse ata e pranuan këtë sugjerim.

Pastaj shkuan te fisi Gatefan edhe ata i thirrën dhe i mashtruan. Edhe ata e pranuan këtë sugjerim.

Kurejshitët dhe banorët e Tuhamës dolën, dolën edhe ushtria e fisit Gatefan. Ata të gjithë përbënin një ushtri prej dhjetë mijë ushtarëve. I rrethkuan muslimanët në drejtim të qytetit. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i konsultoi shokët e tij, kurse Selman Farisiu, radijall-llahu anhu, dha propozimin për të gropuar hendekun. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e pranoi propozimin e tij.

Muslimanët vendosën të fortifikohen në qytet dhe ta mbrojnë atë. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, urdhëroi për të grupuar hendekun në luginën që ishte në veri-pendim të qytetit, sepse kjo anë ishte e zbuluar.

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e ndau gropimin e hendekut në grupe, secilit grup prej dhjetë njerëzve i caktoi të gropojnë nga dyzet kutë, kurse tërë hendeku ishte i gjatë pesë mijë kutë. Edhe Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka punuar me shokët e tij në gropimin e hendekut. Punuan të gjithë me një entuziazëm të madh, në kohë të ftohtë dhe në uri të madhe.

Ebu Talha, radijall-llahu anhu, thotë: u ankuam te Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, se ishim të uritur dhe secili prej nesh i tregoi gurin që kishte vënduar në bark. Atëherë Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, na tregoi se ai barkut të vet i kishte vënduar dy gurë. (Tirmidhiu. Shejh Albani thotë se ky hadith është daif. Shiko: "Daifut-Tergibi vet-Terhibi", nr. 1907).

Edhe për skej të kësaj gjendjeje ata ishin durimtar, e falënderonin All-llahun dhe Ate e përmendin dhe këndonin.

Enesi, radijall-llahu anhu, tregon: Doli Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, te hendeku, kurse muhaxhirët dhe ensarët proponin në një mëngjes të ftohtë. Kur i pa se sa janë të lodhur dhe të uritur tha: All-llahu im jetesa e vërtetë është jetesa e ahiretit Falja mëkatet ensarëve dhe muhaxhirëve

Kurse sahabet duke iu përgjigjur i thanë: "Ne jemi ata që i kemi dhënë besën Muhamedit do të bëjmë xhihad sa të jemi gjallë". (transmeton Buhariu dhe Muslimi).

Bera ibën Azib, radijall-llahu anhu, tregon: "Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, mbante dhe në ditën e Hendekut, saqë edhe barku iu pluhëros". (Buhariu dhe Muslimi).

Kurse sipas Buhariut dhe Muslimit Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i këndonte vargjet e Ibën Revahas duke bartur dheun:

Pasha All-llahun, po mos t'ishte Zoti nuk do të udhëzoheshim

Nuk do të jepnim sadaka e as nuk do të faleshim

Zbrit qetësi mbi ne

Na i forco këmbët kur takohemi me ta

Sepse ata na bënë padrejtësi

E ne, kur dikush dëshiron të na sprovon refuzojmë.

E zgjatte zërin në recitimin e këtyre të fundit.

Gjatë gropimit të Hendekut janë shfaqur disa mrekulli (muxhize).

Transmeton Buhariu dhe Muslimi se Xhabir ibën Abdullahi, radijall-llahu anhu, kur pa urinë dhe vuatjet e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, përgaditi pak ushqim, i cili u mjaftonte disa njerëzve dhe e thiri Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i thiri të gjithë pranishmit në këtë punë: "Xhabiri paska bërë pak ushqim". U tha: "hyni e mos u shtyni".

Të gjithë pranishmit ngrënë ushqim deri sa u ngopën, kurse ushqimi aspak nuk pakësohej, madje në disa transmetime tregohet se ishin përafërsisht një mijë njerëz.

Muslimanëve u doli një shkëmb i madh dhe i fortë, nuk mundeshin ta thejnë me kazmat e tyre që i kishin. Atje shkoi Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha bismillah dhe e goditi tre herë, kurse shkëmbi u bë pluhur. Atëherë Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha: "All-llahu ekber! Më janë dhënë çelësat e Shamit. Jamë duke i parë pallatet e kuqe atje. All-llahu ekber! Më janë dhënë çelësat e Persisë. Pasha All-llahun jam duke i parë pallatet e bardha të Medainit. All-llahu ekber! Më janë dhënë çelësat e Jemenit. Pasha All-llahun jam duke i parë dyert e Sanasë nga ky vend dhe në këtë moment". (Haseni, Ahmedi).

Kjo ka ndodhur në një kohë kur muslimanët dyshonin se a do të mbeten gjallë, i kishte mbytur uria, të ftohtit, kurse armiku i kishte rrethekuar nga çdo anë, doli në shesh dyfytërsia, saqë disa munafika thanë: a nuk po shihni se si Muhammedi pretendon sundimin e Persisë dhe Bizantisë, kurse ne nuk mund të garantojmë as shkuarjen për të kryer nevojën. Këtë e tregon All-llahu, az-ze ve xhel-le, duke thënë:

"Kur hipokritët dhe ata që në zemrat e tyre kishin sëmundje, thonin: "All-llahu dhe i dërguari Tij, nuk na premtuan tjetër vetëm se mashtrim!". (El-Ahzab: 12).

Erdhën idhujtarët, në lindje të Medinës iu afruan Uhudit, një grup prej tyre hypën kodrave të Medinës, sikurse tregon All-llahu: "Kur ata u erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshtmi, dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajoni mendime të llojlojta për All-llahun". (El-Ahzab: 10).

Lart ishin në lindje, në lugin ishin në perendim të Medinës. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, doli me muslimanët që ishin me te. Shpinën e kishin kah Medineja, përballë kishin armikun, e mes tyre hendekun. Gratë dhe fëmijët i strehoi në fortifikatat e Medinës.

Fisi Benu Kurejdha, të cilët ishin çifut, kishin kala në lindje të Medinës, kurse mes tyre dhe Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kishte marëveshje dhe garancë. Ata ishin përafërsisht tetëqind luftëtar. Ata i la në një anë të Medinës. Mirëpo shkoi te ata huzej ibën Ahtebi dhe vazhdoi ti bind ata derisa e thyen marëveshjen.

U vërsulën të gjitha grupacionet në luftë kundër Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe shokëve të tij për t'i çrrënjësuar tërësisht. Ndodhi betejë e madhë, u zmadhua brenga, iu ngushtua jeta muslimanëve, u shtua frika për vehten, gratë dhe fëmijët në

Medinë. All-llahu, subhanehu ve teala, këtë e përshkruan duke thënë:

"Kur ata u erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshtmi, dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajoni mendime të llojlojta për All-llahun. Atje, në atë vend qenë sprovuar besimtarët, dhe qenë tronditur me një dridhje të fortë". (El-Ahzab: 10- 11).

Kështu vazhdoi gjendja një muaj përafërsisht. Munafikët kërkuan leje, tradhtuan dhe ikën nga kjo gjendje, kurse All-llahu i përforcoi besimtarët pasi që i sprovoi dhe e pa vërtetësinë e besimit të tyre:

"E kur muslimanët e panë ushtrinë aleate, thanë: "Kjo është ajo që All-llahu dhe i dërguari i Tij na premtuan neve, e All-llahu dhe i dërguari i Tij e thanë të vërtetën". Ajo (ushtria e armikut që e panë) vetëm ua shtoi atyre besimin dhe mbështetjen". (El-Ahzab: 22).

Domethënë: besimin në All-llahun, nënshtimin dhe dorëzimin para urdhërave të Tij dhe respekt për Pejgamberin e Tij. Kjo është gjendja e besimtarëve të vërtetë, atyreve që u është premtuar fitoreja. Vështirësit vetëm se ua shtojnë besimin dhe veprat e mira, edhe më shumë kapen për urdhërat e All-llahut dhe vendimet e Tij, për fenë e Tij, kështu ata vazhdojnë derisa ta takojnë Zotin e tyre. Fitore nuk është mosvuajtja, rehatia, kënaqësia, gjërat që e stolisin dynjanë edhe në kohën më të vështirë, por fitore është përqëndrimi në principe, paftësia e armikut që tia vjedh besimtarit besimin, edhe nëse e dëmton në trup ose në pasuri.

Aq shumë e kishin vështirë muslimanët sa që Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, vendosi që të bën marëveshje me fisin Gatafan që tu jep një të tretën e fryteve të Medinës, e të kthehen, sepse iu dhimbeshin muslimanët. Në këtë drejtim i konsultoi dy zotëri, Sa'd ibën Muadhin dhe S'ad ibën Ubadën, radijall-llahu

anhuma, kurse ata thanë:

"O i Dërguar i All-llahut. Edhe ne ishim në idhujtari edhe adhurim të statujave, sikurse ata. Nuk e adhuronim All-llahun, e as që e njihnim. Ata prej kësaj gjëje nuk fituan asgjë përveç asja që e fitonin me shitblerje ose qira. Tani, pasi që All-llahu na nderoi me Islam, na udhëzoi në këtë fe, na bëri krenar me ty dhe me Islamin tua japim pasurinë tonë?!"

Pasha All-llahun, ne nuk kemi nevojë për këtë gjë. Pasha All-llahun ne vetëm shpatë mund tu japim atyreve derisa të gjykojë All-llahu mes nesh.

U gëzua Pejgamberi, alejhisselam, pasi që pa paluhatsmërinë, qëndresën dhe refuzimin e tyre. (transmeton Abdurezaku, Ibën Hishami dhe Taberiu në "Histori"- në e tij).

Musliman të nderuar!

Brenda këtyre telasheve, në mes të këtij rrethimi, erdhi fitoreja nga mbi shtatë qiejsh:

"Dhe All-llahu i zbrapsi ata që nuk besuan me atë mllëfin e tyre, duke mos arritur kurrnjë të mirë. Dhe All-llahu ua largoi luftën besimtarëve. All-llahu është i fuqishëm, ngadhënjyes". (El-Ahzab: 25).

Erdhi Nuajm ibën Mesud El-Gatefaniu, radijall-llahu anhu, si musliman te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e pastaj u kthye tek aleatët dhe i dekurajoi. (transmeton Abdurezaku, Ibën Hishami, Taberiu në "Histori"- në e tij dhe Ibën Haxheri në "Fet'hul-Bari").

Ky njeri ndihmoi shumë edhe pse ishte i hyrë rishtaz në Islam, mirëpo ishte besimtar i cili punonte për All-llahun në çdo rast, me aq sa ka mundësi, edhe nëse është i vetmuar.

Pastaj All-llahu dërgoi një erë të fuqishme, një natë të ftohtë dhe të erët. U përmbysën kazanat, u prishën çadrat dhe binin mbi ta gurët. Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, qëndronte në këmbë duke falur namaz.

Hudhejfe, radijall-llahu anhu, siç transmeton Hakimi dhe Bejhakui, ka thënë:

"Natën e "Aleatëve" Ebu Sufjani dhe aleatët mbi ne, Benu Kurejdha, çifutët nën ne, frikoheshim për fëmijët tanë. Asnjëherë nuk kam patur natë më të erët, me erë më të fuqishme, me zëra sikur vetëtimë. Aq erët ishte saqë nuk shihnim gishtin tonë. Pastaj tha: i dëgjova idhujtarët duke thënë: ikni, ikni, se nuk ka vend për ne këtu. Era shkoi në kampin e tyre. Pasha All-llahun dëgjoja zërin e gurëve që i godiste çadrat dh shtretërit e tyre, kurse era i sulmonte nga çdo anë". ("Delailun-Nubuveti", Bejhakui dhe Ibën Asakiri në "Tarihud-Dimeshk").

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"O ju që keni besuar, përkujtojeni të mirën e All-llahut ndaj jush, kur juve u erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk e shihnit, e All-llahu e shihte atë që ju vepronit". (El-Ahzab: 9).

U shpartalluan aleatët, u kthye fisi Kurejshit edhe fisi Gatefan, duke mos marë asgjë, kurse çifutëve u shkoi huç kurtha dhe mashtrimi i tyre.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: "Pas këtij viti nuk do t'ju sulmojnë më kurejshitët, por ju do t'i sulmoni". (sahih, Ahmedi). Kurse në transmetimin e Buhariut qëndron:

"Prej tani ne do ti sulmojmë e ata nuk do të na sulmojnë".

Kështu erdhi edhe çlirimi i Mekës.

Transmeton Buhariu dhe Muslimi se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjat kësaj lufte bënte dua: "All-llahu ynë! Ti që ke zbritur Librin, që llogarit shpejt, shkatërro aleatët. All-llahu im, shkatërroi dhe dridhi".

Gjithashtu transmeton Buhariu dhe Muslimi se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pastaj thoshte: "Ska hyjni tjetër përpos All-llahut që është i Vetëm. Premtimet e Tija janë të vërteta, e ka ndihmuar robin, i ka bërë krenar ushtarët e Tij, vetëm Ai i ka shkatërruar aleatët, dhe ska asgjë pas Tij".

Kur u kthye Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në Medinë, e la armën që të lahet nga pluhuri i kësaj lufte, i erdhi Xhibrili, alejhisselam, e i tha: "Melaqet nuk e kanë lërë armën e tyre. E urdhëroi të shkon te fisi Benu Kurejdha. Shkoi te ata dhe i rrethekoi. Pastaj e përcaktoi zotëriun e fisit Eus, Sa'd ibën Muadhini, radijall-llahu anhu, që të gjykojë mbi ata. Ai pa frikë gjykoj me vendim të Zotit, i cili caktonte vrasjen e luftëtarëve të tyre dhe skllavërimin e fëmijëve dhe grave". (Buhari dhe Muslim).

Ua preu kokat tradhtarëve, fitoi feja dhe miqtë e All-llahut. Këtë e sqaron All-llahu në Kur'an duke thënë: "E ata nga ithtarët e librit (jehuditë), të cilët u ndihmuan atyre (idhujtarëve), Ai (All-llahu) i nxori prej kështjellave të veta dhe në zemrat e tyre u shtini frikën, ashtu që një grup e mbytni, kurse tjetrin grupin e robëroni. E juve ua la trashëgim tokën e tyre, shtëpitë e tyre, pasurinë e tyre dhe tokën që ende nuk e keni shkelur. All-llahu është i gjithfuqishëm për çdo send". (El-Ahzab: 26- 27).

Ky është përfundimi i njerëzve të devotshëm dhe durimtar, të cilët nuk i lëkundin vështirësit nga feja dhe fitnet nga bindja në Zotin e tyre.

"Po ju menduat se do të hyni në xhennet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, sa që i dërguari thoshte, e me te edhe ata që kishin besuar: "Kur do të jetë ndihma e All-llahut"?! Ja (u erdhi ndihma) vërtet ndihma e All-llahut është afër"! (El-Bekare: 214).

All-llahu na bekoftë me Kur'an dhe Sunnet, na bëftë dobi me argumentet dhe urtësinë që gjindet në to. Kërkoj falje për mua, për ju dhe për mbarë muslimanët, andaj edhe ju kërkoni falje prej Tij sepse Ai është Falës.

- II -

All-llahun e falënderojmë që na sjell dhunti, që na i largon telashet, i përgjigjet robit të Vet kur i lutet në erësi, i ka premtuar fitore atij që kapet për rrugën e Tij të drejtë. Dëshmoj se ska hyjni tjetër përpos All-llahut, i Cili është Një dhe pa ortak dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Tij, i cili ka kryer misionin, ka realizuar emanetin dhe na ka lërë një hapësirë të bardhë, ku dita dhe nata janë të njëjtë. Nga kjo hapësirë largohet vetëm i shkaktërruari. Paqa dhe bekimi qofshin mbi te, familjen, gratë, pasardhësit, shokët dhe mbi ata që i pasojnë deri në Ditën e Kijametit.

Musliman të nderuar! Beteja e Ahzabit dhe ditët e Hendekut kanë urtësi dhe mësim, të cilat muslimanët duhet t'i kuptojnë dhe ti kenë në konsideratë.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërbllimin e All-llahut në botën jetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun". (El-Ahzab: 21).

Ligjet e All-llahut nuk ndalen së vepruarit në kohën e kaluar dhe në këtë të tashmen, andaj jabanxhillëku i fesë dhe dobësia e muslimanëve nuk duhet të na shpiejnë në demoralizim dhe molisje, por duhet të jenë shtytës për durim, flijim dhe qëndresë derisa të jep leje Zoti për rrugëdalje.

Prej shkallëve të adhurimit në të cilat duhet të kalitemi është durimi, mobilizimi, qëndresa, bindja, lutja, shpresimi i shpërbllimit, zbatimi i urdhërave të All-llahut, besimi në Caktimin e All-llahut, perceptimi i ligjit të sprovimit, mbrojtja e fesë, etj, sepse: "...All-llahu është mbizotërues i punës së vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë (fshehtësinë e çështjeve)". (Jusuf: 21).

Salih Alu Talib

Imam dhe hatib në Mesxhidul-Haram, hutbe e mbajtur më: 07/10/1425
përktheu: Bekir Halimi 26.11.2004

Vlera e dijes dhe dijetarëve

O ju njerëz! Keni frikë All-llahun me një devotshmëri të vërtetë, kontrolloni veten në sekretet dhe intimitet. Dijeni se do ta takoni dhe se te Ai do të ktheheni. Llogaritne vetveten, peshoni veprat tuaja dhe zbukurrohuni për ditën kur do të dilni para Zotit: "Atë ditë ju do të ekspozoheni (para Zotit), duke mos mbetur fshehtë asnjë sekret juaji". (El-Hakka: 18).

Robër të All-llahut! All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë: "Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t'u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet te ata, në mënyrë që ata të kuptojnë (e të ruhen)". (Et-Teube: 122).

Vëllezër musliman! All-llahu, az-ze ve xhelë, ia ka ngritur pozitën dijes dhe dijetarëve, e ka sqaruar vendin e tyre dhe ka lartësuar gradat e tyre.

All-llahu, tebareke ve tealë, thotë: "...All-llahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni". (El-Muxhadele: 11).

All-llahu, subhanehu ve tealë, nuk e ka urdhëruar Pejgamberin e tij që të kërkojë shtim të asgjëje përpos të dijes, duke i thënë: "thuj: "Zoti im, më shto dituri!". (Taha: 114).

Tërë kjo nga shkaku i ndikimit që ka dija në jetën e njerëzimit, sepse dijetarët janë të gjallët, kurse tjerët janë të vdekur.

"Dija e largon verbërinë nga e zemrës ashtu sikurse largon erësirën hëna po mos të ishte dija nuk do të ishin të lumtur njerëzit

nuk do të dini se çka lejohet e çka ndalohet me dije shpëton njeriu nga turpi kurse injoranca sjell nënçmimin dhe poshtërsimin.

All-llahu, subhanehu ve tealë, ka ndaluar barazimin mes dijetarit dhe injorantit, për shkak se dijetari dallohet me vlerën e dijes dhe dritën e njohjes, duke thënë: "...Thuj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim". (Ez-Zumer: 9).

Dija është nder i madh, kurse vetëm injorantët nuk ia dinë pozitën dhe vlerën.

Abdul-Melik ibën Mervani i ka thënë djemve të vet: "Djemt e mi! mësoni, sepse po jeni zotërinjë ua kaloni tjerëve, e nëse jeni të mesëm sundoni, e nëse jeni të thjeshtë jetoni".

Poeti thotë:

"Ai që nuk shijon hidhurinë e mësimin një çast shijon hidhurinë e injorancës se jeta ai që nuk mëson sa është i ri mer katër tekbiere për vdekjen e tij.

Robër të All-llahut! Kërkimi i dijes është vepra më e mirë në të cilën e harxhojmë ymrin dhe shpenzojmë orët.

Njerëzit janë ose dijetar ose nxënës, ose masa e gjërë e painteresume, të cilët janë:

"Ata janë të luhatshtëm ndërmjet atij dhe atij e nuk janë as me ata as me ata. Po atë që e mposht All-llahu, ti nuk mund të gjesh shpëtim për te". (En-Nisa: 143).

Argumentet e Kur'anit dhe Sunnetit tregojnë vlerën e dijes dhe dijetarëve, stimulojnë dijen dhe fitimin e saj. All-llahu e ka nderuar këtë ummet pasiqë e ka bërë ummet të dijes dhe punës, duke e dalluar nga popujt e padrejtësisë dhe injorancës.

Britma e parë, të cilës iu dëgjua zhurma gjërë e gjatë dhe të cilën e përhapi Islami anembanë e tregonte vlerën e dijes dhe dijetarëve, e vlerëson si tullë të parë në ndërtimin e individëve dhe popujve, formulimin e

popujve dhe shoqërive, e ajo është leximi dhe shkrimi.

Ebu Derda, radijall-llahu anhu, tregon duke thënë: kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

"Ai që ecë rrugës për të kërkuar dije, All-llahu ia mundëson të ecë rrugës për në xhennet. Melaqet ulin krahët e tyre në shenjë kënaqësie me nxënësin e dijes.për dijetarin kërkojnë falje të gjitha krijesat që janë në qiej dhe në tokë, madje edhe peshku në detë. Vlera e dijetarit ndaj adhuruesit është sikur vlera e hënës pesëmbëdhjetëshe në krahasim me yjet tjera. Dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve, kurse pejgamberët nuk kanë lënë trashëgim dinar dhe dirhem, por kanë lënë dijen, andaj ai që e mer këtë, ka marë hisen më të mirë". (sahih, Ebu Davudi).

Robër të All-llahut!

Me dije ngriten lavdia, civilizimet, arinë në pushtet popujt, ndërtohen mbretëri, madje muslimani nuk mund të realizon adhurimin e sinqertë ndaj All-llahut dhe në përputhje me sherijatin e tij, e mos të flasim për ndërtimin e vetes siç dëshiron All-llahu, ose ti ofron shoqërisë së tij të mira, ose ummetit krenari e fitore, përpos se me dituri.

Nëse në një popull përhapet injoranca, ai popull dobësohet, ndryshket dhe bjer në rezalet dhe humnerë.

Ai që ecë rrugës për të cilën mendon se e shpien te All-llahu, mirëpo pa dije, ai ka ecur rrugës së vështirë dhe synon të pamundshmen, sepse nuk ka rrugë që shpien në njohjen e All-llahut, subhanehu ve teala, dhe te kënaqësia e Tij përpos rrugës së dijes së dobishme, me të cilën e ka dërguar All-llahu, az-ze ve xhel-le, Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me të cilën i ka mbushur librat e Tij. Kjo dije është argument për Te, ajo i udhëzon njerëzit në erësirat e injorancës dhe mëdyshjet.

Dija fetare është: dija e marrë nga Libri i All-llahut dhe sunneti i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Kjo është baza e madhe, mbi të cilën ndërtohen të gjitha dijet. Andaj bartësit e dijes fetare janë trashëgimtarët e pejgamberëve dhe garantuesit e kësaj trashëgimie. Ata atëherë kur bashkojnë besimin e shëndoshë me dijen fetare, të kurorзуar me argumente fetare dhe sinqeritet, kanë edukatë të mirëfilltë, ata pa dyshim janë imamët besnik dhe kolosët udhëzues.

Shembulli i tyre në tokë është sikur shembulli i yjeve në qiell. Ata shërbejnë për udhëzimin e njerëzve.

Hafidh ibën Rexheb Hanbeliu, rahimehull-llah, thotë: "...rruga e tevhidit, dija mbi All-llahun, dispozitat, shpërblimin dhe dënimin nuk perceptohen ndryshe përpos se me argument. Tërë këtë All-llahu e ka sqaruar në Librin e Tij dhe në gjuhën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Dijetarët që e njohin sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, janë udhërrëfyesit, të cilët na udhëzojnë në erësirën e injorancës, dyshimeve dhe devijimit. Nëse ata mungojnë devijon njeriu".

Dijetarët mbi All-llahun dhe sherijatin e Tij, janë ata që kanë frikë All-llahun, janë dëshmitarët e Tij në ruzullin tokësor, zëvendësit e Pejgamberit në ummetin e tij.

Njeriu sa ma shum e njeh All-llahun, Atij më shumë i frikohet, sepse njeriu sa ma shum e njeh All-llahun e Madhërishëm, I Cili është i cilësuar me cilësi të plota dhe emra të bukur, njeriu sa ma plot e njeh Ate, dija e tij sa më e përsosur të jetë mbi Te, frika nga Ai është më e madhe dhe më shumë.

Ibën Abasi, radijall-llahu anhuma, thotë:

"Ai që njeh Rahmanin (All-llahun) është ai: që All-llahut nuk i ka bërë shirk, të lejuarën të lejuar e konsideron, të ndaluarën të ndaluar e konsideron, kujdeset për porosinë e All-llahut,

është i bindur se do të takohet me Te dhe se do të jep llogari për veprat e tija".

Pra, frika prej All-llahut është ajo që e pengon njeriun nga mëkati, e thërret në adhurime dhe nxitim për ta fituar kënaqësinë e All-llahut, az-ze ve xhel-le.

Hasan Basriu, rahimehull-llah, thotë: "Dijetar është ai që i ka frikë All-llahut në fshehtësi, e dëshiron atë që e dëshiron All-llahu dhe ikë nga ajo që e urren All-llahu". pastaj lexoi ajetin kuranor: "...Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është mëkatfalës". (Fatir: 28).

Kjo është dija e vërtetë, e cila i ban dobi njeriut, sepse dija nuk është shtim i njohurive dhe gjërave të futura në kujtesë, por dije është frika e madhe nga Zoti, kjo është dritë në zemër të besimtarit.

Dija pa devotshmëri dhe vepra të mira është sikur qiri i cili e ndriçon shtëpinë me dritën e vet, mirëpo e djeg veten. Çfarë i ban dobi dija atij që insiston në mëkate dhe gabime, atij që i dëgjon fjalët e mira mirëpo nuk i pason ato.

Tregon Vehb Ibën Munebeh, rahimehull-llah, nga Sufjani, i cili ka thënë: Hidri, alejhisselam, i ka thënë Musait, alejhisselam: O Musa! Mëso që të punosh me dijen, mos mëso që të flasish me te, e ti ta fitosh djegien, kurse tjerët dritën".

Ebu Derda, radijall-llahu anhu, ka thënë:

"Më së shumti frikohem nga dita kur do të dal para All-llahut, e të më thotë Zoti: ke ditur, çka ke vepruar me atë dije".

Disa njerëz të urtë kanë thënë: "nuk përfiton nga dija ai që nuk punon sipas saj".

Fryti i dijes është veprimi me te, sepse dija e kërkon veprën përmdryshe edhe ajo ikë.

Habitet njeriu, e kaplon një dhimbje e madhe, kur i sheh ata njerëz që kanë dije fetare, mirëpo nuk e praktikojnë, dinë shumë rregulla, mirëpo nuk ka efekt.

Parashtrohet pyetja: ku është ajo dije fetare tek ata që e lan namazin, tek ata që pasojnë epshin? Ku është dija fetare te ata që nuk i respektojnë rregullat fetare, nuk urdhërojnë në të mirë, nuk ndalojnë nga e keqeja, rruajnë mjekrat, përdorin kamatën, bëjnë mëkate, edhe pse e dinë bindshëm se këto gjëra janë të ndaluara për muslimanin.

Dijetarët e selefit kanë thënë: "Dijen e ruanim duke vepruar me te".

Mosveprimi sipas dijes është shkak më i madh që ta largon dijen dhe e haron ate.

Aliu, radijall-llahu anhu, ka thënë: "O ju dijetar! Veproni me dijen, sepse dijetar është ai që vepron me atë që di, ai që përputhet dija me veprën e tij. Sepse do të ketë njerëz që do të mësojnë, mirëpo dija e tyre nuk do ta kalon gabzherin e tyre, vepra e tyre e kundërshton dijen e tyre, brendia i kundërshtohet asaj publikes, rrin në hallka, lavdërohen njëri para tjetrit, sa që njeriu hidhërohet nga nxënësi i tij, nëse e le ate dhe shkon te dikush tjetër. Veprat e tyre nga këto tubime nuk ngriten te All-llahut".

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka dhënë shembull për dijen dhe gjendjen e atyreve që përfitojnë nga dija duke thënë: "Shembulli i asaj me të cilën më ka dërguar All-llahu prej udhëzimit dhe dijes është sikur shembulli i shiut, i cili bjer mbi tokë. Një pjesë e tokës është e mirë dhe e thith ujin, e mbinë bimët dhe bari. Një pjesë tjetër është e fuqishme dhe e grumbullon ujin, me këtë u ban dobi njerëzve, pijnë, u japin me ijë tjerëve dhe vadisin. Kurse një pjesë tjetër as nuk e thith ujin e as nuk e grumbullon. Ky është shembulli i atij që e ka kuptuar fenë, ka patur dobi nga ajo dije me të cilën më ka dërguar All-llahu, ka mësuar dhe tjerët i ka mësuar, shembulli i atij që ska fituar asgjë nga dija dhe nuk e ka pranuar udhëzimin e All-llahut me të cilin jam dërguar". (transmeton Muslimi).

Dijeni, All-llahu ju mëshiroftë, se prej defekteve të dijes dhe shkaqeve që e largon bereqetin e saj është njeriu për shkak të dijes të kërkujë kryetarllëk, të bëhet mendjemadh, të dëshiron që njerëzit t'i nënshtrohen, të drejtohen kah ai, të tenton që të tregohet më i dijsëm se dijetarët e mëdhenj. Këtij njeriu All-llahu i është kërcënuar me zjar, siç na tregon Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"Ai që kërkon dije që të hyn në rangun e dijetarëve, të polemizon me injorantët dhe të mer vëmendjen e njerëzve, ate All-llahu e shtin në zjar". (sahih, Tirmidhiu).

Hasan Basriu, rahimehull-llah, thotë: "Mos të jetë hisja e dikujt nga dija që ti thonë njerëzit: dijetar".

Njeriu duhet të jetë i sinqertë në kërkimin e dijes, të duron dhe ti mëson edhe tjerët në durim, mos ta nxiton vjeljen, sepse fillimi është rrëshqitës, kurse ai që mer guxim të mer kryevendin para kohe, All-llahu e turpëron në kohë.

All-llahu na bekoftë me Kur'an dhe Sunnet, na bëftë dobi me argumentet dhe urtësinë që gjindet në to. Kërkoj falje për mua, për ju dhe për mbarë muslimanët, andaj edhe ju kërkoni falje prej Tij sepse Ai është Falës.

- II -

O ju njerëz! Keni frikë All-llahun, Ate falënderone, respektone dhe mos bëni mëkate ndaj Tij.

Dijeni se devotshmëria është baza e dijes dhe çelësi i kuptimit: "...Kini frikë All-llahun e All-llahu ju dhuron dituri, All-llahu është i gjithëdijshëm për çdo send". (El-Bekare: 282).

Robër të All-llahut! Mësoni dijen e dobishme dhe mësojani tjerëve, sepse atij që All-llahu ia do të mirën ia mëson fenë.

Një pjesë e dijes është obligim për secilin musliman dhe muslimane, askujt nuk i lejohet që ta braktis, e nëse e braktis e cenon jetën dhe fenë e tij, siç janë rregullat e besimit,

pastërtisë, namazeve, zekatit, agjërimit, haxhit, andaj secili musliman e ka obligim të pyes për këto rregulla, ti mësoje dispozitat e fesë, sepse shërimi i injorancës është pyetja.

Sa është e vështirë për njeriun të shoh njeri të thinjur, të plakur, kurse adhurimet që i ban i ban pa dije, mund që njeriu të ishte falur dyzet vite, ma shumë ose ma pak, kurse në realitet të mos jetë falur, sepse namazit të tij i kanë munguar ruknet, ose shartet, ose vaxhibet.

Mjafton kjo gjendje si argument se All-llahu këtij njeriu nuk ia ka dashtur të mirën.

Njeri pa marë parasysh se çfarë grada arrin në shkencat e kësaj bote, nëse nuk i njeh rregullat e domosdoshme të fesë, nuk fiton asgjë.

All-llahu, tebareke ve teala, për këta njerëz thotë: "Edhe atë që dinë nga jeta e kësaj bote, është dije e cekët, por ndaj jetës së përjetshme (ndaj Ahiretit) ata janë plotësisht të verbëruar (të paineresuar)". (Er-Rum: 7).

"Por, dijenia e tyre arrihet në botën tjetër (kur të përjetojnë çka u është premtuar). Ja, ata dyshojnë për këtë (për botën tjetër), bile janë të verbër ndaj saj". (En-Neml: 66).

Ibën Kethiri, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë ajet thotë: "Ata vetëm dije për këtë dynja kanë, si të fitojnë, si të jetojnë. Janë të mençur dhe të aftë për të fituar nga dynjaja, për formën e fitimeve, mirëpo janë neglizhent ndaj çështjeve të fesë dhe asaj që u bën dobi në ahiret, sikur të jetë mendjehetë, pa intelgjencë dhe ide".

Hasan Basriu thotë: "Disa njerëz janë shumë të aftë në dynja, e vëndon një dirhem në thonjë dhe e di se sa peshon, kurse nuk di të falet".

Ibën Abasi, radijall-llahu anhu, thotë:

"Jan për qëllim mosbesimtarët. Ata dinë ta ndërtojnë dynjanë, mirëpo nuk e njohin fenë".

Dijeni, All-llahu ju mëshiroftë, se mbetja e dijes fetare është e lidhur me mbetjen e dijetarëve, nëse ata shkojnë njerëzit mbeten në devijim, shtohet injoranca, kurse kjo është prej shenjave të kijametit.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Prej shenjave të Kijametit është ngritja e dijes, përhapja e injorancës, konsumimi i alkoolit dhe përhapja e zinasë". (Muslimi).

Ngritja e dijes ndodh me vdekjen e dijetarëve.

Abdullah ibën Amr ibën Asi, radijall-llahu anhu, thotë: kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: "All-llahu nuk e mer dijen duke e nxjerrur nga gjoksi i njerëzve, mirëpo e mer dijen duke i marrë dijetarët. E kur nuk le asnjë dijetar, atëherë njerëzit i marin për kryetar injorantët, ata i pyesin, kurse këta u japin fetav pa dije, andaj devijojnë vet po edhe tjerët i devijojnë". (Muslimi).

Marja e dijes është vdekja e dijetarëve, shkuarja e njerëzve të vlefshëm dhe fukahave.

Disa dijetarë kur e kanë komentuar ajetin kuranor: "A nuk shohin ata se Ne i sjellim pakësimin e tokës (së tyre) nga të gjitha anët e saj. All-llahu gjykon, e s'ka kush që mund t'i kundërvihet gjykimit të Tij. Ai ndërmerr masë të shpejtë". (Er-Ra'd: 41).

Atau, rahimehull-llah, ka thënë: "Kjo domethënë vdekja e dijetarëve, shkuarja e njerëzve të vlefshëm, fukahatë e tokës dhe

njerëzit më të mirë".

Kurse Ibën Abasi, radijall-llahu anhu, ka thënë: "Duke vdekur dijetarët fshihen gjurmët e të vërtetës, shtohet injoranca dhe ngritet dija".

...duke e përfunduar këtë hutbe me disa konkluzë:

- 1- dija i ngrit njerëzit;
- 2- dijetarët e hadithit e kanë rikthyer pozitën e tyre në botën islame;
- 3- rëndësia e dijes dhe dijetarëve për muslimanët bashkëkohor;
- 4- nevoja për mobilizim të më shumë njerëzve për të mësuar dijet e fesë;
- 5- marja e iniciativave individuale për të zëvendësuar këta dijetar të mëdhenj që na kanë shkuar, me gjithë vështirësitë që ka kjo rrugë;
- 6- dija dhe përvoja njerëzit i bën referencë dhe autoritet që i bashkon muslimanët;
- 7- muslimanët nuk mund të përparojnë në mungesë të liderëve shpirtëror, që te Ehli Sunneti janë dijetarët.

Dërgoni salavate mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, sepse All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Është e vërtetë se All-llahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni me selam". (El-Ahzab: 56).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kush dërgon mbi një herë salavate, All-llahu dërgon mbi te dhjetë herë".

Bekir Halimi
3.12.2004

Mungesa e të vërtetës

- | -

Porosia kryesore për ju dhe për mua është frika nga Zoti, vetëdija se Zoti na kontrollon në të gjitha veprat që i bëjmë ose i lëjmë, sepse me devotshmëri arrihet miqësia (vilaje) dhe na vijnë myzhdet: "Ta keni të ditur se të dashurit e All-llahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje? (Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepet myzhde në jetën e Dunjasë (në çastin e vdekjes) dhe në jetën tjetër (për shpëtim dhe xhennet). Premtimet e All-llahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, ai është sukses i madh". (Junus: 62- 64).

Musliman të nderuar! Prej sprovave më të mëdha nga të cilat vuajnë në përgjithësi shoqëritë muslimane në këtë shekull është mungesa e të vërtetës ose përzjerja e saj me të kotën, mungesa e pushtetit të referencës së qartë dhe të vërtetë në publikimin e të vërtetës, ndihmimit të saj para të kotës dhe shfaqja e saj në formën që ia ka zbritur All-llahu Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, pa fitne ose mëdyshje, pa keqinterpretime nga ndikimi i dyshimeve dhe epsheve, gjë që bëhet shkaku kryesor që fotografia e Islamit të përballet me dy reziqe kryesore:

Një: Reziku i prishjes së Islamit, duke iu paqartësuar vlerat dhe nocionet statike, duke u futur të vërtetave gënjeshtër, ose origjinaleve gjëra të huaja.

Tentohet që ky kuptim i këtille i gjërave të mbetet dominant në mesin e njerëzve, kurse shpresa mbetet te disa shpirtëra që të vjen koha e përshtatshme për ta kthyer hakun në vendin e vet. Mirëpo njerëzit në këtë kohë të pritjes e kanë mbushur zemrën me këtë besim të prishur, se tërë kjo që janë duke e bërë, ky largim nga Islami dhe kjo mangësi në

fetarizëm, kjo përzjerje të bukurës me të shëmtuarën është vet Islami. Andaj kur të dëgjohen zëra përmirësuese, që i thëret ata ti kthehen metodës së vërtetë, kapjes për shëritin e Tij të përhershëm, ashtu si e ka zbritur All-llahu, i kritikojnë për këtë hap dhe këtë lëvizje, i akuzojnë këshilluesit me prapambeturi, ngurtësi e sipërfaqësi. Kështu supozojnë thirësit e mashtrimit dhe përzjerjes së gjërave, kurse gjuha e gjendjes së tyre kur këshillohen nga këshilluesit thotë: "E kur atyre u thuhet: "Mos e prishni rendin në tokë"! Ata thonë: "Ne jemi vetëm përmirësues (paqtues)! Veni re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë". (El-Bekare: 11- 12).

Këtë që e themi na e përforcon thënia e Abdullah ibën Mesudit, radijall-llahu anhu, ku mes tjerash thotë: "Si do të jetë halli juaj kur do t'ju kaplojnë fitnet nga çdo anë. Plaket në to i vjetri, rritet në to i vogli, njerëzit e konsiderojnë sunnet, e nëse ajo ndryshohet, thonë është ndryshuar sunneti? I thanë: kur do të ndodh kjo gjë, o Ebu Abdurahman? Tha: kur të shtohen lexuesit e Kur'anit, pakësohen fukahatë, shtohen liderët (emirat), fitohet dynjaja me punë të ahiretit". (Transmeton Abdurezaku, Ibën Ebi Shejbe, Daremiu, Shasiu, Hakimi, Ibën Hazmi, Bejhakui, kurse shejh Albani vlerëson se ky transmetim është i vërtetë).

Dy: Ky mashtrim dhe përzjerje e gjërave shkakton te muslimanët përçarje dhe bëhet i pamundshëm bashkimi, sepse secili grup do të pretendon se ka metodën e vet të veçantë.

Kjo do të shkakton që përkatësia islame të mer forma të ndryshme që dallojnë njëra nga tjetrat sikurse vijat e gjata paralele, të cilat është e pamundshme të takohen ndonjë herë.

Nga ky shkak jemi duke parë islam verior, islam jugor, islam lindor, islam perëndimor,

kurse islami është një fe dhe një ngjyrë, mirëpo mashtrimi dhe devijimi bëjnë turbullira në shoqëri, të cilat asnjë ushtri e madhe nuk mund ti bëjë.

Shoqëria muslimane e pastër dhe e devotshme, është ajo shoqëri ku dominon ambijenti i pastër në metodë, qartësia në synim, brendësia e shëndoshë gjatë gjykimit, fetvasë, edukimit, arsimimit, raporteve familjare dhe shoqërore dhe gjithpërshirshmëria në kapjen për Islamin, duke mos skajësuar asnjë aspekt të sherijetit të All-llahut ose hedhja e tyre në grumbullin e kaosit, negociatave dhe kërcënimit.

Ai që përcjell shekujt e hilafetit të drejtë do të jetë i bindur se në ato kohëra ka munguar mashtrimi, përzuerja e gjërave, manipulimi në raport me sherijatin e pastër në të gjitha sferat. Andaj ata u rritën lart, arritën mbretëri të gjërë në ruzullin tokësor, kjo erdhi si dhunti e All-llahut mbi ta, e pastaj si rezultat i vërtetësisë së tyre të brendshme, i personifikuar në realitet dhe dukje.

Ata nuk kanë qenë pejgamber, as që kanë patur sherijat që dallon nga sherijati ynë, nuk kanë patur Libër tjetër përpos këtij që e lexojmë ne, e as sunnet tjetër përpos sunnetit të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, mirëpo besimi i tyre i thellë në All-llahun dhe Pejgamberin e Tij, puna e vërtetë në jetën e përditshme, marja e mësimave nga Libri i All-llahut, kur Ai i qortonte dhe kritikonte ata që mashtrimin dhe përzierjen e gjërave e kishin metodë jete, që të mashtrojnë Zotin e tyre dhe masën e gjërë nga populli i tyre:

"Ata përpiqen ta mashtrojnë All-llahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë". (El-Bekare: 9).

Libri i All-llahut është përplot ajete që qortojnë ata që kanë profesion mashtrimin dhe manipulimin. All-llahu, subhanehu ve teala, ka

qortuar disa ithtarë të Librit (ehli Kitab) të cilët i kanë mashtruar popujt e tyre duke futur në sherijatin e tyre gjëra që s'janë pjesë e tyre, që të pranohen dhe përhapen në mesin e tyre, që të shfaqen në mesin e tyre si reformatore dhe të mëshirshëm, duke thënë:

"E ka disa prej tyre që janë analfabetë, nuk e kuptojnë librin, por jetojnë vetëm në shpresta, duke mos qenë të sigurt. Është shkatërrim për ata që me duart e veta e shkruajnë librin, e pastaj thonë: "Ky është prej All-llahut"! E për të arritur me të një fitim të paktë, pra është shkatërrim i madh për ta çka shkruan duart e tyre dhe është shkatërrim i madh për ta ajo çka fitojnë". (El-Bekare: 78- 79).

Kurse në një ajet tjetër thotë: "Në të vërtetë, një grup prej tyre janë ata që pësh-tjellojnë gjuhët e tyre kur lexojnë librin (për ta deformuar kuptimin) ashtu që ju të mendoni se ajo (shprehje) është nga libri, po ajo nuk është nga libri (i vërtetë), madje thonë: "Kjo është nga All-llahu"! Po ajo nuk është nga All-llahu. Ata duke ditur thonë gënjeshtër për All-llahun". (Ali Imran: 78).

Në këtë drejtim është edhe ajeti Kur'anor:

"E mos e ngatëroni të vërtetën me të pavërtetën dhe me vetëdije të fshehni realitetin". (El-Bekare: 42).

Këtë qortim e përforcon duke thënë në ajetin tjetër: "O ithtarët e librit, përse, duke qenë se ju e dini të vërtetën e ngatëroni me gënjeshtër dhe e fshihni realitetin?" (Ali Imran: 71).

Mashtrimi, ngatërimi i të vërtetës, manipulimi, gjëra të cilat e shkatërrojnë një shoqëri dhe e sjellin në humnerë, janë cilësi të popullit të devijuar dhe popullit që All-llahu është i mllëfosur në ata.

Musliman të nderuar! Mashtrimi dhe ngatërimi i gjërave është publikim i të kotës në formë të të vërtetës, shndërimi i të keqes në të mirë dhe të shëmtuarës në të bukur.

Është e vërtetuar në këtë vepër të rezikshme se ai që ngatërron të vërtetën me të kotën do ta gjenë veten të detyruar që ta fsheh të vërtetën dhe ta sqaron të kotën, sepse po e sqaroi të vërtetën do të asgjësohej e kota, të cilën është duke e vepruar dhe është duke e ngatëruar me të vërtetën. Këtë gjë e harojnë shumë njerëz që kanë të bëjnë me oferta të vesternizimit dhe tentime të përvjedhjes me preteks të ripërtërirjes, reformës, përparimit të shoqërive dhe ngritjes së tyre në nivelin e tjerëve. Në këtë drjetim shërbehen me të gjitha komentet e shtrembëruara, dyshimet dhe keqinterpretimet e teksteve të qarta.

Disa dijetarë të selefiteve kanë thënë:

"Nëse e vërteta ngatërrohet me të kotën, ai që e vepron këtë gjë e ka shfaqur të kotën në formën e të vërtetës dhe ka folur me shprehje që kanë dy kuptime: kuptimin e vërtetë dhe kuptimin e kotë; dëgjuesi mendon se ka synuar kuptimin e vërtetë, kurse ai ka synuar kuptimin e kotë".

Dijeni, All-llahu ju pastë në kujdesin e Tij, se mashtrimi dhe manipulimi ka mjete të ndryshme, ata që e bëjnë këtë vepër nuk i përmbahen vetëm një rruge, edhe pse ndoshta nuk janë të aftë ti shfrytëzojnë të gjitha mjetet.

Disa prej tyre përdorin komentin e gabuar, pasimin e ajeteve jo të qarta që i shërben interesve dhe pikpamjeve të tyre, ngatërrojnë të vërtetën me të kotën.

All-llahu i ka qortuar ata që kanë këto cilësi duke thënë: "... E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar hutitë, e kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: "Ne u kemi besuar atij (atyre që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë"! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes". (Ali Imran: 7).

Robër të All-llahut! Kjo metodë e rezikshme, jo vetëm që i dallon epsharakët dhe njerëzit me dyshime dhe dilema, por i kaplon edhe ata që i japin përparësi të mirave të kësaj bote para ahiretit me dijen, vendimin, sjelljen e tij.

Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë: "Ai dijetar që i jep përparësi dynjasë dhe e do shumë domosdo do të flet mbi All-llahun pa dije në gjykimet, fetvatë, lajmet dhe detyrimet e tija. Sepse vendimet e Zotit shpesh vijnë në kundërshtim me pasionet e njerëzve, sidomos të parisë, andaj nëse dijetari dhe pushtetari e dojnë prijatarinë dhe pasojnë epshet e tyre, këtë nuk mund ta arrijnë përpos se me gjërat e kundërta të vërtetës, sidomos nëse ka edhe ndonjë dilemë. Atëherë epshi dhe dilema ngjallin paisonin, fshihet e sakta dhe humbet fytyra e të vërtetës". ("El-Fevaid", fq. 100).

Nëse dhënia përparësi dynjasë nga dijetari dhe pushtetari i sjell ata në këtë gradë, çka të themi për gazetarin, mendimtarin, politikanin, ideologun, etj?! pa dyshim se te ata kjo edhe më shumë ndikon. La havle ve la kuvvet il-la bil-lah.

Mashtruesit dhe manipuluesit kanë edhe një metodë të rezikshme. Ajo është fshehja e të vërtetës, mos shfaqja e saj para njerëzve, edhe pse nuk e ngatërrojnë ate me të kotë, pastaj sjellin argumente dhe dyshime për rëndësinë e fshehjes dhe rezikun e publikimit. I zmadhojnë pasojat negative që mund të vijnë si pasojë e shfaqjes së të vërtetës dhe i zvoglojnë dobietë e dobive që vijnë si pasojë e publikimit të të vërtetës. Pasi që ngatërrimi i të vërtetës me të kotën dhe fshehja e të vërtetës janë dy gjëra që ndërliken mes vete.

Shejhul-Islam, Ibën Tejmijje, rahimehull-llah, thotë: "ai që e fsheh të vërtetën ka nevojë që në vend të saj të vëndon të kotën, e përzier të vërtetën me të kotë, andaj secili nga ithtarët e Librit që e fsheh atë që ka zbritur All-llahu detyrimisht do ta publikon të kotën". ("Mexhmuul-Fetava", 7/172-173).

All-llahu, az-ze ve xhel-le, u është kërcënuar atyreve që pasojnë këtë metodë duke thënë: "Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruam njerëzve në librin, të tillët i mallkon All-llahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë". (El-Bekare: 159).

Kurse imam Buhariu, rahimehull-llah, transmeton nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, se ka thënë: "Po mos të ishte një ajet në Librin e All-llahut nuk do ti tregoja askujt asgjë", e pastaj e lexoi ajetin e lartshënuar. (Buhariu dhe Muslimi).

Kurse Imam ahmedi sjell një hadith të ngritur deri te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në të cilin ka thënë:

"Ai që pyetet për një çeshtje të dijes dhe e fsheh ate, do të frerohet me frerë të zjarit në Ditën e Kijametit". (transmeton Ahmedi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibën Maxheja, kurse Shejh Albani i vlerëson si sahih).

Andaj, robër të All-llahut, e kemi obligim që ti dorëzohemi sherijatis të All-llahut, sepse është sherijati i përhershëm, ku nuk ka ngatërime dhe mashtrime, vlen për çdo kohë dhe vend, ummeti islam nuk mund të arrijë krenari pa te, kurse humbja, dështimi dhe shkatërrimi është i ndërlidhur me largimin e muslimanëve prej tij.

Musliman të nderuar! Nuk duhet të mashtrohemi me oferta të stolisura dhe mashtrime të zbukuruara për ta skajësuar sherijatin nga jeta e njerëzve, kurse qëndrimi i muslimanit përballë fortunave të devijimit dhe ofanzivave të mashtrimit duhet të jetë, ajo me të cilën All-llahu i ka lavdëruar të thelluarit në dije, të cilët para këtyre sprovave devijuese dhe mëdyshjeve rreth sherijatis thonë: "...Ne u kemi besuar atij (atyre që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë"! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes". (Ali Imran: 7).

- II -

Dijeni, All-llahu ju pastë në kujdesin e Tij, se disa mufesirë (komentues të Kur'anit) kanë disa sqarime të bukura në lidhje me ajetin Kur'anor: "E mos e ngatërroni të vërtetën me të pavërtetën dhe me vetëdije të fshehni realitetin". (El-Bekare: 42).

Ata thonë: Devijimi i tjerëve dhe mashtrimi i tyre arrihet në dy mënyra:

1- Nëse tjetri i ka dëgjuar argumentet e të vërtetës dhe i ka pranuar ato, devijimi i tij ndodh duke i futur dyshime rreth këtyre argumenteve.

2- Nëse tjetri nuk i ka dëgjuar argumentet e të vërtetës, devijimi i tij ndodh duke ia fshehur këto argumente dhe pengimi i tij që të arrijë deri te to.

Andaj fjala e All-llahut: "E mos e ngatërroni të vërtetën me të pavërtetën" e aludon mënyrën e parë, kurse ajeti: "mos fshehni realitetin" e aludon mënyrën e dytë. Pa dyshim se që të dy mënyrat janë telash i madh.

Mashtrimi dhe manipulimi ndodh kur të mungon dija mbi rrugën e të vërtetës dhe rrugicat e të kotës, siç ka thënë Faruku, Omer ibën Hatabi, radijall-llahu anhu: "Do të rrënohet Islami pjesë pjesë, kur do të rriten në Islam njerëz që nuk e njohin injorancën". ("Miftahu Darus-Seadeti", 1/295).

Prej këtu edhe u bë e njohur fraza e tij:

"Nuk mashtroj as që lejoj që dikush të më mashtrojë". (po aty).

Muslimani duhet të ketë frikë Zotin e vet, duhet ta njeh fenë e tij, sepse All-llahu i ka sqaruar argumentet e Tij që të bëhen të qarta metodat e kriminelëve.

Atëherë kur të shtohen bisedat e kota, ngatërrimi i gjërave, të flet njeriu i thjeshtë për çeshtjet e përgjithshme, kur të përzien njerëzit një thënie të mirë me një të keqe, atëherë nuk na mbetet asgjë tjetër përpos se

ti drejtohem All-llahun që të na jep udhëzim dhe mbrojtje nga mashtrimi dhe devijimi, sikurse na tregon Imam Muslimi në sahihun e tij se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, kur e fillonte namazin e natës, e fillonte me këtë lutje: "All-llahu im, Zoti i Xhibrilit dhe Mikailit, njohës i gajbit dhe të dukshmes, Ti gjykon mes robërve Tu në gjërat që ata kanë mosmarveshje, më udhëzo në të vërtetë me lejen Tënde në ato gjëra që ata kanë dallime, sepse Ti udhëzon cilin do në rrugën e drejtë". (Muslimi).

Ibën Kajimi, rahimehull-llah, na tregon qëndrimin e hoxhës së tij, Ibën Tejmijjes, rahimehull-llah, përballë këtyre gjërave të rënda, duke thënë: "Kam parë shejhul-Islamin, rahimehull-llah, kur i vinte e rëndë ndonjë çështje ose ishte e vështirë, ikte në pendim, istigfar, istiane (kërkim ndihmë nga All-llahu) Atij i mbështetej, kërkonte zgjidhjen e saktë nga Ai dhe hapjen e depove të Mëshirës së Tij, pastaj shpejt vinte ndihma hyjnore mbi te që ta ndihmonte dhe zbritnin mbi te inspirimet hyjnore se me cilën tia fillon". ("I'lamul-Muvekein", 4/131-132).

Ai që ka frikë All-llahun dhe dënimin e Tij duhet të kujdeset nga lejimi i të ndaluarës me hile dhe mashtrime, duhet ta dijë se nuk e shpëton prej All-llahut mashtrimet dhe dredhitë e tija në fjalë ose vepra, duhet ta dijë se All-llahu e posedon një ditë ku dobësohen njerëzit,

rrënohen kodrat, vijnë trishtimet një pas një, dëshmojnë gjymtyrët, zbardhen fytyrat e atyreve që kanë këshilluar për All-llahun, Pejgamberin dhe Librin e Tij dhe që në zemrën e tyre ka patur bamirësi, vërtetësi dhe sinqeritet për të Lartin dhe të Lartësuarin, kurse nxihen fytyrat e atyreve që në zemër kanë mashtrimin, tradhtinë, rrenën, kurthet dhe hilen. Atëherë do të mësojnë mashtruesit se vetveten kanë mashtruar dhe se kanë luajtur me fenë: "Dhe ashtu (sikurse në Mekë) në çdo qytet kemi bërë kriminelët e tij pari, në mënyrë që të bëjnë dredhi në të, por nuk mashtrojnë tjetërkë pos veten e tyre dhe prapëseprapë nuk kuptojnë". (El-Enam: 123).

"Ata që i sulmojnë argumentet Tona, nuk mund të na fshihen. Pra, a më mirë i ka punët ai që do të hidhet në zjarr, apo ai që në ditën e kijametit vjen i sigurt? E ju pra veproni si të dëshironi, e ta dini se Ai sheh atë që punoni". (Fusilet: 40).

Dërgoni salavate mbi njeriun më të mirë dhe më të pastër, Muhammed ibën Abdullahun, pronari i Havdit dhe shefatit, sepse me këtë gjë ju ka urdhëruar All-llahu, gjë me të cilën vet ia ka filluar, duke thënë: "Është e vërtetë se All-llahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që ke- ni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni me selam". (El-Ahzab: 56).

Suud Shurejm
imam dhe hatib në Mesxhidul-Haram
hutbe e mbajtur me datë: 21/10/1425
Përshtati: Bekir Halimi
10.12.2004

Nderimi i emrave të All-llahut

Muslimanët e kanë obligim t'i respektojnë emrat e All-llahut, subhanehu ve teala, t'i madhërojnë ato, ta mësojnë kuptimin e tyre të cilët tregojnë madhërinë e All-llahut subhanehu ve teala. Kur kemi treguar për tevhidin e emrave dhe cilësive të All-llahut, e kemi parë se All-llahu, i ka emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta. Ka disa emra që janë të veçantë vetëm për All-llahun e nuk lejohet për njerëzit të emërtohen me ato emra p.sh. ER-Rahman- I Gjithmëshirshmi, EL-Hakem-Gjykuesi etj. Thotë All-llahu, subhanehu ve teala: "...All-llahu i ka emrat e Tij të bukur, pra, luteni Atë me ato emra..." (A'raf 180).

Shumë musliman bëjnë gabime të mëdha lidhur me emrat e All-llahut, subhanehu ve teala: e emërton dikush fëmiun e tij me emër që është i veçantë për All-llahun, subhanehu ve teala, apo shoqëria e tij e thërret me ndonjë pseudonim të këtyllë dhe nuk ia din rrezikun që përmban ai pseudonim.

Ja një rast lidhur me këtë temë që ka ndodhur në kohën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e që është mësim për të gjithë muslimanët. Transmetohet nga Ebu Shurejh- Hani' ibën Jezid, radijall-llahu anhu, se ai kur u shpërngul te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me popullin e tij, pseudonimi i tij ishte Ebul-Hakem (babai i Gjykuesit) dhe populli i tij e thirrnin kështu. Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e thirri dhe i tha: All-llahu është Gjykues dhe Atij i takon gjykimi, e ti pse quhesh Ebul-Hakem? Tha: Kur populli im nuk mund të pajtohet në ndonjë gjë, vijnë tek unë. Gjykoj mes tyre dhe

kënaqen të dy palët. Tha Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: Shumë bukur! Si quhen fëmijët e tu? Tha: Shurejh, Muslim dhe Abdull-llah. Tha Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: Cili prej tyre është më i madhi? Tha: Shurejhu. Tha Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: Prej tash ti je Ebu Shurejhu (babai i Shurejhut).

Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ndërroi pseudonimin e këtij si nderë për emrat e All-llahut, subhanehu ve teala, si dhe për atë se pseudonimi i tij ishte emër që i përket vetëm All-llahut, subhanehu ve teala; "Gjykues". Gjykuesi (el-HAKEM) është ai i cili kur të gjykon nuk kthehet e kundërshtohet gjykimi i tij, e ky është vetëm All-llahu, subhanehu ve teala.

Nëse njeriu emërton fëmiun e tij; Abdul-Hakem (robi i Gjykuesit), kjo lejohet, sikurse Abdurrahman, Abdull-llah etj. Lejimi i kësaj është vetëm për shkak të parashtesës "abdu" (robi), mirëpo nuk do të thotë se cilitdo emër që t'i shtohet kjo fjalë është në rregull p.sh. Abdur-resul apo Abdun-nebij (robi i të Dërguarit), Abdulka'be (robi i Qabes) etj., kjo nuk lejohet. Pra, nuk lejohet që fjala "abdu" t'i shtohet çfarëdo emrit tjetër pos emrit All-llah dhe emrave tjerë të Tij.

Ai që emri i atij është në kundërshtim me normat Islame, duhet ta ndërron me ndonjë prej emrave që janë në pëlqim me normat Islame.

Pasi që ta ndërron emrin i lajmëron të tjerët me emrin e tij të ri Islam, ua sqaron shkakun e ndërrimit të emrit, për këtë do të shpërblehet tek All-llahu, me shpërblim të shtrenjtë.

Omer Berisha (nga libri "Mësime në tevhid")
26.11.2004

Sistemi i emërimit në Islam

Islami vendos një rëndësi të veçantë identifikimit të qartë të marrëdhënieve familjare. Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Mësoni mjaft për prejardhjen (vijën) tuaj, për t’i ditur të afërmit nga gjaku dhe trajtoni ato në mënyrë të përshtatshme”. (Transmeton Tirmidhiu)

Kjo do të thotë se vijat (prejardhja) duhet të dihet mjaft mirë për të parandaluar martesat brenda brezave të ndaluar dhe për t’i përcaktuar obligimet e gjakut dhe ato familjare.

Edhe pse është detyrë e shtetit Islam për t’u kujdesur për qytetarët e saj, përgjegjësia primare fillimisht qëndron në anëtarët e familjes. Për këtë shkak sipas ligjit Islam, marrëdhëniet e gjakut duhet të definohen qartë dhe çfarëdo ndërhyrje në to është rreptësisht e ndaluar. Kjo është e theksuar qartë në sistemin e emërimit në Islam në të cilin çdo emër dhe sekuencë e saj përfshinë një marrëdhënie specifike të gjenezës.

Për shembull, Halid ibën Abdullah ibën Zeki el-Harbi, që në kohët e tashme shkruhet Halid Abdullah Zeki el-Harbi do të thotë Halidi, djali i Abdullahut, djali i Zakiut, nga fisi Harb. Ky system i emërimit të njerëzve sipas baballarëve dhe gjyshërve është paraqitur në pjesën më të madhe të kulturave. Madje edhe në anglisht, George djali i Johnit me kohë është bërë djali (son=djalë) i George Johnit dhe në fund është bërë George Johnson.

Në kohërat para Islame, arabët zakonisht ua kanë ndryshuar vijën e prejardhjes djemve të tyre të fituar (adoptuar) me vijën e tyre. Më vonë, kjo ishte ndaluar nga Allahu Fuqiplotë.

Ibën Omer, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë se kur Pejgamberi, sal-lallahu alejhi

ve sel-lem, e liroi Zejd ibën Harithin dhe e adoptoi atë, njerëzit i referoheshin atij si Zejd ibën Muhammed deri sa është shpallur ajeti, “Ju thirrni (mbështetni) ata në etërit e vërtetë të tyre, kjo është më e drejtë tek Allahu...” (Ahzab: 5)

Kur kjo rregull u bë pjesë e ligjit Hyjnor, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, u udhëzua që edhe më tej të theksojë atë me një seri të paralajmërimeve. Për shembull, në një rast ai ka thënë, “Ai i cili me vetëdije e atribuon prejardhjen e tij dikujt tjetër e jo babait të tij, nuk do të hyjë në Xhennet”. (Buhariu, Muslimi, Abu Davudi)

Islami është komplet. Ai rregullon të gjitha aspektet e jetës së njeriut me qëllim të vendosjes së një sistemi shoqëror në të cilin ka përkujdes për mirëqenien njerëzore dhe në të cilin e drejta për adhurimin e Zotit është e mbrojtur.

Si rrjedhë e kësaj, edhe pse disa pjesë për sistemin e emërimit në Islam mund të jenë më të rëndësishme se disa të tjera, asnjëra nuk është aq irelevante ose e parëndësishme dhe se a është bërë apo jo, nuk ka ndonjë rëndësi. Fakti se kolonializmi evropian ka arritur të korruptojë aplikimin e sistemit të emërimit Islam sidomos në mes të muslimanëve jo-arabë, në asnjë mënyrë nuk ndryshon këtë validitet.

Deri në kohërat kolonialiste, sistemi i emërimit perëndimor është degjeneruar në një grup të emrave pa domethënie, të pasuar me mbiemrin. Të ndikuar nga kultura greko-romake, në të cilën gratë konsideroheshin si pronë e burrave, shoqëritë perëndimore në martesë, fshinë mbiemrin e saj të vajzërisë dhe e zëvendësuan atë me mbiemrin e burrit.

Në sistemin e emërimit Islam, ajo mban mbiemrin e saj pasi me atë tregohet vija e vërtetë e saj. Mirëpo, të dyja këto trende degjeneruese perëndimore janë pranuar me të madhe nëpër tokat muslimane së bashku me grackat kulturore jo-Islame të kolonializmit evropian.

Muslimanët e rinj, të pavetëdijshëm për sistemin e emërimit Islam, shpesh pranojnë emrat arabë në stil kaotik evropian. Në fjalë, ata me prejardhje afrikane shpesh fshijnë edhe mbiemrat e tyre duke u bazuar në mendimet se ato emra janë nga koha e robërisë. Që do të thotë, mbiemrat e paraardhësve të tyre, të cilët kanë qenë robër, zakonisht, kanë marrë mbiemrin e pronarëve të tyre, dhe kështu emri ose mbiemri i pronarit është trashëguar nga gjenerata në gjeneratë.

Kështu, një individ që ndoshta është quajtur Clive Baron Williams, përderisa emri i babait të tij ka qenë George Herbert Williams, me hyrjen në Islam, mund që emrin e tij ta ndryshojë në Fejsal Omer Mehdi. Mirëpo, emri i tij, sipas sistemit të emërimit në Islam duhet të jetë Fejsal George Williams, që është, Fejsali, i biri i George Williamsit. Pjesa e emrit të babait të tij është e domosdoshme të përcaktohet se kush janë të afërmit e tij, me qëllim të ikjes nga martesat ndërfamiljare, të lirimit të të drejtave të prejardhjes dhe me qëllim të plotësimit të obligimeve të përgjithshme të marrëdhënies të gjakut. Kjo bëhet shumë e rëndësishme në përfundim, kur marrëdhëniet para-martesore dhe jashtë-martesore janë të zakonshme dhe të cilat çojnë në një gjeneratë të fëmijëve të afërm jo-legjitimë.

Si rrjedhë, kur disa nga këto gjysëm-vëllezër dhe gjysëm-motra hyjnë në Islam me mbiemra të ndryshëm, ekziston një mundësi reale që disa nga ata pa qëllim të

hyjnë në martesë ndërfamiljare. Praktika e muslimanëve të rinj e fshirjes së mbiemrit familjar, ka krijuar një shqetësim në mes të familjeve të tyre jo-muslimane, që shumë lehtë do të mund të shmangeshin nëse ishte miratuar sistemi i emërimit Islam.

Aktualisht, muslimani i ri nuk është nën asnjë obligim për ta ndryshuar madje edhe "emrin krishter" të saj ose të tij, nëse nuk ka domethënie jo-Islame. Kështu, emri i Clive, që do të thotë banor i kodrës nuk duhet të ndryshohet në Dennis, lloj i emrit Dionysus që do të thotë Ai i Dionysus-it (zoti grek i verës dhe fertilitetit i cili është adhuruar me rite orgjje).

Është plotësisht e pranueshme për një musliman, qoftë i konvertuar i ri ose jo, të ndryshojë emrin e tij apo të saj. Kjo ishte praktikë e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, të ndryshojë emrat e njerëzve nëse ato ishin negative ose jo-Islame. Njëra nga gratë e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, quheshte Berra (e virtutshme) dhe ai ia ndryshoi në Zejneb. (Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi)

Allahu, xhel-leshanuhu, në Kur'an ka thënë: "Mos lavdëroni veten, se Ai e di kush është më i ruajtur" (Nexhm: 32)

Ibën Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka treguar se babai i tij, Omeri, kishte një vajzë me emrin 'Asije (mosbindëse) të cilës Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ia kishte ndryshuar atë në Xhemile (e bukur). (Transmeton Muslimi)

Xhabir ibën Abdullah, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka treguar se Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka ndaluar emrat si Ja'laa (i/e ngritur), Bareqe (i/e bekuar), Efleh (e/i suksesshëm), Jesaar (i/e pasur) dhe Naafi (e/i dobishëm). (Transmeton Muslimi)

Megjithatë, i Dërguari i Allahut, sal-lallahu

alejhi ve sel-lem, asnjëherë nuk i ka ndryshuar emrat e të parëve (baballarëve) të njerëzve, pa marrë para sysh se sa jo-Islame kanë qenë ato. Për shembull, kur Abdush-Shams ibën Sahr pranoi Islamin, Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e refuzoi emrin e tij, Abdush-Shams (rob i diellit), dhe e emëroi atë Abdur-Rahman ibën Sahr (Ibën Haxher el-Esçalani). Emri i babait të tij, Sahr (gur), mbet i paprekur.

Njëjtë, emri i Ebu Seleme-s ishte ndryshuar në Abdullah ibën Abdul-Asad, duke e lënë emrin e babait të tij Abdul-Asad (rob i luanit) të pandryshuar. (Ibën Xhevzi)

Kështu, mund të përfundohet se fshirja e mbiemrit të një personi është kundër shkrimit dhe frymës së ligjit Islam. Emri dhe mbiemri i babait duhet të mbahet, dhe nëse babai nuk dihet, atëherë pas emrit të dhënë ose të zgjedhur të muslimanit, duhet të pasojë emri dhe mbiemri i nënës.

Por, duhet të theksohet se ekzistojnë tituj të tjerë dhe emra përshkrues që mund të shtohen ose para ose prapa emrit aktual të personit.

Sipas sistemit të emërimit Islam, emrat prefikse (nofkat) përbëhen nga Ebu (babai i) në rastin e meshkujve dhe Umm (nëna e) në rastin e femrave, që pasohet me emrin e fëmijës më të madh të personit, ose djalit të tij ose fëmijës së dëshiruar.

Disa njerëz janë bërë aq mirë të njohur për nga nofkat e tyre sa që emrat e tyre gati janë harruar. Për shembull, ndërmjet Sahabëve (shoqëruesve të Muhammedit, alejhisselam) Ebu Bekr (Abdullah ibën Othman), Ebu Hurejre (Abdur Rahman ibën Sahr), and Ebu Lejla (Bilal el-Ensari).

Kujdes poashtu duhet të ketë gjatë emërimit të vajzave, pasi që praktika e emërimit të vajzave me dy ose tre emra para mbiemrit, është praktikë perëndimore që

nuk është në përputhje me sistemin e emërimit Islam. Për shembull, një vajzë me emrin Esmaa Xhemile Zejneb Abdullah emri i babait të së cilës është Zejd Abdullah, në të vërtetë duhet të quhet Esma Zejd Abdullah, që do të thotë, Esma vajza e Zejd Abdullahut. Kjo praktikë është për shkak të faktit se emri i dhënë i mashkullit ose femrës, sipas sistemit të emërimit Islam, duhet të pasohet vetëm nga emri i nënës së tij ose saj, nëse babai nuk dihet, ose se fëmija është jo-legjitim dhe se prindërit nuk ishin martuar.

Kështu, emri Esma Xhemile Zejneb Abdullah në sistemin e emërimit Islam do të thotë Esma është vajza jo-legjitime e Xhemiles dhe se nëna e saj Xhemiles poashtu është vajzë jo-legjitime e Zejneb-it, vajzës së Abdullahut.

Emrat e ndaluar në Islam

Ekzistojnë emra që janë në kundërshtim me Sheriatin (Ligjin Islam) ose kanë domethënie që janë të paparanueshme për njerëzit me intelekt të shëndoshë dhe me shpirt të pastër. Këtyre emrave duhet t'iu shmangemi, pasi që dhënia e emrave të tillë fëmijëve do të ishte krim kundër Dinit dhe sjelljeve të tyre, për shkak se ato do të rriten të lidhur me emrat e tyre dhe me domethëniet që ato i kanë.

Emrat e ndaluar ndahen në dy kategori: emrat të cilat janë të ndaluara në Sheriat dhe emrat që janë të refuzuar ose për shkak të Sheriatit ose për shkak të sjelljeve dhe shijes së mirë.

Emrat e ndaluar:

1. Emrat që tregojnë shërbim dikujt tjetër përveç Allahut, xhel-le shanuhu, siç është: 'Abdun-Nebi (rob i Pejgamberit), 'Abdur-Resul (rob i të Dërguarit) dhe çfarëdo emri tjetër i ngjashëm me këto. Domethënie të njëjtë kanë emrat 'Gulamun-Nebi' dhe Gulamur-Resul'.

2. Përdorimi i emrave që janë emrat të caktuar të Allahut, xhel-le shanuhu, si: al-Ahad (Një dhe i Vetmi, Unik në Zotimin e tij, emrat dhe atributet, dhe e Drejta e tij për adhurim. Një, që do të thotë pa shok, pa ndihmës, pa rival dhe pa ndonjë gjë të ngjashme me Të), er-Rahman (Më i Mëshirshmi) dhe el-Halik (Krijuesi).

3. Nga emrat e ndaluar për djemt dhe vajzat tona sidomos ato të jo-muslimanëve, si: George, David, Michael, Joseph, Diana, Jaclyn, etj., pasi që përdorimi i këtyre emrave shkakton – herët apo vonë – dashuri ndaj tyre ose ndjenja të afërsisë me to dhe imitimi i tyre në sjelljet dhe zakonet e tyre, që ne – muslimanët – jemi të ndaluar të imitojmë jo-muslimanët dhe të kemi dashuri ndaj tyre si dhe lidhje shoqërore (miqësore)

4. Nga emrat prej të cilave duhet të largohemi janë emrat e tiranëve dhe despotëve si: Fir'aun (Faraoni), Karun, Ebu Xhehl dhe të ngjashmit e tyre, poashtu edhe emrat e udhëheqësve të kufrit dhe kryesuesve të ateizmit siç është Marks, Lenin dhe kështu me rradhë, pasi përdorimi i këtyre emrave do të thotë se një person ka qenë i kënaqur me veprimet e tyre, dhe do të thoshte imitim të tyre, dhe dashuri ndaj sistemeve të tyre të mendimit – dhe e gjithë kjo është e ndaluar.

Emrat që janë të refuzuar në Islam ose të refuzuar për shkak të sjelljeve dhe shijes së mirë:

1. Dhënia e emrave që kanë për qëllim të tregojnë shërbim Allahut por që nuk dihet se janë nga emrat e përsosur të Allahut, xhel-le shanuhu – si 'Abdul-Mevxhud, Abdul-Maksud dhe 'Abdus-Settar. Kjo për shkak se asgjë nuk mund të pohohet si një nga emrat e Allahut, xhel-le shanuhu, pa ndonjë tekst autentik, dhe këto emra nuk plotësojnë këtë kriter sepse ato janë attribute dhe informata,

dhe kështu duhet të druajmë se në këtë mënyrë ne mund t'i japim Allahut, xhel-le shanuhu, emra që as Ai e as i Dërguari i Tij, alejhis-selam, nuk i kanë përdorë për Të.

2. Nga këto emra janë emrat që mbajnë domethënie të pesimizmit, ose karakteristika të fajit, që nuk do të pëlqehen ose shkaktojnë averzion ose madje edhe poseduesin e atij emri të ndjehet i degraduar, i nënçmuar dhe në këtë mënyrë do të vriste personalitetin e tij – si Harb (luftë), Himar (gomar), dhe Kelb (qen) – dhe të ngjashmit më to, që zakonisht përdoren si emra nga njerëzit e shkretirës ose fshatrave.

3. Për shkak të sjelljes së mirë duhet të shmangemi nga emrat që janë sugjerues ose ofendojnë kuptimin e turpit të një personi – si: Hujam (i dashuruari), Nahid (vajza e re me gjinj të mëdhenj!), Visal (union seksual), Gada (grua e re delikate), Fatin (joshëse), Fitne (tunduese), Shadije (këngëtare) dhe emra me domethënie të ngjashme.

Pra, etërit dhe nënat duhet të jenë të vetëdijshëm për dhënien e këtyre emrave fëmijëve të tyre – pasi që ato janë emra që kryesisht mbahen nga aktoret e shashtisura filmike dhe vallëtalet, dhe se përdorimi i këtyre emrave mund të jetë rrezik për personalitetin e fëmisë dhe shoqërisë – pasi që ai do të rritet si i ngjitur për ta së bashku me domethënien që e kanë dhe për personat famëkëqinj që i mbajnë ato emra. Atëherë, kjo mund t'i çojë ata të imitojnë ata njerëz dhe të pasojnë rrugën e tyre, ngadalë duke e humbur personalitetin e tyre Islam, Allahut, xhel-le shanuhu, i kthehemi për ndihmë.

4. Poashtu nuk është mirë të jepen emra që përmbajnë deklarata të virtyteve të personit, si: Berra (i virtytshëm) dhe emrat e ngjashëm – për shkak të kësaj domethënie Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e ndryshoi emrin e njërit nga grave të tij nga Berra në Zejneb.

5. Emrat e melekëve, sidomos nëse ato përdoren për femrat – siç është Melik pasi nga kjo duhet të druhet se përfshin imitim të paganëve që engjujve u jepnin emra femërore. Por, sa i përket përdorimit të atyre emrave (emrat e melaqeve sh.r.) për meshkujt – atëherë kjo nuk pëlqehet (mekruh) nga Imam Malik-u, por lejohet nga një grup i dijetarëve, pasi hadithi që e ndalon këtë gjë nuk është autentik.

6. Njëjtë nuk pëlqehet të bëhet emërimi me emra të sureve të Kur'anit siç është: Taha, Jasin dhe emrat e sureve tjera. Kjo është thënie e Imam Malik-ut. Ibën Kajjim poashtu ka thënë: “Thënia për njerëzit e zakonshëm se Jasin dhe Taha janë nga emrat e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nuk është e drejtë, nuk ekziston ndonjë hadith autentik rreth kësaj...”

7. Nuk pëlqehet të jepen emra si 'Jesaar' (i lehtësuar), 'Rebah' (përfitim), 'Naxhi' (i suksesshëm), 'Eflah' (i përparuar), 'Ja'la' (i ngritur)' dhe Bereqe' (i bekuar) pasi që Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e ka ndaluar këtë me thënien e tij: “Mos e quani djalin tuaj Jesaar, as Rebah, as Naxhi, as Eflah, pasi do të thoni: 'A është ai atje?' Kështu do të thuhet: 'Jo'. Vërtetë ato janë katër, pra mos më atribuoni më shumë”. (Transmetojnë Muslim, Ebu Davud dhe Et-Tirmidhi).

Ndalesa për Ja'la dhe Bereqe paraqitet në një hadith tjetër të transmetuar nga Muslimi.

Ndryshimi i emrave të ndaluar

Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka dashur emrat që kanë qenë të mirë për tu shqiptuar dhe kanë pasur domethënie të mirë, ndërsa i ka urrejtur emrat e tjerë, i ka ndaluar dhe i ka ndryshuar. Nga emrat që Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka ndryshuar janë:

- 'Aasije (mosbindëse) – këtë emër ai e ka ndryshuar në Xhemile (e bukur dhe e mirë) (Transmetojnë Muslimi dhe Ebu Davudi)
- Hazn (i ashpër) në Sahl (i butë). (Transmetojnë Buhari dhe Ebu Davudi)
- Berra (grua e virtytshme) në Zejneb (Transmeton Muslimi)
- Es-Surm (ndarje/i ndarë) në Sa'eed (i gëzuar, i lumtur) (Transmeton Buhari)
- Esrem (i prerë) në Zur'aa (farë e mbjellur) (Transmeton Ebu Davudi)
- Xheth-thame (joaktiv/e) në Husane (i/e mirë dhe i/e bukur) (Transmeton Hakimi)
- Shihab (Zjarr) në Hisham (Transmeton Buhari)
- Harb (Luftë) në Silm (paqe) (Transmeton Ebu Davudi)
- Benuz-Zina (djem të paligjshëm) në Benu-Rishde (djem të martesës ligjore) (Transmetuar nga Ebu Davudi).

Dr. Bilal Philips

Marrë nga: IslamWeb

Solli në shqip: Xh.A.

Redaktuar nga: R.R. (Albislam.Com)

[I përpiluar nga "Manners of Welcoming the New Born Child in Islam" (Mënyrat e mirëpritjes së fëmijës së posalindur në Islam), nga Jusuf ibën 'Abdullah El-'Arifii] 3.12.2004

Kremtimi i martesave në xhami

Kremtimi i martesave në xhami është një praktikë e përditshme. Njerëzit e Mekës dhe Xhides, për shembull, dëshirojnë t'i kremtojnë martesat e tyre në Mesxhidin Haram, përderisa xhamia është afër tyre. Kjo i ka bërë shumë njerëz që të shqetësohen me ndjekjen e sunnetit për të pyetur nëse kjo praktikë është e sanksionuar nga sunneti.

Së pari ne duhet të konsiderojmë faktin e hadithit. Një hadith i cili është i transmetuar nga Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i cili ka thënë: "Lajmëroni martesën, kremtojeni në xhamija dhe bieni tamburevë me rastin e saj". [Sunen et-Tirmidhi (1089) dhe Sunen el-Bejhaki (7/290-15065)]

Megjithatë, hadithi ka një zinxhir të dobët transmetimi përderisa përmban transmetuesin Isa ibën Mejmun, i cili transmeton nga Kasim bin Muhammed nga Aisheja nga Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

El-Bejhaki ka thënë: "Isa ibën Mejmun është një transmetues i dobët".

El-Tirmidhiu ka thënë: "Isa ibën Mejmun el-Ansari është i konsideruar i dobët në hadith".

Edh-Dhehebi na informon që el-Buhari ka thënë: "Isa ibën Mejmun i cili transmeton hadithin "kremtojeni martesën..." është një transmetues i dobët i cili nuk llogaritet". [Mizan el-tidal (3/326)]

Edh-Dhehebi gjithashtu na informon që Abdur-Rahman bin Mehdi ka thënë: "Unë u përballa me të (Isa ibën Mejmun) rreth tij dhe i thashë: "Çfarë janë këto hadithe që

transmeton nga Kasimi, nga Aisheja?" Ai është përgjigjur: "Unë nuk do t'i përsëris më". [Mizan el-Itidal (3?325)]

Albani e deklaroi hadithin si të dobët, në të dy; në Irva el-Galil (nr.1993) dhe në Silsiletul el-ehadith ed-Daife (nr.978).

Unë nuk jam në dijeni për asnjë hadith të saktë ku Pejgamberi ose e ka urdhëruar ose e ka ndaluar kremtimin e martesave në xhami. Unë nuk kam has asnjë lloj të ngjajshëm ose në lidhje me këtë. Shejh Uthejmini e konfirmon këtë në komentimin e tij mbi veprën ligjore Hanbelite Zad el-Mustegni, ku ai komenton mbi këtë çështje nëse është e preferueshme për të kremtuar martesat në ditën e premtë (xhuma) duke thënë: "Ibën Kajjimi e përmend që është pranueshme që martesa të kremtohet në xhami ashtu si dhe ditën e premtë për shkak të nderit të kohës dhe vendit. Megjithatë, kjo është e diskutueshme në dy llogari, përderisa të ketë diçka në sunnet që e mbështet atë. Nëse ka atëherë, mirë. Megjithatë, unë nuk di për asgjë në sunnet që e mbështet atë". [Esh-Sherh el-Mumti (5/132)]

Përsa i përket praktikës së Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ne kemi çfarë është e transmetuar në hadithin e mëposhtëm rreth një gruaje e cila iu afrua të dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe i ofroj veten e saj atij për martesë: Ajo tha: "O i dërguar i Allahut, unë kam ardhur tek ti të të besoj veten time".

Një person nga mesi i sahabeve të tij u ngrit në këmbë dhe tha: "O i dërguar i Allahut martoje atë me mua nëse nuk ke nevojë për të".

Ai Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "A ke ndonjë gjë me vete (për t'ia dhënë asaj në mehër)?" Ai tha: "Jo, O i dërguar i Allahut, Vallahi unë nuk kam asgjë".

Atëhere i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka thënë: "Shko tek njerëzit e tu (familja) dhe shiko nëse të gjejnë ndonjë gjë". Ai u kthye dhe i tha: "Unë nuk kam asgjë". I Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha: "Shiko, madje edhe për një unazë hekuri".

Ai i tha atij: "A di ndonjë pjesë prej Kur'anit?" Ai i tha: "Unë e di këtë dhe atë kapitull (dhe ai i numëroj ato)".

Atëhere i dërguari i Allahut i tha: "Shko, se po ta jap atë në martesë për pjesën e Kur'anit që ti di". [Sahih el-Buhari (5149) dhe Sahih Muslim (1425)]

Ibën Haxher el-Eskalani në komentimin e tij të këtij hadithi, na informon ne që në një transmetim të këtij hadithi nga Sufjan eth-Thevri, është e përmendur që kjo ndodhi ka ndodhur në xhami. [Feth el-Bari (9/113) Këtu ne kemi një situatë ku i dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kremtoi një martesë në një xhami, megjithëse duhet pranuar, se duket që vendi ishte më tepër i rastësishëm sesa bërë më qëllim.

Së dyti, kur ne i kthejmë vëmendjen tonë opinioneve të juristëve, ne shohim që juristët e të katër shkollave kanë rënë dakord që është sunnet për ta kremtuar martesën në xhami.

Ibën Tejmijje thotë: "Është e preferueshme për të bërë kontratën e martesës në xhami". [Mexhmu el-Fatava (32/18)]

Ibën Kasimi shkruan: "Është sunnet për të kremtuar atë në xhami. Kjo është çfarë Ibën

Kajimi ka thënë dhe ai është i besueshëm, dijetarë besnik i cili nuk deklaroi diçka të jetë Sunnet përveç se kur ka baza legjitime për të vepruar kështu". [Hashije el-Ravd el-Murbi (6/243)]

Së fundi ne kemi nevojë të konsiderojmë që arsyeja për bërjen e kontratës martesore në xhami është për të kërkuar bekimet e të vepruarit kështu në atë vend. El-Mubarekfuri, në komentimin e këtij hadithi tek Sunen et-tirmidhi e diskuton hadithin : "Lajmërojeni martesën, kremtojeni në xhamija dhe bieni tamburinëve më rastin e saj" dhe ka thënë:

Përsa i përket dëshmisë "kremtojeni në xhamija" kjo është ose për shkak të kryerjes së martesës me lehtësi për ta bërë publike ose për përfituar bekimet e vendit". [Tuhfat el-ehvedhi (4/210)]

Pjesa e bekimeve në el-Mesxhid el-Haram në Mekë është shumë më e madhe. Allahu thotë: "Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar". [el-Isra : 1]

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë rreth Mekës: "Me të vërtetë, është më e mira e tokës së Allahut dhe më e dashura e tokës së Allahut për Allahun". [Musned Ahmed (4/305) dhe Mustedrek el-Hakim (3/7) me një zinxhir transmetimi të saktë]

Çfarë mbetet tani, megjithatë, është pyetja sesi ne jemi të supozuar ta kuptojmë bekimin e këtyre vendeve.

Urve tranmseton nga Aisheja që ajo ka thënë: "I dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, më martoi mua në muajin e Shevalit dhe e kremtoj martesën në muajin e Shevalit. Kështu atëhere, cila nga gratë e pejgamberit ishte më e favorizuar nga ai sesa unë?"

Urve atëhere komentoi që Aishe preferonte që gratë e nivelit të saj të kremtonin martesat e

tyre në muajin e Shevalit. [Sahih Muslim 1423]

Ky hadith na ofron ne me dy gjëra. Së pari është ajo që hedh poshtë supersticionet që urrenin të kremtonin martesën në muajin e Shevalit që ekzistonte midis Arabëve para islamit.

Më e rëndësishme për atë që ne po diskutojmë është që ky hadith tregon lejueshmërinë e ndjekjes së vepër së vetme të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, edhe madje kur nuk ka asnjë fakt që i rrethon rrethanet e veprës në mënyrë të veçantë ose edhe nëse janë vetëm koïçidencë. Nëse Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, të kishte patur qëllim muajin e Shevalit si kohë për martesën dhe për kremtimin e saj, ai me doemos do ta kishte shprehur këtë në terma të qartë përderisa fjalët e tij na sjellin një tregim më vendimtarë të të tilla gjërave sesa veprat e tij.

Fakti i vetëm që Pejgamberi, sal-lallahu

alejhi ve sel-lem, kremtoj një martesë në xhami na pengon ne për të ndërtuar preferencën e një personi për ta bërë atë si bidat, përderisa dhënia e preferencës një vendi (xhamisë) nuk është ndryshe nga ajo çfarë Aishe bëri duke i dhënë preferencë një kohe (muajit të Shevalit).

Shkurtimisht, ne themi që është e lejueshme për një person për t'i dhënë preferencë xhamisë si vend për të kremtuar martesën. Të vepruarit kështu nuk është një bidat apo një akt i pabazë. Megjithatë, nuk ka asnjë fakt për të thënë që në ligjin islam merr gjykimin e të qënurit diçka e preferuar ose që është sunnet për të kremtuar martesën në xhami. Në të njëjtën kohë, ne nuk i sanksionojmë ata të cilët e shikojnë atë si diçka të preferueshme nga ana islame, duke pasë në konsideratë faktin që ky është opinioni i shumë dijetarëve të mëdhenj.

Hani el-Xhubejr
(gjykatës në Gjykatën e Mekës, Arabia Saudite)
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
26.11.2004

Disa gra dijetare

Nëse ne do të shikonim në veprat e biografive të shkruara nga dijetarët, si enciklopedia e Dhehebiut; Sijer Al'am en-Nubela, ne do të gjejmë biografite e shumë grave të përmendura për çdo kohë të historisë islame.

Ne do t'i përmendim vetëm pak nga dijetaret e ndershme nga kohëra të ndryshme:

Muadhe el-Adevijje (83 h). Një nga dijetaret dhe transmetueset e besueshme nga gjenerata e tabi'inëve. Ajo ka transmetuar nga Ali ibën Ebu Talib, Aisha dhe Hisham ibën Amiri.

Amra bint er-Rahman ibën Sad el-Ensarije (98 h). Ajo ishte një tabi'ine dhe një talebe e Aishes. Ajo gjithashtu ka mësuar nga sahabet, Umm Selemme dhe Rafi bin Hadixhe. Ajo ishte një nga juristët më të rëndësishëm të Medines nga gjenerata e tabi'inëve.

Hafsa bint Sirin el-Ensarije (100 h). Ajo ishte një talebe e Ummi Atije-s, Enes bin Malik dhe sahabëve të tjerë. Ajo ishte një nga juristët nga gjenerata e tabi'inëve. Katade ishte një nga studentët e saj.

Ame el-Vahid bint el-Mehamili (377 h). Ajo ishte një juriste e dalluar e medhhebit shafi'i dhe një mufti në Bagdad.

Qerime bint Ahmed el-Marvezijje (463 h). Ajo ishte një nga transmetueset më të rëndësishme të Sahih el-Buharit dhe ka patur shumë studentë të sukseshëm, duke përfshirë këtu edhe Hatib el-Bagdadi-n.

Zejneb bint Abd r-rahman bin Hasan bin Ahmed bin Sehl el-Xhurxhanijje (615 h). Ajo ishte një dijetare nga Horasani. Ajo ishte një

studente e dijetarit të famshëm të gjuhës el-Zemahsheri, nga i cili ajo mori ixhazet (një diplomë akademike).

Jasemin bint Selim el-Harimije (634). Ajo ishte një dijetare e hadithit. Ibën Bulbna ishte një nga studentët e saj më të sukseshëm.

Zejneb bint Mekki bin Ali bin Kemil el-Harranije (688 h). Ajo ishte një dijetare e famshme nga Damaski dhe një mësuese e Ibën Tejmijjes, dijetarit të hadithit el-Mizi (autorit të Tehdhib el-Kemal) dhe shumë të tjerëve.

Zejneb bint Umar bin Kindi bin Said el-Dimashkijje (699 h). Ajo ishte gjithashtu një nga mësuesit e dijetarit të famshëm të hadithit el-Mizzit.

Hatixhe bint Abd ur-Rahman el-Makdisijje (701 h). Ajo ishte një dijetare dhe shkrimtare, një studente e Ibën ez-Zabidit dhe të tjerëve. Ajo ishte gjithashtu një nga mësuesit e dijetarëve të hadithit, el-Mizi-t.

Zejneb bint Sulejman bin Ibrahim bin Rahme el-Es'ardi (705 h). Ajo ishte një nga mësuesit e es-Subkit dhe edh-Dhehebiut. Ajo e ka dëgjuar sahahun nga Ibën ez-Zebidi.

Fatime bint Ibrahim el-Badi (711 h). Ajo ishte gjithashtu një studente e Ibën Zebidit dhe një mësuese e es-Subkit dhe shumë të tjerëve.

Fatime bint Abbas bin Abu el-feth el-Hanbelijje (714). Ajo ishte një juriste hanbelite dhe mufti, së pari në Damask pastaj në Kairo.

Abd el-Vehab et-Turejri

Përgjegjës i seksionit të fetvave tek IslamToday.net

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

3.12.2004

Imam Hisham ed Destuvai

Njëri prej imamëve i periudhës më të dalluar i lëmive fetare. Autoriteti i pamohueshëm dhe Hafidhi që kishte tubuar një numër të madh të haditheve. Në autoritetin e tij janë mbështetur shumë autorë gjatë përpilimit të librave të tyre.

Quhet Ebu Bekr Hisham ibën ebi Abdil-lah Senber El Basri Er Reb'ij. Ka qenë i njohur me nofken Ed Destuvai sepse ka bërë tregëti me stufe që janë sjellur prej vendin Destuva në afërsi të qytetit Ahfaz në Iran.

Nuk ka informata precize për datëlindjen e tij por dihet se është lindur në vitin 75 H.

Përfitoi prej shumë mësues nga mesi i të cilëve do t'i përmendim: Jahja ibën Ebi Kethir, Katade, El kasim ibën Ebi Bezze, Hammad el Fekih, Ibën Ebi nexhij, Ejjub Es Sihtijani, Asim ibën Behdele etj.

Nga dija e tij e gjërë përfituan shumë dijetarë që me plotë drejtë konsiderohen imamë të kohës së tyre. me përmendje do t'i veçojmë:

Shu'be, Ibën El Mubarek, Jezid ibën Zurej, Ibën Ulejje, Abdur Rahman ibën Mehdi, Jezid ibën Harun, Ebu Nu'ajm, Ebu Seleme Et Tebudheki dhe shumë tjerë.

Shu'be thoshte: "Me të vërtetë e kërkonte hadithin për hirë të All-llahut."

Ibën Me'in: "Kur Jahja El Kattan dëgjonte

ndonjë hadith prej Hishamit nuk u brengoste që të mos e dëgjon prej tjerëve."

Ebu Davud Et Tajalisi thoshte: "Hishami ishte prijesi i besimdrejtëve në hadith."

Kur Imam Ahmedin e pyetën për Hishamin tha: "Mos pyet për të, nuk di për ndonjë transmetues më besnik se ai."

Ebu Nua'jmi kështu e përshkruante: "Prej tyre (evlijatë) është edhe i sinqerti në ruajtjen e haditheve, i rrjedhshmi në transmetimin e tyre, përmendja e All-llahut ishte shoqëruesi i tij kurse frika prej dënimit të tij ishte aleati i tij. Quhet Hisham ibën Ebi Abdil-lah Ed Destuvai.

Dhehebi: Hafidhi, autoriteti, Imam i sinqertë...

Ibën Fejadi: Nga të qajturit e shumtë iu prishën sytë dhe shumë pak shihte.

Thoshte: Po habitem me të qeshurin e dijetarit. Pse nuk po thotë: "Ah sikur të shpëtojmë nga sprova me dijen që na është dhënë, ajo është argument në favor tonin ose kundër neve."

Djali i tij Muadh ibën Hisham thotë: Jeta e babës tim në këtë botë zgjati shtatëdhjetë e tetë vjet.

Ndërroi jetë në vitin 153 H. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë. Amin

Talha Kurtishi,
3.12.2004

Ibën Ebi Dhi'b

Shejhul Islam Ibën Ebi Dhi'b është njëri prej dijetarëve të rrallë që meritoi emërtimin më këtë titull më të lartë në klerarkinë e dijetarëve islam. Imam i periudhës më të dalluar të historisë islame, periudhen e tre gjeneratave të bekuara të cilëve u referohemi me termin Es Selif Es Salih (paraardhësit e mirë).

Quket Ebul Harith, Muhammed ibën Abdur Rahman ibën El Mugire ibën El Harith ibën Hisham ibën Shu'be El Kureshi El Amiri El Medini...

I lindur në vitin 80 H pati fatin të mëson nga dijetarët e mëdhenj të gjeneratës së tabi'inëve që trashëguan dijen e shokëve të Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Mësues të tij ishin Ikrimë, Se'id El Mekburij, Nafi'u, Muhammed ibën El Munkedir, Shu'be dhe shumë tjerë.

Fjalët e dijetarëve për të:

Ahmed ibën Hanbeli thoshte: "E përgjasonin me (imamin e tabi'inëve) Se'id ibën El Musejeb."

El Vakidiu thotë: "Ishte njeriu më i mirë dhe më modestë..."

Jahja ibën Me'in: Ibën Ebi Dhi'bi ka qenë Thikka (i besueshëm në transmetimet e tij).

Ibën Hibbani: "Ishte njëri prej fukahatë eMedinës, i dalluari me adhurim..."

Dhehebi: Ishte besnik dhe i pranuar tek njerëzit, njëri prej bartësve të dijes, i respektuari gjuha e të clit fliste të vërtetën...

Kjo famë të cilën e arriti u bë shkak që vazhdimisht të vizitohet nga kërkuesit e dijes që prej tij mësonin hadithet e të Dërguarit dhe fikhun (jurisprudencën islame).

Prej nxënësve të tij do t'i përmendim: Ibën El Mubareku, Jahja El Kattan, Sufjan Eth Theuri, Adem ibën Ebi Ijas, Veki' ibën Xherrah, Ali ibën Xha'd, El Velid ibën Muslim, Abdullah ibën Vehb dhe shumë tjerë...

El Vakidiu kështu e përshkruante atë: "Falej tërë natën, ishte në ibadet të vazhdueshëm..."

Agjëronte agjërimin e Davudit, alejhi selam.

Ebul Ajna rrëfen: "Kur halifeja El Mehdi vizitoi xhaminë e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të gjithë u çuan në këmbë përpos Ibën Ebi Dhi'bit. I thanë ky është prijësi i besimtarëve ngritu në këmbë. Tha: Unë i ngrihem në këmbë vetëm Zotit të botërave. Mehdiu tha: Lëre sepse gjithë qimet e trupit m'u çuan përpjet nga frika, ma kujtoi ajetin: "A nuk e dinë të tillët se kanë për t'u ringjallur? Në një ditë të madhe. Në ditën kur njerëzit ngrihen (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve." (El Mutaffifin, 4-6)

Ai gjithashtu rrëfen dialogun mes tij dhe halifës El Mensur: Ibën Ebi Dhi'bi tha: Është uri e madhe, pse nuk u ndan të varfurve nga plaçkat e luftës? El Mensuri tha: Për të kanë nevojë ushtarët në front. Po të mos ishin ushtarët armiku do të vinte në shtëpinë tënde (Medine). Ibën ebi Dhi'bi tha: Në kohën e Omerit, radijall-llahu anhu, kishte mjaftë edhe për ushtarët edhe për nevojtarët. Kur El Mensuri i dëgjoi këto fjalë e uli kokën dhe tha: Ky është më i miri prej banorëve të Hixhazit.

Nga këto fjalë kuptojmë se ai asnjëherë nuk trembej që të thotë të vërtetën në praninë e sundimtarëve.

Për veprimtarinë e tij të shkruar Dhehebiu thotë se ka shkruar një libër të madh në të cilin ka tubuar hadithe. Këtë libër ne sot nuk e kemi por emri i tij është i shënuar në gati çdo libër të hadithit dhe fikhut.

Vdiq në vitin 158 H në qytetin e Kufës. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë. Amin. (Burimet: Tehdhibut Tehdhib, Sijer A'lam En Nubela)

Talha Kurtishi, 10.12.2004

Tema: Vizita e farefisit

Numri: 1187 **Data:** 13.12.2004

Pyetje: ...babai im ka ndru jetë kur unë isha 6 vjeçar, nëna ime me mua dhe motrën time është përzënë - fjalë ma me vend - nga shtëpia e babait... elhamdulillah prej Allahut që më mëshiroi dhe më udhezoi e më largoi nga rruga e xhahilijetit, tani familja ime nga ana e babait ka filluar të interesohet për mua... une e di se lidhja farefisnore është ngushtë e lidhur për Arshi por nuk di si të veproj kur une nuk kam fare ndjenja për ta dhe ftesave të tyre nuk i përgjigjem fare ose negativisht... para sa kohe kanë pasur syneti dhe më kanë ftuar... por disi më dukej si të shkoj te nje familje e huaj që as nuk i njoh bile...

Përgjigje: All-llahu ta shtoftë kujdesin për njohjen dhe zbatimin e fesë... Kjo që ke parashtruar këtë pyetje, pa dyshim tregon për brengën që ke si musliman, edhe mendoj se kjo është një gjë shumë e dobishme dhe pozitive në jetën tënde si musliman...

Sa i përket çështjes që e ke parashtruar tek ne, pa dyshim se vazhdimi i lidhjeve farefisnore është obligim fetar, sidomos kur ata janë sjellur keq me ty, sepse kjo është përkujdesi për lidhjet farefisnore, siç ka treguar Pejgamberi, alejhis-selam: "Nuk përkujdeset për farefisin, ai që ua kthen vizitën, por ai që kur ata nuk e vizitojnë ky i viziton ata".

Duke potencuar në ndejat me ta se këtë e bëj vetëm sepse kështu më mëson islami, e jo për ndonje gjë tjetër, që të bëhet kjo vizitë edhe shkak për udhëzimin e tyre...

All-llahu të dhashtë sabër për të gëlltitë ato të këqija që ti kanë bërë, edhe tua kthesh të keqen me të mirë, sepse kështu na mëson Kurani: "Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt. Mirëpo këtë nuk mund ta arrijë kush, pos atyre që janë të durueshëm, dhe nuk mund ta arrijë kush, pos atyre që kanë virtyt të lartë. E nëse ty të ngacmon ndonjë ngacmim prej djallit, ti kërko mbrojtje prej All-llahut, se vërtet Ai është dëgjuesi, i dijsmili". (Fusilet: 34-36).

Shko vizitoi, keshilloi dhe kujdesu për ta aq sa ke mundësi, se kjo është ibadet... All-llahu e di më së miri...

Bekir Halimi,
13.12.2004

Mezhebi i ehli hadithit

“...Mezhebi i ehli hadithit është mezhebi i katër imamave të fikhut të cilët thanë: “kur të jet i vërtetë hadithi, ai është mezhebi im”. Thotë Imam Shafiu kur ju drejtua nxënësit të tij Imam Ahmed ibën Hanbelit, dhe i tha atij: “O Ahmed kur të arrijë hadithi sahih (i vërtetë), më njohto për të, ju jeni më të ditur për të se unë”. Pa marrë parasysh se ky hadith a vjen prej Shami, Egjypti apo Hixhazi në shohim Imam Shafiun duke i thënë nxënësit ti je më i ditur për hadithin se unë. Me rëndësi është që transmetuesi të jet thika (i besueshëm) dhe kjo është prej edukatës, fesë dhe verasë (druajtje nga devotshmëria) së Imam Shafiut, që ai nuk pati fanatizëm për vendin e vet. Ai ishte nga Mekeja dhe më vonë kah fundi

i jetës së tij ishte imam në Bagdad e pastaj në Egjypt. I tha Imam Ahmedit “prej cilit do vend që të vijë hadithi më njohto për të që të punoj me te”. Kjo ngase sa do që njeriu të dijë nga sunneti i mbetet shume e shumë nga ai. Imam Shafiu ishte imam në hadith dhe në fikh por kërkoi ndihmë nga dikush që ishte më i dijshtëm se ai në hadith e ai ishte Imam Ahmedi. Ne morrëm nga fjala e Imam Shafiut drejtuar Imam Ahmedit një plan për fitim të diturisë e ai është se; duhet ta marrim hadithin prej cilitdo fikh që të jet ai, pa marrë pasysh se a është në fikhun hanefi, shafii, maliki apo në ate hanbeli me një kusht që ai hadith të jetë i vërtetë...”

Shejh Muhammed Nasiruddin Albani

Marrë nga:

“elhavi min fetava shejh Albani” v.2 f.300, botuar më 1996

Përktheu: R.R. (AlbiIslam.Com)

12.12.2004

Libri - Katërdhjet hadithe mbi moralin

17. Butësia

Transmeton Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka thënë Eshexh ibën Abdulkajisit: "ti i posedon dy cilësi të cilat i don Allahu, subhanehu ve teala: sjellja e butë dhe maturaia." (transmeton Muslim)

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Ata që e frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit" (Ali Imran: 134). Dhe: "Ti (Muhammed) merre të lehtë, urdhëro për të mirë dhe hiq prej të padijshmëve". (A'raf: 199)

Është thënë se sjellja e butë (el-hilm) është gllabërimi i mllëfit. Gjithashtu sjellja e butë është definuar si: frenimi i vetes në raste kur kritikohet apo sulmohet, për të mos rënë në atë që s'është e dëshiruar. Sjellja e butë përfshinë njohjen e drejtë, durimin, maturinë, përmbajtjen kurse nuk është bashkuar një gjë me një tjetër më bukur se sa falja e gabimit me mundësinë për hakmarrje.

Në një fjalë të urtë thuhet: nuk është i butë ai që kur i bëhet padrejtësi sillet me butësi e kur t'i jepet mundësia hakmirret por i butë është ai i cili kur i bëhet padrejtësi sillet me butësi kurse kur i jepet mundësia për t'u hakmarrë ia falë.

Dijetari Damre ka thënë: sjellja e butë (el-hilm) është shkallë më e lartë së mendja (logjika) sepse Allahu, subhanehu ve teala, është quajtur me këtë emër (El Halim) dhe kjo e bën më të lartë, pastaj nuk është quajtur me këtë emër në Kur'an përveç Ibrahimit dhe Ismailit, alejhima selam, Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "S'ka dyshim, Ibrahimisihte shumë i ndieshëm dhe i butë". (Teube: 114), gjithashtu për Ismailin, alejhi selam, thotë: "Ne e gëzuan atë (Ibrahimin) me një djalë që do të jetë i butë (i sjëllshëm)". (Saffat: 101)

Njeriu me sjellje të butë është me pozitë të lartë, i lavdëruar dhe veprat e tij janë të pëlqyera. Sjellja e butë është më e bukur se çdoherë atëherë kur rrjedh nga ai që ka mundësi për t'u hakmarrë. Që kënde, konkludojmë se sjellje të butë e të mirë ka ai i cili Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e merr shembulltë, prijës në çdo cilësi të moralit, stoliset me to, ec rrugës së tij dhe me këtë Allahu, subhanehu ve teala, i jep të mira të shumta kurse në botën tjetër shpërblime të panumërta.

Transmeton Abdullah ibën Mes'udi, radijall-llahu anhu, i cili thotë: "Ditën kur Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ndau plaqkën e luftës së Hunejnit, një prej Ensarëve tha: kjo ndarje nuk është bërë për hir të Allahut. Abdullah ibën Mes'udi thotë: "Shkova te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe pasi e lajmërova për këtë fjalë iu ndërta fytira e pastaj tha: Allahu e mëshiroftë Musain, është dëmtuar edhe më shumë se kjo mirëpo ka duruar". (Transmeton Buhariu) Mendo vëlla i nderuar si ka bërë durim Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe është sjellë butë me këtë njeri prej Ensarëve.

Transmetohet se dy njerëz vurën bast nëse munden të zemërojnë Ahnefin. Njëri prej tyre shkoi te Ahnefi dhe i shprehi dëshirën për t'u fejuar me nënën e tij. Ahnefi tha: nuk po të refuzoj për të të nënçmuar e as për atë se s'dua të të bëj dhëndër, mirëpo për shkak se nëna ime ka shumë vjet kurse ti ke nevojë për një grua të re që dashuron dhe që lind, që mëson nga morali yt dhe përfiton nga sjellja yte. Tash kthehu te shokët dhe lajmëroi se nuk më ke zemëruar!

Një njeri tjetër shkoi te Muaviju, radijall-llahu anhu, për të kërkuar prej tij që të fejojete me nënën e tij. Muaviju, radijall-llahu anhu, e pyeti: ç'të shtyri të interesohesh për nënën time kur e di se ajo është e shtyrë në moshë? Ai tha: po, kam dëgjuar se ajo është e shtyrë në moshë! Muaviju përsëri i tha: ndoshta ke patur për qëllim që të zemërosh zotëriun e fisit Temim (e ka për qëllim veteveten)? Ai u përgjigj: po, e Muaviju ia ktheu: shko se nuk mundesh!

Një njeri e shau Ebu Dherrin, radijall-llahu anhu, e ai i tha: mos vazhdo të më shashë dhe ler vend për pajtim sepse ne nuk ia kthejmë atyre që bëjnë mëkate Allahut duke na sharë, me më shumë se sa të respektojmë Allahun.

Ahmed Muadh Hakkij Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)